FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 95

Tiranë – E martë, 2 korrik 2019

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 430, datë 26.6.2019	Për miratimin e rregullit teknik për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve të transportueshme nën presion.....	6969
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 437, datë 26.6.2019	Për kriteret e licencimit të veprimtarive të përpunimit industrial të duhanit dhe/ose prodhimit të produkteve të duhanit.....	7001
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 441, datë 26.6.2019	Për miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, të pasurisë me numër 1044, zona kadastrale 3826, Bashkia Kolonjë.....	7004
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 442, datë 26.6.2019	Për miratimin e rregullave të ndalimit të eksportit të merkurit metalik, komponimeve dhe përzierjeve të caktuara të merkurit, ruajtjes së sigurt të merkurit metalik dhe të kritereve specifike të ruajtjes së merkurit metalik të konsideruar si mbetje.....	7007
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 445, datë 28.6.2019	Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të Bashkisë Vau i Dejës, z. Zef Hila	7017
Urdhër i ministrit të Kulturës nr. 386, datë 26.6.2019	Për delegim kompetence.....	7017
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 84, datë 31.5.2019	Mbi miratimin e "Kontratës për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektroenergjetik për periudhën kohore 1.1.2019–31.12.2019" midis OST sh.a. dhe KESH sh.a.....	7018
Vendim i Këshillit Kombëtar të Ujit nr. 6, datë 12.6.2019	Për miratimin e rregullores së Këshillit të Basenit Ujor.....	7030

Vendim i Drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave nr. 4, datë 20.6.2019	Për miratimin e standardeve të kutive, dosjeve dhe mjeteve kancelarike të detyrueshme për zbatim nga të gjitha institucionet e Republikës së Shqipërisë.....	7035
Vendim i Drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave nr. 5, datë 20.6.2019	Për miratimin e standardeve të kutive dhe dosjeve për ruajtje të përhershme, si dhe listës së institucioneve dhe tipologjisë e dokumenteve të institucioneve që janë të detyruara të zbatojnë këto standarde.....	7036

VENDIM
Nr. 430, datë 26.6.2019

PËR MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK PËR KËRKESAT THELBËSORE DHE VLERËSIMIN E KONFORMITETIT TË PAJISJEVE TË TRANSPORTUESHME NËN PRESION[1]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 7, 12, 13 dhe 22, të ligjit nr. 32/2016, "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion", dhe të neneve 5, 6, e 42, të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullit teknik për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve të transportueshme nën presion, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

RREGULL TEKNIK
PËR KËRKESAT THELBËSORE DHE VLERËSIMIN E KONFORMITETIT TË PAJISJEVE TË TRANSPORTUESHME NËN PRESION

KAPITULLI 1
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Ky Rregull Teknik përcakton rregullat mbi sigurinë e pajisjeve të transportueshme nën presion, të cilat janë projektuar për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme dhe për të siguruar qarkullimin e lirë të tyre, përfshirë vendosjen dhe bërjen të disponueshme të tyre në treg, si dhe përdorimin e këtyre pajisjeve të transportueshme nën presion, brenda territorit të Shqipërisë në kushte të sigurta teknike. Ky Rregull Teknik synon gjithashtu të përcaktojë edhe detyrimet e operatorëve ekonomikë, si dhe kushtet që duhet të plotësojnë këto pajisje të transportueshme nën presion, për të qenë të sigurta për përdorim, siç mund të jenë inspektimet periodike, të ndërmjetme apo të jashtëzakonshme si dhe përputhshmëria me përcaktimet teknike dhe standardet, të renditura në këtë vendim.

2. Ky Rregull Teknik zbatohet, për:

a) Pajisje të transportueshme nën presion, të cilat nuk mbartin markimin sipas këtij Rregulli Teknik, me qëllim bërjen e disponueshme në treg, rivlerësimin e konformitetit dhe përdorimin e tyre;

b) Pajisje të transportueshme nën presion, që mbartin markimin sipas këtij Rregulli Teknik me qëllim kryerjen e inspektimeve periodike, inspektimeve të ndërmjetme, kontrolle të jashtezakonshme dhe përdorimin e tyre;

c) Pajisje të transportueshme nën presion, që nuk mbartin markimet sipas këtij Rregulli Teknik dhe nuk kanë qenë subjekt i rivlerësimit të konformitetit, lidhur me kryerjen e inspektimeve periodike, inspektimeve të ndërmjetme, kontrolle të jashtëzakonshme dhe përdorimin e tyre.

3. Ky Rregull Teknik nuk zbatohet për pajisje të transportueshme nën presion, të cilat përdoren ekskluzivisht për transportin e mallrave të rrezikshme, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve të tjera, për të cilat zbatohen dispozitat përkatëse të ADR.

Neni 2
Përkufizime

Përveç përkufizimeve të dhëna në ligjin nr. 10489, datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", i ndryshuar, në kuptim të këtij Rregulli Teknik zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

[1] Ky vendim i Këshillit të Ministrave transpozon plotësisht direktivën 2010/35 EU.

1. "Pajisje e transportueshme nën presion" janë:

a) të gjitha bombolat nën presion, ventilët e tyre dhe aksesorët e tjerë të sigurisë (siç paraqiten në kapitullin I, të aneksit III, të këtij Rregulli Teknik dhe që përfshihen në kapitullin 6.2, të anekseve të ADR);

b) cisternat, automjetet bateri, depozita kontejner gazi me shumë elemente, valvulet e tyre dhe aksesorët e tjerë të lidhur me to, (siç përshkruhen në kapitullin II, të aneksit III, të këtij Rregulli Teknik dhe që përfshihen në kapitullin 6.8, të anekseve të ADR).

Në rastin kur, pajisjet e përmendura në germat "a" ose "b" më sipër, janë subjekt i trajtimit të këtij Rregulli Teknik, kur përdoren për mbushjen e gazeve të klasës 2 të klasifikimit të ADR, por duke përjashtuar gazet ose substancat të paraqitura me figurat 6 dhe 7, të kodit të klasifikimit të ADR dhe ato të lëndëve të rrezikshme, të klasave të tjera, të specifikuara në aneksin I të këtij Rregulli Teknik. Pajisjet e transportueshme nën presion përfshijnë pajisjet e gazit me referencën (UN 2037), por pa përfshirë aerosolët (UN 1950), enët e hapura kriogjenike, bombolat e gazit për aparate frymëmarrje, fikset e zjarrit (UN 1044), si dhe pajisjet e transportueshme nën presion, të listuara në anekset A dhe B, të ADR-së.

2. "ADR" është marrëveshja evropiane për transportin rrugor të mallrave të rrezikshme, (transpozuar me legjislacionin shqiptar, për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen Evropiane "Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme (ADR)" dhe protokollin e nënshkrimit"). Për referimin ndaj ADR-së, merret në konsideratë versioni i azhornuar i këtij dokumenti.

3. "Përdorim" është çdo mbushje, magazinim i përkohshëm për transportimin e tyre, zbrazja dhe rimbushja e pajisjes së transportueshme nën presion.

4. "Rikthim" është çdo masë, që synon në kthimin mbrapsht të pajisjes së transportueshme nën presion, e cila tashmë është bërë e disponueshme ndaj përdoruesit fundor.

5. "Importues" është çdo person fizik apo juridik i regjistruar në Shqipëri, i cili vendos në treg pajisje të transportueshme nën presion apo pjesë të tyre.

6. "Shpërndarës" është çdo person fizik apo juridik, përveç prodhuesit apo importuesit, i cili vendos në treg pajisje të transportueshme nën presion apo pjesë të tyre.

7. "Pronar" është çdo person fizik apo juridik në territorin shqiptar, i cili ka në pronësi ose posedim pajisje të transportueshme nën presion.

Në rastin e bombolave të GLN për përdorim familjar, pronar konsiderohet subjekti tregtar, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fushën e hidrokarbureve.

8. "Operator' është çdo person apo subjekt tregtar, i cili përdor pajisje të transportueshme nën presion.

9. "Vlerësimi i konformitetit" është procesi, i cili do të thotë, vlerësimi dhe procedura e vlerësimit të konformitetit, për të përcaktuar përmbushjen me kërkesat e specifikuara në këtë rregull teknik.

10. "Markim apo shenjim" sipas përcaktimeve të nenit 15, më poshtë është markimi ose sipas rastit, shënjimi, i cili tregon se pajisjet e transportueshme nën presion, janë në përputhje me kërkesat e vlerësimit të konformitetit, të përcaktuara në anekset e këtij Rregulli Teknik.

11. "Rivlerësimi i konformitetit" është procedura e realizuar, me kërkesë të pronarit dhe sipas rastit operatorit, për një rivlerësim të konformitetit të pajisjes së transportueshme nën presion, e cila është hedhur në treg, para datës së hyrjes në fuqi të këtij Rregulli Teknik.

12. "Inspektimi periodik" është inspektimi periodik dhe procedurat e përcaktuara për inspektimin periodik, të specifikuara në anekset e këtij Rregulli Teknik.

13. "Inspektim i ndërmjetëm" është inspektim i ndërmjetëm, i realizuar në përputhje me procedurat e përcaktuara, në anekset e këtij Rregulli Teknik.

14. "Kontroll i jashtëzakonshëm" është një kontroll i jashtëzakonshëm, sipas procedurave të përcaktuara në anekset e këtij Rregulli Teknik.

15. "Autoriteti miratues" është ministria përgjegjëse për industrinë.

16. "Klasat e mallrave të rrezikshme" të trajtuara në këtë Rregull Teknik, në përputhje me përcaktimet e ADR-së, janë:

Klasi I – substanca dhe lëndë shpërthyese;

Klasi II – gaze;

Klasi III – lëngje të djegshme.

17. "Ministria" është ministria përgjegjëse për industrinë.

18. "Ministri" është ministri përgjegjës për industrinë.

19. "Certifikatë Konformiteti" ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë në ligjin nr. 32/2016.

20. "Numri UN" është referenca ndaj klasifikimit të lëndëve apo mallrave të Kombeve të Bashkuara, të referuara në ADR.

Përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, i trajtuar në këtë Rregull Teknik, për bombolat e gazit të destinuara për mbushje me GLN, për përdorim prej konsumatorit fundor, personi përgjegjës për kryerjen e inspektimit periodik të tyre nga një OM, janë shoqëritë e autorizuara për mbushjen e tyre, sipas përcaktimit të ligjit nr. 8450/1999, i ndryshuar.

Neni 3
Kërkesa të veçanta të venddepozitimit apo magazinimit

Ministri përcakton, nëpërmjet një rregulloreje të miratuar me urdhër të posaçëm, kërkesa specifike që aplikohen për vendmagazinimin apo depozitimin e pajisjeve të transportueshme nën presion, kërkesa të cilat nuk lidhen me kushtet teknike të vetë pajisjeve nën presion.

KAPITULLI 2
DETYRIMET E OPERATORËVE EKONOMIKË

Neni 4
Detyrimet e prodhuesve

1. Kur prodhuesit vendosin në treg pajisjet e tyre të transportueshme nën presion, ata sigurojnë se ato janë në përputhje, me kërkesat e këtij Rregulli Teknik.

2. Kur pajisjet e transportueshme nën presion, janë në përputhje me kërkesat e zbatuara të sigurisë, e treguar kjo me procesin e vlerësimit të konformitetit, të përcaktuar në këtë Rregull Teknik, prodhuesi vendos markimin ose shënjimin përkatës, në përputhje me përcaktimet e nenit 15, të këtij Rregulli Teknik. Të gjitha pajisjet e transportueshme nën presion të importuara, që kanë të vendosur markimin Pi, sipas përcaktimeve të nenit 15, prezumohen se përmbushin kërkesat e këtij Rregulli Teknik.

3. Prodhuesit, mbajnë dhe ruajnë dokumentacionin teknik, që lidhet me prodhimin e pajisjes së transportueshme nën presion, për një periudhë jo më pak se dhjetë vjet, mbas vendosjes së produktit në treg.

4. Prodhuesit, të cilët vlerësojnë apo kanë arsye të besojnë se, pajisjet e transportueshme nën presion që ata kanë vendosur në treg, nuk janë në përputhje me kërkesat e këtij Rregulli Teknik, duhet të marrin menjëherë masat e nevojshme korrigjuese, për të sjellë pajisjet e transportueshme nën presion në përputhje me kushtet e konformitetit, si dhe ta tërheqë apo ta rikthejë atë, sipas rastit. Kur pajisja e transportueshme nën presion paraqet një rrezik, prodhuesi njofton menjëherë inspektoratin shtetëror teknik dhe industrial (ISHTI), duke i dhënë hollësitë, në veçanti mbi mospërputhshmërisë dhe të çdo mase, të marrë për korrigjimin e mospërputhshmërisë.

5. Prodhuesi dokumenton të gjithë procedurën e identifikimit të mospërputhshmërisë dhe të masave korrigjuese të ndërmarra.

6. Prodhuesit në vijim të një kërkese të arsyetuar nga ISHTI-ja, duhet të ofrojnë informacionin e kërkuar nga organet kompetente, duke argumentuar në mënyrë dokumentare konformitetin e pajisjes së transportueshme nën presion, në mënyrë lehtësisht të kuptueshme. Prodhuesit duhet të bashkëpunojnë me ISHTI-në sipas kërkesës së këtij të fundit, për të eliminuar rreziqet e shfaqura nga pajisjet e transportueshme nën presion, të vendosura në treg.

Neni 5
Përfaqësuesit e autorizuar

1. Prodhuesi me një akt përfaqësimi mund të caktojë një përfaqësues të autorizuar.

Detyrimet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të nenit 4 dhe hartimi i dokumentacionit teknik nuk janë pjesë e aktit të përfaqësimit të lëshuar prej tij.

2. Një përfaqësues i autorizuar kryen detyrat e përcaktuara në aktin e përfaqësimit, të lëshuar nga prodhuesi. Akti i përfaqësimit, i lejon

përfaqësuesit të autorizuar të kryejë të paktën detyrimet e mëposhtme:

a) të mbajë dokumentacionin teknik në dispozicion të ISHTI-t, për një periudhë jo më pak se 10 vjet.

b) t'i sigurojë ISHTI-së, sipas një kërkese të tij, të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm, për të demonstruar konformitetin e pajisjes së transportueshme nën presion.

3. Identiteti dhe adresa e përfaqësuesit të autorizuar, duhet të tregohet në certifikatën / deklaratën e konformitetit, të pajisjes së transportueshme nën presion, në momentin e vënies në treg.

Neni 6
Detyrimet e importuesit

1. Importuesi vendos në treg vetëm pajisje të transportueshme nën presion, të cilat janë në përputhje me kërkesat e këtij Rregulli Teknik.

2. Përpara vendosjes në treg të pajisjeve të transportueshme nën presion, importuesit sigurojnë se prodhuesit kanë realizuar plotësisht procedurat e vlerësimit të konformitetit. Importuesit sigurojnë se prodhuesit kanë hartuar dokumentacionin teknik dhe se pajisja e transportueshme nën presion, mbart markimin sipas parashikimit në këtë Rregull teknik dhe shoqërohet nga certifikata e konformitetit.

Kur një importues konsideron, apo ka arsye të besojë se, pajisja e transportueshme nën presion nuk është në përputhje me kërkesat e këtij Rregulli Teknik, ai nuk duhet ta vendosë në treg pajisjen e transportueshme, deri sa të sillet në përputhje me kërkesat e konformitetit. Në rastin kur, pajisja e transportueshme nën presion paraqet një rrezik, importuesi duhet të njoftojë menjëherë për këtë qëllim prodhuesin dhe ISHTI-në.

3. Importuesit tregojnë emrin e tyre dhe adresën, ku mund të kontaktohen në certifikatën e konformitetit, që shoqëron pajisjen e transportueshme nën presion.

4. Importuesit sigurojnë se, gjatë kohës kur pajisjet e transportueshme nën presion janë nën përgjegjësinë e tyre, kushtet e magazinimit ose transportit të tyre nuk duhet të rrezikojnë përputhshmërinë e këtyre pajisjeve me kërkesat përkatëse.

5. Importuesit të cilët vlerësojnë ose kanë arsye të besojnë se, pajisjet e transportueshme nën presion që ata kanë vendosur në treg nuk janë në konformitet me këtë Rregull Teknik, duhet të marrin masa të menjëhershme korrigjuese, të kthejnë ose të ndalojnë nëse kërkohet. Për më tepër, në rastin kur pajisja e transportueshme nën presion paraqet një rrezik, importuesi informon menjëherë prodhuesin dhe ISHTI-në duke dhënë hollësi, veçanërisht mbi mospërputhjet dhe për çdo masë të marrë.

Importuesit dokumentojnë të gjitha këto raste të mospërputhjeve dhe të masave korrigjuese.

6. Importuesi mban për një periudhë jo më pak se 10 vjet, një kopje të dokumentacionit teknik të paraqitur nga prodhuesi, duke e vënë në dispozicion të ISHTI-së dhe ndaj organeve kompetente, për shqyrtim sipas kërkesës së tyre.

7. Me kërkesë të ISHTI-së, importuesi i siguron të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm, në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme, për të demonstruar konformitetin e pajisjes së transportueshme nën presion. Importuesi bashkëpunon me autoritetin sipas kërkesës së këtij të fundit, për çdo masë të marrë për të eliminuar rreziqet e shfaqura nga pajisjet e transportueshme nën presion, të vendosura në treg.

8. Importuesit duhet të japin informacion ndaj operatorëve, për qëllim të përmbushjes së detyrimeve të tyre ligjore, në përputhje me kërkesat e këtij vendimi.

Neni 7
Detyrimet e shpërndarësve

1. Shpërndarësit duhet të bëjnë të disponueshme në treg, vetëm pajisje të transportueshme nën presion, të cilat janë në përputhje me kërkesat e këtij Rregulli Teknik. Përpara bërjes së disponueshme në treg të pajisjeve të transportueshme nën presion, shpërndarësit verifikojnë se pajisjet e transportueshme nën presion, mbartin markimin ose shënjimin sipas përcaktimeve të këtij Rregulli Teknik dhe se shoqërohen me certifikatën e konformitetit dhe adresën e kontaktit të referuar, në pikën 3, të nenit 6, të këtij Rregulli Teknik.

Kur një shpërndarës konsideron ose ka arsye të besojë se, pajisja e transportueshme nën

presion nuk është në përputhje me kërkesat e këtij Rregulli Teknik, ai nuk duhet ta bëjë të disponueshme në treg deri sa ajo të sillet në konformitet. Për më tepër, në rastin kur pajisja e transportueshme nën presion shfaq një rrezik, shpërndarësi informon prodhuesin ose importuesin mbi rrezikun, si dhe ISHTI-në.

2. Shpërndarësi siguron se, gjatë kohës që pajisjet e transportueshme nën presion janë nën përgjegjësinë e tyre, kushtet e magazinimit apo trasportimit të tyre nuk duhet të cenojnë përputhshmërinë me kërkesat e këtij Rregulli Teknik.

3. Shpërndarësit të cilët konsiderojnë ose kanë arsye të besojnë se pajisjet e transportueshme nën presion, të cilat ata i kanë bërë të disponueshme në treg, nuk janë në konformitet me kërkesat e këtij Rregulli Teknik, duhet të sigurojnë marrjen e masave për të sjellë këto pajisje të transportueshme nën presion në konformitet, t'i kthejnë ose t'i ndalojnë ato, sipas rastit. Për më tepër, në rastin kur pajisja e transportueshme nën presion shfaq një rrezik, shpërndarësi duhet të njoftojë menjëherë prodhuesin, importuesin kur kërkohet dhe ISHTI-në, duke dhënë edhe informacion të detajuar mbi mospërputhjen dhe masat korrigjuese të marra prej tij. Shpërndarësit duhet të dokumentojnë të tilla raste moskonformiteti dhe të çdo mase korrigjuese të marrë.

4. Me kërkesë të ISHTI-së, shpërndarësit i sigurojnë atij të gjithë informacionin dhe dokumentacionin, të nevojshëm për të demonstruar konformitetin e pajisjeve të transportueshme nën presion, në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme prej autoritetit. Shpërndarësit bashkëpunojnë me autoritetin, sipas kërkesës së tij, për çdo masë të marrë për të eliminuar rrezikun e shfaqur nga pajisja e transportueshme nën presion, të cilën e kanë bërë të disponueshme në treg.

5. Shpërndarësit duhet të ofrojnë informacion ndaj operatorëve, në përputhje me specifikimet e këtij Rregulli Teknik.

Neni 8
Detyrimet e pronarëve

1. Kur një pronar konsideron ose ka arsye të besojë se pajisja e transportueshme nën presion, nuk është në konformitet me kërkesat e këtij Rregulli Teknik, duke përfshirë kërkesat për inspektimin periodik, ai nuk duhet ta bëjë të disponueshme në treg ose të përdorë atë, deri sa të sillet në konformitet. Për më tepër, në rastin kur pajisjet e transportueshme nën presion paraqesin një rrezik, pronari duhet të informojë sipas rastit prodhuesin, importuesin ose shpërndarësin, dhe ISHTI-në.

Pronarët duhet të dokumentojnë të gjitha rastet e mospërputhjes dhe masat korrigjuese.

2. Pronarët duhet të sigurojnë se, për sa kohë pajisjet e transportueshme nën presion janë nën përgjegjësinë e tyre, kushtet e magazinimit dhe transportit nuk duhet të rrezikojnë përputhshmërinë e tyre me kërkesat e këtij Rregulli Teknik.

3. Pronarët duhet të ofrojnë ndaj operatorëve, informacionin e kërkuar në përputhje me kërkesat e këtij Rregulli Teknik.

4. Kërkesat e këtij neni nuk zbatohen për përdoruesit familjarë, të cilët i përdorin këto pajisje të transportueshme nën presion për përdorimin e tyre në familje, aktivitete pushimi apo sportive.

Neni 9
Detyrimet e operatorëve

1. Operatorët duhet të përdorin vetëm pajisje të transportueshme nën presion, të cilat janë në përputhje me kërkesat e këtij Rregulli Teknik.

2. Kur pajisjet e transportueshme nën presion paraqesin një rrezik, operatori duhet të informojë pronarin, si dhe ISHTI-në.

Neni 10
Rastet kur detyrimet e prodhuesve aplikohen edhe ndaj importuesve dhe shpërndarësve

Një importues ose shpërndarës konsiderohet si prodhues, për qëllime të këtij Rregulli Teknik dhe subjekt i detyrimeve të prodhuesit sipas nenit 4, të këtij Rregulli Teknik, kur ai vendos në treg pajisje të transportueshme nën presion, nën emrin ose markën e tij tregtare, ose modifikon pajisjen e transportueshme nën presion, tashmë të vendosur në treg, në mënyrë të tillë që, ndikon

në përputhshmërinë me kërkesat e zbatuara, ndaj kësaj pajisje të transportueshme nën presion.

Neni 11
Informacioni prej operatorëve ekonomikë

Operatorët ekonomikë, me kërkesë të ISHTI-së dhe ministrisë, japin informacion për një periudhë të paktën dhjetë vjeçare, mbi:

a) çdo operator ekonomik, i cili i ka furnizuar me pajisje të transportueshme nën presion;

b) çdo operator ekonomik, të cilin e ka furnizuar me pajisje të transportueshme nën presion.

KAPITULLI 3
KONFORMITETI I PAJISJEVE TË TRANSPORTUESHME NËN PRESION

Neni 12
Konformiteti i pajisjeve të transportueshme nën presion dhe vlerësimi i tyre

1. Pajisjet e transportueshme nën presion të përmendura në nenin 1, pika 2/a, duhet të plotësojnë kërkesat përkatëse të vlerësimit të konformitetit, inspektimit periodik, inspektimit të ndërmjetëm dhe kërkesave të kontrolleve të jashtëzakonshme, të përcaktuara në këtë Rregull Teknik.

2. Pajisjet e transportueshme nën presion të përmendura në nenin 1, pika 2/b, duhet të plotësojnë specifikimet e dokumentacionit, sipas të cilit pajisja është prodhuar. Pajisjet janë subjekt i inspektimeve periodike, të ndërmjetme dhe të jashtëzakonshme, sipas kërkesave të kapitujve 3 dhe 4 të këtij Rregulli Teknik.

3. Certifikatat e vlerësimit të konformitetit dhe certifikatat e rivlerësimit të konformitetit, si dhe raportet e inspektimeve periodike, të ndërmjetme dhe të jashtëzakonshme, të lëshuara nga një OM duhet të shoqërojnë pajisjen gjatë gjithë ciklit të shfrytëzimit të saj.

Për pjesët e çmontueshme të pajisjeve rimbushëse të transportueshme nën presion, kryhet një vlerësim i veçantë i konformitetit.

Neni 13
Rivlerësimi i konformitetit

Rivlerësimi i konformitetit të pajisjeve të transportueshme nën presion, të përmendura në nenin 1 pika 2/c, të prodhuara dhe të vëna në përdorim përpara datës së hyrjes në fuqi, të këtij Rregulli Teknik, do të kryhet sipas procedurave të dhëna në aneksin III, të këtij Rregulli Teknik.

Markimi Pi dhe shënjimi AL i këtyre pajisjeve, kryhet sipas përcaktimeve të këtij Rregulli Teknik.

Neni 14
Parimet e përgjithshme të markimit Pi dhe shënjimit AL

1. Markimi Pi vendoset nga prodhuesit, në rastet e rivlerësimit të konformitetit, sipas përcaktimeve të specifikuara në këtë Rregull Teknik.

Për bombolat e vendosura në treg, përpara datës së hyrjes në fuqi të këtij Rregulli Teknik, të cilat nuk kanë markimin përkatës të përcaktuar në këtë Rregull Teknik, vendoset shënjimi "AL" pas rivlerësimit të konformitetit, prej një OM.

2. Markimi Pi do të vendoset vetëm ndaj pajisjeve të transportueshme nën presion, të cilat janë në përputhje me kërkesat e vlerësimit të konformitetit të përcaktuara në këtë Rregull Teknik. Shënjimi AL vendoset vetëm ndaj pajisjeve të transportueshme nën presion, të cilat janë në përputhje me kërkesat e rivlerësimit të konformitetit.

Markimi dhe shënjimi nuk vendosen ndaj pajisjeve të tjera të transportueshme nën presion, përveç atyre të përcaktuara në këtë rregull teknik.

3. Duke vendosur markimin përkatës, prodhuesi ose pronari tregon se, merr përsipër përgjegjësinë për konformitetin e pajisjes së transportueshme nën presion, ndaj gjithë kërkesave të përcaktuara në këtë Rregull Teknik.

4. Markimi sipas përcaktimeve të këtij Rregulli Teknik, është i vetmi markim që vërteton konformitetin e pajisjes së transportueshme nën presion me kërkesat e zbatuara, të përcaktuara në këtë Rregull Teknik.

5. Vendosja e markimit, apo shënjimit, ndaj pajisjeve të transportueshme nën presion, të cilat mund të krijojnë një shtrembërim të kuptimit të

markimit dhe shënjimit, apo formës së saj, është e ndaluar.

Çdo markim apo shënjim ndaj pajisjes së transportueshme nën presion, duhet të bëhet në mënyrë të tillë që, të mos pengohet shikueshmëria apo kuptueshmëria e saj.

6. Pjesët e çmontueshme të pajisjeve rimbushëse të transportueshme nën presion, që kanë funksion të drejtpërdrejtë sigurie, duhet të markohen apo shënjohen sipas përcaktimeve të nenit 15.

7. Në rast keqpërdorimi të markimit ose shënjimit, përveçse zbatohen masat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, zbatohen edhe masa dhe sanksione sipas përcaktimeve të legjislacionit, për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

Neni 15

Rregullat dhe kushtet për markimin Pi dhe shënjimin AL

1. Markimi Pi do të bëhet sipas simbolit të poshtëshënuar:



2. Lartësia minimale e simbolit do të jetë 5 milimetra. Për pajisjet e transportueshme nën presion me një diametër jo më shumë se 140 milimetra, lartësia minimale do të jetë 2,5 milimetra.

3. Përmasat e dhëna në simbolin e mësipërm duhet të zbatohen me rigorozitet. Rrjeta kuadratike në sfondin e markës Pi nuk duhet të përdoret për markim.

4. Markimi Pi duhet të vendoset në pajisjen e transportueshme nën presion dhe sipas rastit, në pjesën e çmontueshme të pajisjes rimbushëse, që lidhet drejtpërdrejt me funksion sigurie, në trupin e pajisjes ose në etiketën e saj, në një vend të dukshëm, lehtësisht i lexueshëm dhe të mos mund të hiqet.

5. Markimi Pi duhet të kryhet përpara se pajisja e transportueshme nën presion, apo pjesa e çmontueshme e pajisjes rimbushëse që lidhet drejtpërdrejt me funksion sigurie, të vendosen në treg, apo kur i nënshtrohen rivlerësimit të konformitetit.

6. Markimi Pi duhet të ndiqet nga numri i identifikimit i OEN-së, të përfshirë në inspektimin fillestar dhe testimet e bëra gjatë vlerësimit të konformitetit, përpara se të vendoset në treg.

Numri i identifikimit të OEN-së dhe data e inspektimit duhet të vendoset nga vetë ky organ, ose sipas rastit sipas instruksioneve të këtij të fundit, në fazën e prodhimit prej prodhuesit.

7. Shënimi i datës së ardhshme të inspektimit periodik ose sipas rastit, inspektimit të ndërmjetëm, duhet të vendoset në pajisjen e transportueshme nën presion dhe të shoqërohet me numrin e identifikimit të OEN-së, përgjegjëse për inspektimet periodike, në përputhje kjo me direktivën.

8. Bombolat e përdorura për mbushje me GLN, të cilat tashmë janë të hedhura në treg dhe të cilat nuk kanë markimin Pi, sipas përcaktimeve të këtij Rregulli Teknik, duhet t'i nënshtrohen inspektimit fillestar dhe vijimisht atij periodik, në përputhje me kërkesat e këtij Rregulli Teknik. Në rastin e inspektimit fillestar, pasi të gjenden në përputhje me kushtet e konformitetit, do të shënjohen me simbolin "AL", të shoqëruar me numrin e identifikimit të OM, që ka kryer inspektimin.

9. Shënjimi AL do të bëhet sipas simbolit të poshtëshënuar:



Lartësia minimale e simbolit do të jetë 5 milimetra. Për pajisjet e transportueshme nën presion me një diametër jo më shumë se 140 milimetra, lartësia minimale do të jetë 2,5 milimetra.

10. Përmasat e dhëna në simbolin e mësipërm duhet të zbatohen me rigorozitet. Në sfondin e shënjimit AL nuk duhet të përdoret asnjë rrjetëzim.

11. Shënjimi AL duhet të vendoset në pajisjen e transportueshme nën presion dhe sipas rastit në pjesën e çmontueshme të pajisjes rimbushëse që

lidhet drejtpërdrejt me funksion sigurie, në trupin e pajisjes ose në etiketën e saj, në një vend të dukshëm, lehtësisht i lexueshëm dhe të mos mund të hiqet.

12. Shënjimi AL duhet të vendoset pasi pajisja e transportueshme nën presion, apo pjesa e çmontueshme e pajisjes rimbushëse që lidhet drejtpërdrejt me funksion sigurie, i nënshtrohet rivlerësimit të konformitetit, përpara se pajisja të rivendoset në treg.

13. Shënjimi AL duhet të ndiqet nga numri i identifikimit të OM-së, të përfshirë në inspektimin dhe testimet e bëra gjatë rivlerësimit të konformitetit, përpara se të vendoset apo të rivendoset në treg. Numri i identifikimit të OM-së duhet të vendoset nga vetë ky organ sipas rastit, ose sipas instruksioneve të këtij të fundit.

Neni 16
Qarkullimi i lirë i pajisjeve të transportueshme nën presion

Ky Rregull Teknik sanksionon parimin e lëvizjes së lirë të pajisjeve të transportueshme nën presion, të cilat janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë Rregull Teknik.

KAPITULLI 4
DETYRIMET E ORGANIT TË MIRATUAR

Neni 17
Kërkesat dhe detyrimet operacionale të Organit të Miratuar

1. OM-ja duhet të kryejë procedurat e vlerësimit të konformitetit, inspektimet periodike, inspektimet e ndërmjetme dhe kontrollet e jashtëzakonshme në përputhje me kriteret e aktit përkatës të miratimit.

2. OM-ja duhet të kryejë procedurat e rivlerësimit të konformitetit në përputhje me specifikimet e këtij Rregulli Teknik.

3. Përveç kërkesave të parashikuara në legjislacionin për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore, për organet e miratuara të vlerësimit të konformitetit, nga ministri përgjegjës për industrinë, duhet të plotësojnë edhe kërkesat e mëposhtme:

a) shmangien nga çdo konflikt interesi;

b) pavarësinë dhe kompensimin e drejtë të punonjësve;

c) sigurimin ndaj përgjegjësive civile.

Neni 18
Detyrimi i Organit të Miratuar për informimin

Organi i miratuar duhet të informojë ministrin përgjegjës për industrinë, mbi rastet e mëposhtme:

a) çdo refuzim, kufizim, pezullim apo revokim të një certifikate konformiteti;

b) çdo rrethanë, e cila ndikon në qëllimin dhe kushtet e miratimit të tij;

c) çdo informacion mbi aktivitetet e kryera, të kërkuar nga autoritetet shtetërore përgjegjëse.

KAPITULLI 5
PROCEDURAT E SIGURISË

Neni 19
Procedura për trajtimin e pajisjeve të transportueshme nën presion, të cilat paraqesin rrezik në nivel kombëtar

1. Në rastet kur, ISHTI-ja ka arsye të mjaftueshme për të besuar se pajisjet e transportueshme nën presion, objekt i këtij Rregulli Teknik, paraqesin një rrezik për shëndetin, sigurinë e njerëzve apo aspekte të tjera të interesit publik, ai kryen një vlerësim ndaj pajisjeve të transportueshme nën presion, të cilat i vlerëson se paraqesin rrezik. Vlerësimi përfshin të gjitha kërkesat e specifikuara në këtë Rregull Teknik. Operatorët përkatës ekonomikë, duhet të bashkëpunojnë me ISHTI-në, duke ofruar akses në ambientet e tyre dhe vënien në dispozicion të mostrave, sipas kërkesës.

Në rastet kur, gjatë këtij vlerësimi evidentohet se pajisjet e transportueshme nën presion, nuk përputhen me kërkesat e këtij Rregulli Teknik, ISHTI-ja i kërkon menjëherë operatorëve ekonomikë përkatës, të ndërmarrin masa korrigjuese për t'i sjellë këto pajisje në përputhje me ato kërkesa dhe sipas rastit, ndalimin e tregtimit apo kthimin mbrapsht të pajisjeve të transportueshme nën presion, qe janë bërë të disponueshme te përdoruesi i fundit, brenda një periudhe të arsyeshme kohore, në përputhje me natyrën e riskut, sipas vlerësimit përkatës. Në këto raste, zbatohen dispozitat e ligjit për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve

joushqimore. ISHTI-ja për këtë qëllim njofton edhe OM-në.

2. Operatori ekonomik duhet të sigurojë se janë marrë masat përkatëse korrigjuese për pajisjen e transportueshme nën presion.

3. Kur operatori ekonomik përkatës, nuk ndërmerr masat e duhura korrigjuese, brenda periudhës së përcaktuar në paragrafin e dytë të pikës 1, të këtij neni, ISHTI-ja duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme, për të ndaluar apo kufizuar vënien në treg të këtyre pajisjeve të transportueshme nën presion. Në këtë rast, ISHTI-ja njofton ministrin përgjegjës për industrinë.

4. Informacioni i dhënë në pikën 3 më sipër, duhet të përfshijë të gjitha detajet, në veçanti të dhënat e nevojshme për identifikimin e mospërputhjeve të pajisjeve të transportueshme nën presion, origjinën e pajisjes, natyrën e mospërputhjes dhe nivelin e riskut që paraqet, natyrën dhe afatet e masave të ndërmarra, si dhe argumentet e paraqitura nga operatorët ekonomikë. Në veçanti, ISHTI-ja do të paraqesë në MIE një informacion nëse mospërputhja ka ardhur prej:

a) Mospërputhjes së pajisjeve të transportueshme nën presion, me kërkesat që lidhen me shëndetin ose sigurinë e personave, si dhe aspekteve të tjera të interesit publik, të përcaktuara në këtë Rregull Teknik; apo

Mangësive në referencat ndaj standardeve të harmonizuara apo akteve teknike referuese.

Neni 20

Pajisje të transportueshme nën presion në përputhje me kërkesat e konformitetit, të cilat paraqesin një rrezik për shëndetin dhe sigurinë

1. Në rastin kur kryhet një vlerësim sipas përcaktimeve të nenit 19, pika 1, megjithëse pajisjet e transportueshme nën presion janë në përputhje me kërkesat e këtij Rregulli Teknik, ato paraqesin një rrezik për shëndetin apo sigurinë e njerëzve, apo aspekte të tjera të interesit publik, ISHTI-ja u kërkon të gjithë operatorëve përkatës ekonomikë, të ndërmarrin të gjitha masat përkatëse ndaj pajisjeve të transportueshme nën presion, që vendosen apo gjenden në treg, duke i tërhequr apo kthyer mbrapsht nga përdoruesi i fundit brenda një periudhe të përshtatshme kohore, në përputhje me natyrën e riskut.

2. Operatori ekonomik duhet të sigurojë se, ka ndërmarrë masat përkatëse korrigjuese lidhur me pajisjen e transportueshme nën presion që ka vendosur në treg.

3. Në këtë rast, ISHTI-ja duhet të informojë gjithë autoritetet dhe palët e përfshira, mbi detajet e nevojshme për identifikimin e pajisjeve të transportueshme nën presion që paraqesin një risk, origjinën dhe zinxhirin e furnizimit dhe vendosjes në treg të tij, natyrën e rrezikut dhe masat e marra.

Neni 21

Mospërputhja formale

1. Pa paragjykuar përcaktimet e nenit 19, kur vërehen situatat e mëposhtme, ISHTI-ja i kërkon operatorit ekonomik përkatës, të zgjidhë përfundimisht mospërputhjen e vërejtur, në rastet, kur:

a) markimi Pi është vendosur në mospërputhje, me përcaktimet e neneve 13, 14 apo 15;

b) markimi Pi nuk është vendosur sipas përcaktimeve të neneve 13, 14 apo 15;

c) shënjimi AL është vendosur në mos-përputhje, me përcaktimet e neneve 13, 14 apo 15;

d) shënjimi AL nuk është vendosur sipas përcaktimeve të neneve 13, 14 apo 15;

e) dokumentacioni teknik nuk është i disponueshëm, ose është jo i plotë;

f) nuk janë plotësuar kërkesat e këtij Rregulli Teknik.

2 Kur mospërputhjet e përmendura në pikën 1 më sipër vazhdojnë, ISHTI merr masa për të kufizuar apo ndaluar tregtimin dhe qarkullimin e lirë të pajisjeve të transportueshme nën presion, duke i tërhequr apo sipas rastit duke i kthyer mbrapsht ato.

KAPITULLI 6
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 22
Dispozita përfundimtare

Numri UN	Kategoria	Substanca e rrezikshme
1051	6.1	ACID CIANIDRIK, I STABILIZUAR me përmbajtje uji më pak se 3%
1052	8	ACID FLUORIDRIK, ANIDRIK
1745	5.1	PENTAFLORUR BROMI përjashtuar transporti në cisterna
1746	5.1	TRIFLORUR BROMI përjashtuar transporti në cisterna
1790	8	ACID FLUORIDRIK me përqendrim më të madh se 85%
2495	5.1	PENTAFLORUR JODI përjashtuar transporti në cisterna

Lidhur me markimin, shënjimin, apo kritere teknike të tjera specifike mbi pajisje të transportueshme nën presion, do të përdoren kriteret e përcaktuara në aneksin III, të këtij vendimi.

ANEKSI I
LISTA E MALLRAVE TË RREZIKSHME, PËRVEÇ ATYRE TË KLASIT 2

ANEKSI II
PROCEDURAT PËR RIVLERËSIMIN E KONFORMITETIT

1. Metoda për të siguruar se pajisjet e transportueshme nën presion, referuar nenit 1, pika 2, germa "c", të prodhuara dhe vënë në shërbim/përdorim, përpara hyrjes në fuqi të këtij Rregulli Teknik, janë në përputhje me dispozitat e këtij Rregulli Teknik, kur për rivlerësim zbatohen kërkesat e dhëna në këtë aneks.

2. Pronari ose personi përgjegjës që ka titullin e pronësisë/posedimit të rregullit ligjor, do t'i paraqesë OM-së të gjithë informacionin që ka të bëjë me pajisjen e transportueshme nën presion, duke mundësuar identifikimin e saktë të pajisjes (origjinën, rregullat e projektimit dhe në rastet e bombolave të acetilenit edhe detajet e materialit poroz).

Informacioni përfshin sipas rastit, çdo kushtëzim të përdorimit, si dhe çdo dëmtim të mundshëm apo riparim të kryer.

3. OM-ja e tipit A për rivlerësimin e konformitetit vlerëson, nëse pajisja e transportueshme nën presion ofron të paktën, të njëjtën shkallë sigurie të përcaktuar në dispozitat e këtij Rregulli Teknik. Vlerësimi kryhet mbi bazën e informacionit, të siguruar në përputhje me pikën 2 më sipër dhe në rastin kur është e përshtatshme, mbi bazën e inspektimeve të tjera.

4. Nëse rezultatet e vlerësimit sipas pikës 3 më sipër janë të kënaqshme, pajisja e transportueshme nën presion i nënshtrohet inspektimit periodik të parashikuar në aneksin III. Në rast të përmbushjes së kërkesave të inspektimit periodik, aplikohet shënjimi AL nën mbikëqyrjen e OM-së përgjegjëse për inspektimin periodik, në përputhje me nenin 14. Shënjimi AL do të ndiqet nga numri i identifikimit të OM-së, i cili do të lëshojë certifikatën e konformitetit, në përputhje me dispozitat e pikës 6, këtu më poshtë.

5. Në rastin e bombolave nën presion të prodhuara në seri, rivlerësimi i konformitetit do të kryhet prej OM i notifikuar, për inspektimet periodike të bombolës përkatëse nën presion, me kushtin që konformiteti i tipit është vlerësuar, në përputhje me përcaktimet e pikës 3 më sipër, nga një OM i tipit A, përgjegjëse për rivlerësimin e konformitetit dhe për çdo rast, lëshohet certifikata e rivlerësimit sipas direktivës.

6. Në të gjitha rastet, OM-ja përgjegjëse për inspektimin periodik, do të lëshojnë certifikatën e konformitetit, e cila përmban të paktën:

a) numrin e identifikimit të OM-së, që lëshon certifikatën dhe nëse është ndryshe, numrin e

identifikimit të tipit A, të OM-së përgjegjëse për rivlerësimin e konformitetit, në përputhje me pikën 3;

b) emrin dhe adresën e pronarit apo operatorit, sipas përcaktimeve të pikës 2 më sipër;

c) në rastin e aplikimit të procedurës sipas pikës 5, të dhënat treguese të certifikatës sipas llojit të vlerësimit;

d) të dhënat për identifikimin e pajisjes së transportueshme nën presion, ndaj së cilës është kryer shënjimi AL, shoqëruar edhe nga numri serial; dhe

e) data e lëshimit.

7. Edhe në rastet e rivlerësimit lëshohet certifikatë konformiteti. Në rastet e përdorimit të procedurës sipas pikës 5, OM-ja e tipit A përgjegjës për rivlerësimin lëshon certifikatën e konformitetit e cila përmban të paktën:

a) numrin e identifikimit të OM-së, që lëshon certifikatën dhe nëse është ndryshe, numrin e identifikimit të tipit A, të OM-së përgjegjëse për rivlerësimin e konformitetit, në përputhje me pikën 3;

b) emrin dhe adresën e prodhuesit dhe mbajtësit origjinal, të miratimit të pajisjes së transportueshme nën presion, që i është nënshtruar rivlerësimit, në rastet kur nuk është prodhuesi;

c) të dhënat identifikuese të pajisjes së transportueshme nën presion, të prodhuar në seri;

d) datën e lëshimit; dhe

e) fjalët: "kjo certifikatë nuk është e vlefshme dhe nuk autorizon prodhim të pajisjeve të ngjashme të transportueshme nën presion, apo pjesë të saj".

8. Me vendosjen apo kur është vendosur markimi Pi apo shënjimi AL, pronari apo poseduesi tregon se merr përsipër përgjegjësinë, për konformitetin e pajisjes së transportueshme nën presion, ndaj gjithë kërkesave të përcaktuara në këtë vendim, në momentin e rivlerësimit.

ANEKSI III
KËRKESA PËR INSPEKTIMIN E PAJISJEVE TË TRANSPORTUESHME NËN PRESION

Hyrje

Personi përgjegjës për pajisjet e transportueshme nën presion, referuar nenit 2 të këtij Rregulli Teknik, është i detyruar të garantojë që pajisjet e transportueshme nën presion, të vëna në shërbim/shfrytëzim vazhdojnë të jenë në përputhje me kërkesat e këtij Rregulli Teknik, gjatë gjithë periudhës së përdorimit të tyre. Ai ka gjithashtu detyrimin, që të marrë të gjitha masat për kryerjen e inspektimit periodik, inspektimit të ndërmjetëm dhe të kontrolleve të jashtëzakonshme, për çdo pajisje të transportueshme nën presion.

Rezultati pozitiv i vlerësimit të kryer, bën të mundur që pajisjet e transportueshme nën presion, që i janë nënshtruar vlerësimit, të mund të vazhdojnë të jenë në shërbim/shfrytëzim.

KAPITULLI I
KËRKESA PËR NDËRTIMIN DHE INSPEKTIMIN E ENËVE TË TRANSPORTUESHME NËN PRESION, BOMBOLAVE QË RIMBUSHEN, AEROSOLËVE SHPËRNDARËS, ENËVE TË VOGLA QË PËRMBAJNË GAZ (FISHEKËT E GAZIT) DHE FISHEKËT PËR PILË, ME LËNDË DJEGËSE QË MBAJNË GAZ TË LËNGËZUAR TË NDEZSHËM

SHËNIM. Aerosolët shpërndarës, enët e transportueshme të vogla që përmbajnë gaz (fishekët e gazit, dhe fishekët për pilë me lëndë djegëse që mbajnë gaz të lëngëzuar të ndezëshëm, nuk i nënshtrohen kërkesave të përcaktuara nga pika 1 deri në pikën 5 të këtij aneksi.

1. Kërkesa të përgjithshme

3.1 Projektimi dhe prodhimi

3.1.1 Enët e transportueshme nën presion dhe mbylljet e tyre duhet të projektohen, prodhohen, provohen dhe të pajisen, në mënyrë të tillë që të përballojnë të gjitha konditat, përfshirë lodhjen, të cilave do t'u nënshtrohen gjatë konditave normale të ngarkimit dhe përdorimit.

3.1.2 Trashësia minimale e mureve në asnjë rast, nuk duhet të jetë më e vogël se ajo e specifikuar në projekt dhe në standardet teknike të ndërtimit.

3.1.3 Për enët e transportueshme të salduara duhet të përdoren vetëm metale me veti të saldueshëm.

3.1.4 Presioni i provës i bombolave, tubave, fuçive nën presion dhe bateritë e bombolave duhet të jenë në përputhje me instruksionin e ambalazhimit P 200, ose për një substancë kimike nën presion në përputhje me instruksionin e paketimit P 206. Presioni i provës për enët kriogjenike të mbyllura duhet të jetë në përputhje me instruksionin e paketimit P 203. Presioni i testimit për sistemin hidraulik metalik, duhet të jetë në përputhje me instruksionin e paketimit P 205.

3.1.5 Presioni i enëve të bashkuara në bateri, duhet të jetë i mbajtur nga një strukturë dhe të lidhura së bashku që të formohet një njësi. Enët nën presion duhet të sigurohen, në mënyrë që të parandalohet lëvizja kundrejt lidhjes në strukturë dhe lëvizjes, që mund të rezultojë nga përqëndrimi i sforcimeve lokale të dëmshme. Bashkimet e tubave kolektorë (p.sh.: tubat kolektorë, ventilat dhe manometrat), duhet të projektohen dhe prodhohen në mënyrë të tillë që, të mbrohen nga goditjet dhe kundra goditjet që vijnë nga kushtet normale të transportit. Tubat kolektorë duhet të kenë të paktën të njëjtin presion prove me atë të bombolave. Për gazet e lëngëzuar toksikë, çdo enë nën presion duhet të ketë një valvul ndarëse, për të garantuar që çdo enë nën presion mund të mbushet veças dhe që gjatë ngarkimit, të mos mund të ndodhë ndërrimi i përmbajtjes, ndërmjet enëve nën presion gjatë transportit.

SHËNIM. Gazet e lëngëzuar toksikë kanë kodet e klasifikimit 2T, 2TF, 2TC, 2TO ose 2TOC.

3.1.6 Duhet të shmanget kontakti ndërmjet dy metaleve jo të ngjashëm, që mund të çojnë në dëmtim nga veprimi galvanik.

3.1.7 Kërkesa shtesë për ndërtimin e enëve kriogjenike, të mbyllura për gazet e lëngëzuara, në të ftohtë.

3.1.8 Vetitë mekanike të metalit të përdorur, duhet të caktohen për çdo enë nën presion, përfshirë qëndrueshmërinë në goditje dhe koeficientin e palosjes.

SHËNIM. Lidhur me qëndrueshmërinë në goditje, mund të përdoren metoda të provës të specifikuara në nënseksionin 2.5.3, të kapitullit 2, të këtij aneksi, që jep hollësi të kërkesave të provës.

3.1.9 Enët nën presion duhet të jenë të termoizoluara. Termoizolimi duhet të mbrohet nga përplasja me anën e një xhakete. Nëse hapësirës ndërmjet enës nën presion dhe xhaketës, i është hequr ajri (temoizolim me vakum), xhaketa duhet të projektohet për të përballuar pa deformim, një presion të jashtëm të paktën 100 kPa (1 bar), të llogaritur në përputhje me kodin teknik të njohur, ose një presioni kritik shkatërrimi në shtypje të paktën 200 kPa (2 bar), presion manometrik. Nëse xhaketa është e mbyllur, që të jetë hermetike ndaj gazit (p.sh. në rastin e termoizolimit me vakum), duhet të parashikohet një dispozitiv, për të përballuar çdo presion të dëmshëm, që mund të shfaqet në shtresën e izolimit, në rastin e hermeticitetit të pamjaftueshëm të enës nën presion dhe të këtyre pajisjeve. Ky dispozitiv duhet të pengojë futjen e lagështirës në izolim.

3.1.10 Enët kriogjenike të mbyllura, të destinuara për ngarkimin e gazeve të lëngëzuar në të ftohtë, që kanë pikë vlimi nën – 182 oC në presionin atmosferik, duhet të mos të përmbajnë materiale që mund të reagojnë me oksigjenin ose oksigjenin e atmosferave, të pasura me oksigjen në mënyrë të dëmshme, kur vendosen në enë.

3.1.11 Enët kriogjenike të mbyllura duhet të projektohen dhe të prodhohen, me sistem ngritje dhe balancimi të ngarkesës së përshtatshme.

3.1.12 Kërkesa suplementare të zbatueshme, për ndërtimin e enëve të transportueshme nën presion, për acetilen.

3.1.13 Enët e transportueshme nën presion për acetilenin, me numër të UN 1001, të tretur, dhe me numër të UN 3374, pa solvent, duhet të mbushen me një material poroz, të shpërndarë uniformisht, të një tipi që është konform me kërkesat dhe provat e specifikuara nga një autoritet kompetent dhe që:

a) Është i përshtatshëm për enën nën presion dhe nuk formon komponentë të dëmshëm, as me acetilenin, as me solventin në rastin e numrit të UN 1001;dhe

b) Është në gjendje të parandalojë përhapjen dhe dekompozimin e acetilenit në materialin poroz.

Në rastin e numrit të UN 1001, solventi duhet të jetë i përshtatshëm me enën e transportueshme nën presion.

3.2 Materialet

3.2.1 Materialet e ndërtimit të enëve të transportueshme nën presion dhe mbylljeve të tyre, që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me mallrat e rrezikshme, nuk duhet të ndryshojnë ose të dobësohen nga mallrat e rrezikshme, të cilat janë destinuar të mbajnë dhe të mos u shkaktojnë efekt të rrezikshëm, p.sh. reaksion katalize ose të hyjnë në veprim me mallrat e rrezikshme.

3.2.2 Enët e transportueshme nën presion dhe mbylljet e tyre, duhet të bëhen prej materialesh të specifikuara në projekt dhe në standardet teknike të ndërtimit dhe në instruksionin e ambalazhimit, që aplikohet për substancat e destinuara të mbahen në enën e transportueshme nën presion. Materialet duhet të jenë rezistente ndaj thyerjes së brishtë dhe nga plasaritja, nga korrozioni i lodhjes, si tregohet në projekt dhe në standardet teknike të ndërtimit.

3.3 Pajisjet e shërbimit

3.3.1 Ventilët, tubat lidhës dhe pajisjet e tjera që i nënshtrohen tensionit, përjashtuar valvulet e shkarkimit të presionit, duhet të projektohen dhe prodhohen në mënyrë të tillë që, presioni i shkatërrimit të jetë të paktën 1.5 herë të presionit të provës së enës së transportueshme nën presion.

3.3.2 Pajisjet e shërbimit duhet të konfigurohen ose projektohen për të parandaluar dëmtimin, që mund të rezultojë prej çlirimit të përmbajtjes së enës së transportueshme nën presion, gjatë kushteve normale të përdorimit dhe mbushjes. Pjesët e tubave kolektorë që lidhen me ventilët mbyllës, duhet të jenë fleksibël, në mënyrë të mjaftueshme për të mbrojtur ventilët dhe tubat nga dëmtimi i prerjes, ose çlirimi i përmbajtjes së enës së transportueshme nën presion. Ventilët e mbushjes dhe të shkarkimit dhe kapakët mbrojtës të jenë të sigurt nga hapja pa dashje. Ventilët duhet të jenë të mbrojtur siç specifikohet në 4.1.

3.3.3 Enët e transportueshme nën presion, që nuk mund të mbahen në dorë ose të rrokullisen, duhet të pajisen me dispozitivë (patina, unaza, rripa), për të garantuar që mund të mbahen me mjete mekanike dhe të manovrohen në mënyrë të tillë që mos dobësojnë, as të mos shkaktojnë sforcime të papranueshme në enën e transportueshme nën presion.

3.3.4 Çdo enë e transportueshme nën presion, duhet të pajiset me dispozitiv të shkarkimit të presionit, si specifikohet në dispozitat e ambalazhimit P200 (2), ose P205 të 4.1.4.1, ose në 1.3.6.4 dhe 1.3.6.5.

3.3.5 Enët e transportueshme nën presion, mbushja e të cilave përcaktohet nga volumi, duhen pajisur me një indikator niveli.

3.4 Miratimi i projektit të enëve të transportueshme nën presion

3.4.1 Konformiteti i enëve të transportueshme nën presion, duhet të vlerësohet në kohën e prodhimit siç kërkohet nga autoritetet kompetente. Enët e transportueshme nën presion duhen inspektuar, testuar dhe aprovuar nga një OM. Dokumentacioni teknik duhet të përfshijë specifikime të plota mbi projektimin dhe ndërtimin, si dhe dokumentacion të plotë në prodhim dhe testim.

3.4.2 Sistemet e sigurimit të cilësisë duhet të jenë konform me kërkesat e autoritetit kompetent.

3.5 Inspektimi fillestar dhe testimi

3.5.1 Enët e reja të transportueshme nën presion, ndryshe nga enët e mbyllura kriogjenike dhe sistemet e ruajtjes së metaleve hidride, duhet t'i nënshtrohen testimit dhe inspektimit përgjatë prodhimit dhe pas tij në fazën e përdorimit / shfrytëzimit, në përputhje me standardet e përdorura për projektimin dhe prodhimin e tyre, duke përfshirë:

a) testimi i karakteristikave të materialeve të ndërtimit;

b) verifikimi i trashësisë minimale të murit;

c) verifikimi i homogjenitetit të materialit të secilit grumbullim të prodhimit;

d) inspektimi i kushteve të brendshme dhe të jashtme të enëve të transportueshme nën presion;

e) inspektimi i fundit të qafës;

f) verifikimi i konformitetit me standardin e projektimit.

Për gjithë enët e transportueshme nën presion:

a) test të presionit hidraulik. Enët nën presion duhet t'i rezistojnë testit të presionit, pa shfaqur

zgjerim më të madh se ai i lejuar në specifikimet e projektimit;

Shënim. Në marrëveshje me autoritetin e miratimit të projektit, testi i presionit hidraulik mund të zëvendësohet nga një test që përdor gaz pasiv, i cili nuk shkakton rrezik zjarri.

b) inspektimi dhe vlerësimi i difekteve të prodhimit, si dhe riparimi i tyre ose nxjerrja jashtë funksionit e enës nën presion. Në rastin e enëve nën presion të salduara, duhet kushtuar vëmendje e veçantë cilësisë së saldimeve;

c) inspektim i shënimeve në enët nën presion;

d) për më tepër, enët e transportueshme nën presion që synojnë transportin e nr. UN 1001 acetilin e tretur, dhe nr. UN 3374 acetilin si tretës i lirë, duhen inspektuar në mënyrë që të garantohet instalimi i duhur dhe kushtet e materialit poroz dhe nëse është e aplikueshme, sasia e tretësit.

3.5.2 Në një kampion të përshtatshëm të enëvë kriogjene të mbyllura, duhet të kryhen inspektimet dhe testimet e specifikuara në paragrafët 1.5.1/a, "b", "d" dhe "f". Për më tepër, saldimet duhet të inspektohen nga metoda testimi pa shkatërrim, radiografike, ultratinguj etj., në një kampion të marrë nga enët kriogjene të mbyllura në përputhje me projektimin e aplikueshëm dhe standardin e ndërtimit. Ky inspektim saldimi nuk aplikohet për xhaketën termoizoluese.

Për më tepër, gjithë enët kriogjene të mbyllura duhet t'i nënshtrohen inspektimeve dhe testimeve të specifikuara në 1.5.1/g, "h", dhe "i", si dhe testit të rrjedhjeve të mundshme dhe testit të funksionimit të rregullt pas instalimit në bashkësinë përkatëse ku do të shërbejë pas montimit.

3.5.3 Për sistemet e depozitimit prej metaleve hidride, duhet verifikuar nëse aplikohen inspektimet dhe testimet e specifikuara në 1.5.1/a, "b", "c", "d", "e", "f", "g", "h", "i" dhe të jenë kryer në një kampion të përshtatshëm të enëve të përdorura në sistemin e ruajtjes së metalit hidrid. Për më tepër, në një kampion të përshtatshëm të sistemeve të ruajtjes së metaleve hidride, duhet të kryhen inspektimet dhe testimet e specifikuara në 1.5.1/c dhe "f", si dhe nëse aplikohet edhe 1.5.1/e, si dhe inspektimi i kushteve të jashtme të sistemit të depozitimit prej metali hidrid.

Përveç kësaj, gjithë sistemet e depozitimit të metaleve hidride duhet t'i nënshtrohen inspektimit fillestar dhe testimeve të përcaktuara në 1.5.1/h dhe "i", si dhe testit të rrjedhjeve të mundshme dhe testit të funksionimit të rregullt, pas instalimit në bashkësinë përkatëse, ku do të shërbejë pas montimit.

3.6 Inspektimi periodik dhe testimi

3.6.1 Enët nën presion të transportueshme që rimbushen, me përjashtim të enëve të transportueshme kriogjenike, duhet t'i nënshtrohen inspektimit periodik dhe testimeve nga një OM, për:

a) kontrollin e gjendjes së jashtme të enës nën presion të transportueshme dhe verifikimi i pajisjeve dhe markimeve të jashtme;

b) kontrollin e gjendjes së brendshme të enës nën presion të transportueshme (p.sh. shikimi i brendshëm, verifikimi i trashësisë minimale të mureve);

c) kontrolli i filetimeve të grykës nëse ka shenja korrozioni ose nëse aksesorët janë hequr;

d) prova e presionit hidraulik dhe në se është e nevojshme, verifikimi i karakteristikave të materialit me prova të përshtatshme;

e) kontrolli i pajisjeve të punës, si dhe aksesorëve dhe dispozitivëve të dekomprimimit nëse ka në përdorim.

Në marrëveshje me MIE, prova e presionit hidraulik mund të zëvendësohet me një provë me gaz, kur ky operacion nuk paraqet rrezik.

Në marrëveshje me autoritetin kompetent, prova e presionit hidraulik të bombolave ose tubave mund të zëvendësohet me një metodë ekuivalente, të mbështetur në kontroll me emetim akustik dhe një kontroll me ultratingull. Standardi SSH ISO 18119 "Bombola gazi – çelik i pastër dhe cilindrat dhe tubat e gazit aliazh alumini - Inspektimi periodik dhe prova."

Shpeshtësia e kontrolleve dhe provave periodike jepet nga instruksioni i ambalazhimit P 200, si vijon:

P200 INSTRUKSIONI I AMBALAZHIMIT P 200											
Tabela 2: GAZET E LËNGËZUARA DHE GAZET E TRETURA											
No UN	*Emri dhe përshkrimi*	Kodi i klasifikimit	CL50 (në ml/m3)	Bombola	Tuba	Fuçi nën presion	Bateri bombolash	Periodiciteti i provave në vite	Presioni i provës (në bar)	Shkalla e mbushjes	Dispozita të posaçme për ambalazhin
1005	AMONIAK ANHIDËR	2TC	4000	X	X	X	X	5	29	0,54	b, ra
1013	DYOKSID I KARBONIT	2A		X	X	X	X	10	190 250	0,68 0,76	ra ra
1018	KLOROPENTAFLUORETAN (GAZ FRIGORIFERËSH R 22)	2A		X	X	X	X	10	27	1,03	ra
1075	GAZ I NAFTËS I LËNGËZUAR	2F		X	X	X	X	5			v, z
1079	DYOKSID SQUFURI	2TC	2520	X	X	X	X	5	12	1,23	ra
1965	HIDROKARBURË TË GAZTË PËRZIERJE TË LËNGËZUAR, N.S.A.	2F		X	X	X	X	5			ra, ta, v, z
	Përzierja A							5	10	0.50	
	Përzierja A01							5	15	0.49	
	Përzierja A02							5	15	0.48	
	Përzierja A0							5	15	0.47	
	Përzierja A1							5	20	0.46	
	Përzierja B1							5	25	0.45	
	Përzierja B2							5	25	0.44	
	Përzierja B							10	25	0.43	
	Përzierja C							10	30	0.42	

Pajisjet e transportueshme nën presion, të prodhuara dhe vëna në përdorim/shfrytëzim përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të cilat përdoren për mbushje me GLN, të cilat nuk kanë dokumentacion shoqërues mbi origjinën, datën e prodhimit dhe futjes në treg, apo të pashoqëruara me markimin përkatës, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, i nënshtrohen inspektimit fillestar të vlerësimit të konformitetit dhe pajisen me markimin përkatës prej OM dhe janë subjekt i inspektimit periodik, çdo dy vjet.

3.6.2 Enët nën presion të projektuara për mbajtjen e nr. UN 1001, acetilin të shpërbërë dhe nr. UN 3374 pa tretës, duhen analizuar siç specifikohet në 1.6.1/a, "c" dhe "e". Përveç kësaj, duhet ekzaminuar gjendja e materialeve poroze, ku duhet të analizohen çarje, distanca e sipërme, hapësira dhe vendosja.

3.6.3 Ventilët e lëshimit të presionit për enët kriogjenike të mbyllura duhet t'i nënshtrohen inspektimeve dhe testimeve periodike.

3.7 Kërkesa për prodhuesit

Prodhuesit duhet të jenë të aftë teknikisht dhe duhet të zotërojnë gjithë burimet e kërkuara, për prodhimin e kënaqshëm të enëve nën presion. Kjo lidhet në veçanti me personelin e kualifikuar:

a) të mbikëqyrë gjithë procesin e prodhimit;

b) të kryejë bashkimin e materialeve; dhe

c) të kryejë testimet relevante.

3.8 Kërkesat për trupën inspektuese

Trupa inspektuese duhet të jetë e pavarur nga kompanitë e prodhimit, të tregtimit dhe të

mbushjes së pajisjeve të transportueshme nën presion dhe duhet të ketë kompetenca të plota teknike si në burime njerëzore, po ashtu në pajisjet e nevojshme për të kryer testimet dhe inspektimet, për të bërë të mundur lëshimin e certifikatave përkatëse të konformitetit.

4. KËRKESAT PËR ENËT E TRANSPORTUESHME NËN PRESION ME MARKIMIN UN

Përveç kërkesave të pikës 1, enët nën presion duhet të jenë në përputhje edhe me kërkesat e këtij kapitulli, përfshirë standardet e aplikueshme ndaj tyre.

4.1 Projektimi, ndërtimi, inspektimi fillestar dhe periodik

4.1.1 Standardet e paraqitura në tabelën e mëposhtme, specifikimet teknike apo standardet e barasvlershme me to, përdoren si referencë për projektimin, ndërtimin, inspektimin fillestar dhe periodik të bombolave, përveç kërkesave të tjera të inspektimit lidhur me sistemin e vlerësimit të konformitetit.

S SH EN ISO 9809-1:2010	Bombola gazi – Bombola gazi që rimbushen, prej çeliku të pa salduara – Projektimi, ndërtimi dhe prova – Pjesa 1:Bombolat prej çeliku të kalitur dhe të riardhur me rezistencë në tërheqje më të vogël se 1100 MPa
S SH EN ISO 9809-2:2010	Bombola gazi – Bombola gazi që rimbushen, prej çeliku të pa salduara – Projektimi, ndërtimi dhe prova – Pjesa 1:Bombolat prej çeliku të kalitur dhe të riardhur me rezistencë në tërheqje më të vogël se 1100 Mpa (ISO 9809-1:2010)
S SH EN ISO 9809-3:2010	Bombola gazi – Bombola gazi që rimbushen, prej çeliku të pa salduara – Projektimi, ndërtimi dhe testimi – Pjesa 3:Bombola çeliku të normalizuar (ISO 9809-3:2010)
S SH EN ISO 7866:2012	Bombola gazi – Bombola gazi që rimbushen, prej lidhje alumini të pa salduara - Projektimi, ndërtimi dhe prova
S SH ISO 4706:2008	Bombola gazi – Bombola gazi që rimbushen, prej çeliku të salduara – Presioni i provës 60 bar dhe poshtë këtij presioni
S SH ISO 18172-1:2007	Bombola gazi – Bombola gazi që rimbushen, prej çeliku inoksidabël të salduara – Presioni i provës 6 MPa dhe poshtë këtij presioni
S SH ISO 20703:2006	Bombola gazi – Bombola prej lidhje alumini të salduara dhe të transportueshme - Projektimi, ndërtimi dhe provat
S SH ISO 11118:2015	Bombola gazi – Bombola gazi metalike që nuk rimbushen – Specifikimi dhe metodat e provës
S SH ISO 11119-1:2002	Bombola gazi me konstruksion të përbërë – Specifikimi dhe metodat e provës – Pjesa 1: Bombolat e gazit të përbëra të veshura me mbështjellë
S SH ISO 11119-2:2002	Bombola gazi me konstruksion të përbëre – Specifikimi dhe metodat e provës – Pjesa 2: Bombola gazi të përbëra të përforcuara plotësisht me mbështjellë fibre, me këmishë metalike që kontribuon në mbajtjen e ngarkesës
S SH ISO 11119-3:2002	Bombola gazi me konstruksion të përbërë – Specifikimi dhe metodat e provës – Pjesa 3: Bombola gazi të përbëra të përforcuara plotësisht me mbështjellë fibre, me këmishë metalike që nuk kontribuon në mbajtjen e ngarkesës ose pa këmishë metalike

4.1.2 Për projektimin, ndërtimin dhe inspektimin fillestar, si dhe testin e bombolave aplikohet standardi i mëposhtëm:

S SH EN ISO 11120:2015 Bombola gazi – Tubat prej çeliku pa tegel saldimi që rimbushen, me kapacitet uji ndërmjet 150 l dhe 3000 l – Projektimi, konstruksioni dhe testimi.

Shënimi lidhur me faktorin F në seksionin 7.1 të këtij standardi, nuk aplikohet për bombolat me markimin UN.

4.1.3 Standardi në vijim aplikohet për projektimin, ndërtimin dhe për inspektimin fillestar, si dhe testimin e bombolave të acetilenit, përveç kërkesave të inspektimit, lidhur me konformitetin e sistemit të vlerësimit dhe aprovimit:

Për skeletin e bombolës:

S SH EN ISO 9809-1:2010 Bombola gazi – Bombola gazi prej çeliku të pa salduara, që rimbushen – Projektimi, ndërtimi dhe prova – Pjesa 1: Bombolat prej çeliku të kalitur dhe të riardhur, me rezistencë në tërheqje më të vogël se 1100 MPa.

S SH EN ISO 9809-3:2010 Bombola gazi – Bombola gazi prej çeliku të pa salduara, që

rimbushen – Projektimi, ndërtimi dhe testimi – Pjesa 3: Bombola çeliku të normalizuar.

Për materialin poroz në cilindër:

S SH EN ISO 3807:2013 Bombola gazi – Bombola acetileni – Kërkesat bazë dhe llojet e provave.

4.1.4 Standardi në vijim aplikohet për projektimin, ndërtimin dhe inspektimin fillestar të enëve nën presion kriogjenike UN, përveç se kërkesat e inspektimit lidhur me sistemin e vlerësimit të konformitetit dhe aprovimin, të cilat duhet të jenë në përputhje me pikën 2.5, më poshtë:

S SH ISO 21029-1:2004 Enët kriogjenike – Enët e transportueshme të termoizoluara me vakum, me vëllim jo më të madh se 1000 litra - Pjesa 1: Projektimi, fabrikimi, inspektimi dhe provat.

4.1.5 Standardi në vijim aplikohet për projektimin, ndërtimin dhe inspektimin fillestar, si dhe testimin e sistemeve të ruajtjes së metaleve hidride UN, përveç kësaj kërkesat e inspektimit lidhur me sistemin e vlerësimit të konformitetit dhe aprovimin, të cilat duhet të jenë në përputhje me pikën 2.5, më poshtë:

S SH ISO 16111:2008 Pajisjet ruajtëse të bombolave të gazit të transportueshme – Absorbimi i hidrogjenit në hidruret metalike të kthyeshme.

4.2 Materialet

Përveç kërkesave të materialit të specifikuara në projektimin e enës nën presion dhe standardeve të ndërtimit, apo çdo kufizim i specifikuar në paketën e aplikueshme të instruksioneve që duhet të paraqitet për gazin/et, që mund të përmbajë (p.sh. instruksionet e paketimit P200 ose P205 i 4.1.4.1), standardi në vijim aplikohet për përputhshmërinë e materialit:

S SH EN ISO 11114-1:2012 Bombola gazi të transportueshme – Përputhshmëria e materialeve të bombolës dhe valvulit me përmbajtjen e gazit – Pjesa 1: Materialet metalike.

S SH EN ISO 11114-2:2013 Bombola gazi – Përputhshmëria e materialeve të bombolës dhe valvulit me përmbajtjen e gazit – Pjesa 2: Materialet jometalike.

SHËNIM. Limitet e përcaktuara në S SH EN ISO 11114-1:2012 mbi lidhjen e lartë të çelikut, në nivelet përfundimtare të rezistencës gjatë tërheqjes deri në vlerën 1100 Mpa, nuk zbatohen për UN Nr. 2203 silan[2].

4.3 Pajisjet ndihmëse dhe aksesorët e sigurisë

Standardet në vijim aplikohen për inspektimin e pajisjeve mbyllëse dhe mbrojtjen e tyre:

S SH EN ISO 11117:2008/AC:2010	Bombola gazi – Kapakët (kapuçat) mbrojtës të valvuleve dhe mbrojtëset e valvuleve - Projektimi, ndërtimi dhe provat
S SH EN ISO 10297:2014	Bombola gazi të transportueshme – Ventilat e bombolave – Specifikimi dhe prova e tipit. *SHËNIM. Versioni EN i standardit ISO përmbush kërkesat dhe gjithashtu mund të përdoret si alternativë.*
S SH EN ISO 13340:2001	Bombolat që transportojnë gaz - Rubinetat për bombolat që nuk rimbushen - Specifikimet dhe provat e prototipit

Për pajisjet prej metaleve hidride UN, kërkesat e përmendura në standardin në vijim, aplikohen për pajisjet mbyllëse dhe mbrojtjen e tyre:

S SH ISO 16111:2008 Pajisjet ruajtëse të bombolave të gazit të transportueshme – Absorbimi i hidrogjenit në hidruret metalike të kthyeshme.

4.4 Inspektimet periodike dhe testimet

Standardet e paraqitura në tabelën e mëposhtme, aplikohen për inspektimin periodik dhe testimin e bombolave UN dhe pajisjet me hidrure metalore:

[2] Silan – një kompleks i pangjyrë i gaztë i përbërë prej silikonit dhe hidrogjenit që ka veti të forta reduktimi dhe është spontanisht i ndezshëm në ajër.

S SH ISO 6406: 2005	Bombola gazi - Bombola gazi prej çeliku të pa salduara – Inspektimi periodik dhe prova.
S SH ISO 10460:2005	Bombola gazi - Bombola gazi prej çeliku me karbon të salduara – Inspektimi periodik dhe prova. *SHËNIM. Riparimi i saldimeve të përshkruara në paragrafin 12.1 i këtij standardi nuk lejohet. Riparimet e përshkruara në paragrafin 12.2 kërkojnë aprovim prej autoritetit miratues për inspektimin periodik dhe testimin prej OM-së.*
S SH ISO 10461:2008	Bombola gazi - Bombola gazi prej lidhjesh alumini të pa salduara – Inspektimi periodik dhe prova
S SH EN ISO 10462:2013	Bombola gazi – Bombola acetileni – Inspektimi periodik dhe mirëmbajtja
S SH EN ISO 11623:2015	Bombola (cilindra) që transportojnë gaz – Inspektimi periodik dhe prova e përbërjes së bombolave të gazit
S SH ISO 16111:2008	Pajisjet ruajtëse të bombolave gazi të transportueshme – Absorbimi i hidrogjenit në hidruret metalike të kthyeshme.
S SH EN 1968:2002 + A1:2005 (përveç aneksit B)	Bombola gazi të transportueshme - Kontrolli dhe provat periodike të bombolave të gazit prej çeliku të pa salduara.
S SH EN 1802:2002 (përveç aneksit B)	Bombola gazi të transportueshme - Kontrollet dhe provat periodike të bombolave të gazit prej aliazhi të aluminit pa saldim.
S SH EN 1803:2002 (përveç aneksit B)	Bombola gazi të transportueshme - Kontrollet dhe provat periodike të bombolave të gazit prej çeliku me karbon të salduara.
S SH EN 14189:2003	Bombola që transportojnë gaz - Inspektimi dhe mirëmbajtja e valvuleve të bombolës në kohën e inspektimit periodik të bombolave të gazit
S SH EN ISO 22434:2011	Bombola gazi – Inspektimi dhe Mirëmbajtja e valvuleve
S SH EN 14876:2007	Bombolat e gazit - Kontrolli periodik dhe provat e fuçive nën presion prej çeliku të salduar
S SH EN 14912:2015	Pajisjet dhe aksesorët për GLN – Pajisjet dhe aksesorët për GLN – Inspektimi dhe mirëmbajtja e ventilave të bombolave në kohën e inspektimit periodik të bombolave
S SH EN 1440:2016 + A1:2018 (përveç anekseve G dhe H)	Pajisjet dhe aksesorët për GLN – Inspektimi periodik i bombolave të transportueshme të GLN që rimbushen

4.5 Sistemi i vlerësimit të konformitetit të enëve të transportueshme nën presion UN

4.5.1 Për qëllimin e kësaj pike:

Sistemi i vlerësimit të konformitetit nënkupton një sistem të miratimit të prodhimit prej MIE-së, duke aprovuar projektimin e llojit të pajisjes nën presion, aprovimin e sistemit të cilësisë të prodhuesit dhe miratimin e trupës inspektuese;

Lloj i projektimit do të thotë një dizajn i enës nën presion, siç specifikohet nga standardet përkatëse të projektimit të enës nën presion;

Verifikimi nënkupton konfirmimin nga ekzaminimi ose nga sigurimi i provave objektive, sipas të cilave kërkesat e specifikuara janë përmbushur.

4.5.2 Autoriteti kompetent, duhet të miratojë sistemin e vlerësimit të konformitetit për qëllimin e garantimit se enët e transportueshme nën presion, janë konform kërkesave përkatëse teknike.

Autoriteti kompetent duhet të publikojë të dhënat e trupës inspektuese të miratuar dhe numrin e identifikimit të saj, si dhe të dhënat e prodhuesit të cilit i është aprovuar projekti, për prodhimin e pajisjes nën presion.

Trupa inspektues OM duhet:

a) të ketë një staf me një strukturë organizative, të aftë, të trajnuar dhe kompetente për të kryer funksionet e veta, në mënyrë të kënaqshme teknike;

b) të ketë në dispozicion mjedisin, objektet dhe të zotërojë pajisjet e përshtatshme;

c) veprojë në mënyrë të paanshme dhe të jetë e lirë nga çdo ndikim, i cili mund të pengojë veprimin në mënyrë të paanshme;

d) të sigurojë konfidencialitetin komercial të aktiviteteve tregtare të pronarit prodhues dhe organeve të tjera;

e) të krijojë një sistem të cilësisë të dokumentuar;

f) të sigurojë kryerjen e testeve dhe inspektimeve të përcaktuara në standardin përkatës të enës nën presion; dhe

g) të mbajë një raport të efektshëm dhe të përshtatshëm të sistemit të të dhënave.

Trupa inspektues duhet të kryejë testimin e enës nën presion dhe inspektimin, si dhe certifikimin për të vërtetuar konformitetin me standardin përkatës të enës nën presion.

Laboratori testues i trupës inspektuese duhet të ketë:

a) staf me strukturë organizative, të mjaftueshëm në numër, kompetencë dhe aftësi; dhe

b) kushte të përshtatshme dhe pajisjet e duhura për kryerjen e testimeve, të kërkuara nga standardi i prodhimit për përmbushjen e kërkesave të trupës inspektuese.

4.6 Markimi i enëve nën presion UN rimbushëse

SHËNIM. Kërkesat për markimin e sistemeve të ruajtjes së metaleve hidride UN paraqiten në 2.9.

4.6.1 Enët nën presion rimbushëse UN, duhet të markohen në mënyrë të qartë dhe të lexueshme, me shenjat e certifikimit operacional dhe shenjat e prodhimit. Këto shenja duhet të jenë të vendosura në mënyrë të përhershme (p.sh. të stampuara ose të gdhendura) mbi enën nën presion. Shenjat duhet të jenë vendosur në krye ose në grykën e enës nën presion, ose në një përbërës të fiksuar të enës nën presion. Përveç simbolit të paketimit UN, përmasa minimale e shenjës duhet të jetë 5 mm për enët nën presion me diametër më të madh ose të barabartë me 140 mm dhe 2.5 mm për enët nën presion me diametër më të vogël se 140 mm. Përmasa minimale e simbolit të paketimit UN duhet të jetë 10 mm për enët nën presion me diametër më të madh ose të barabartë me 140 mm dhe 5 mm për enët nën presion me diametër më të vogël se 140 mm.

4.6.2 Duhet të aplikohen shenjat e certifikimit si në vijim:



Simboli i paketimit të Kombeve të Bashkuara (UN)

Ky simbol nuk duhet përdorur për asnjë qëllim tjetër përveç certifikimit që një paketim, një cisternë e lëvizshme ose një sistem seri cisternash, është në përputhje me kërkesat e ADR. Kjo shenjë ndiqet nga stampa e trupës inspektuese, data e inspektimit fillestar, viti (katërshifror), i ndjekur nga muaji (dyshifror), i ndarë nga fraksioni (p.sh. "/").

4.6.3 Shenjat operative që duhen përdorur në vijim:

a) testi i presionit në bar, i ndjekur nga germat "PH" dhe nga shkrimi "BAR";

b) masa e enës nën presion bosh duke përfshirë të gjitha pjesët e bashkangjitura në mënyrë të përhershme integrale (p.sh. unaza e grykës, unaza e fundit etj.) në kilogram, ndjekur nga germat "KG". Kjo masë nuk duhet të përfshijë masën e ventilëve, kapakëve të ventilëve ose mbrojtësve të ventilëve, çdo veshje ose material poroz për acetilenin. Masa duhet shprehur në tri shifra të rrumbullakosura në shifrën e fundit. Për bombolat më pak se 1 kg, masa duhet shprehur në dy shifra të përafruara në shifrën e fundit. Në rast të enëve nën presion për acetilen të tretur UN 1001 dhe acetilen UN 3374 si tretës i lirë, të paktën një pikë decimal dhe dy shifra për enët nën presion të cilat peshojnë më pak se 1 kg;

c) trashësia minimale e murit të enës nën presion në milimetra e ndjekur nga germat "MM". Kjo shenjë nuk kërkohet për enët nën presion me kapacitet uji më pak ose të barabartë me 1 litër ose për bombola të përbëra apo për enët kriogjenike të mbyllura;

d) në rastin e enëve nën presion për gazin e kompresuar acetilen UN 1001 i shpërbërë dhe për acetilen UN 3374 si tretës i lirë, presioni i punës do të tregohet në bar, e ndjekur nga germat "PË". Në rastin e enëve kriogjenike të mbyllura, presioni maksimal i lejuar i punës ndiqet nga germat "MAËP";

e) në rastin e enëve nën presion për gazin e lëngshëm dhe gazin likuid të ftohur, kapaciteti i ujit në litra shprehet në tri shifra duke rrumbullakosur shifrën e fundit, ndiqet nga germa "L". Nëse vlera e kapacitetit minimal ose nominal të ujit është numër i plotë, shifrat pas pikës së decimelit mund të neglizhohen;

f) në rastin e enëve nën presion për acetilen UN 1001 të shpërbërë, totali i masës së enës bosh, aksesorët dhe pjesët e pa hequra gjatë mbushjes, çdo veshje, materiali poroz, solvent dhe mbushja e gazit shprehet në tri shifra të përafruar me shifrën e fundit, e ndjekur nga germat "KG". Të paktën një decimal duhet të tregohet pas pikës së decimalit. Për enët nën presion prej më pak se 1 kg, masa duhet të shprehet me dy shifra të përafruara me shifrën e fundit;

g) në rastin e enëve nën presion për acetilen pa tretës UN 3374, totali i masës së enës bosh, aksesorët dhe pjesët e pa hequra gjatë mbushjes, çdo veshje dhe materiali poroz, shprehen në tri shifra të përafruara me shifrën e fundit, e ndjekur nga germat "KG".

4.6.4 Shenjat që duhen aplikuar në vijim:

a) identifikimi i diametrit të bombolës (p.sh. 25E). Kjo shenjë nuk kërkohet për enët kriogjenike të mbyllura;

b) shenja e regjistruar e prodhuesit nga autoriteti kompetent. Kur vendi i prodhimit nuk është i njëjtë me vendin e miratimit, atëherë shenja e prodhuesit duhet të paraprihet nga karakteristikat identifikuese të vendit të prodhimit siç tregohet nga shenjat dalluese për mjetet motorike në qarkullimin ndërkombëtar. Vendi i shenjës së vendosur dhe marka e prodhuesit duhen ndarë nga një hapësirë ose fraksion;

c) numri serial i përcaktuar nga prodhuesi;

d) në rastin e enëve nën presion prej çeliku dhe enëve nën presion të përbëra nga veshje çeliku të destinuara për mbajtjen e gazit me rrezik zbutjen e hidrogjenit, germa "H" tregon përputhshmërinë e çelikut (referuar S SH EN ISO 11114-1:2012).

4.6.5 Shenja më sipër duhet vendosur në tri grupe:

a) shenjat e prodhuesit duhet të jenë kryesorja dhe duhet të jenë të dukshme siç përshkruhet në 2.7.4;

b) shenjat operative në 2.7.3 duhet të jenë në mes të grupimit dhe testi i presionit (f) duhet të ndiqet nga presioni i punës (i) kur kërkohet;

c) shenjat e certifikimit duhet të jenë në krye të grupimit dhe duhet të jenë të dukshme në sekuencën e dhënë në 2.7.2.

Më poshtë paraqitet një shembull i shenjave të aplikuara në bombol



4.6.6 Shenja të tjera janë të lejueshme në pika të ulëta, përveç atyre në faqen anësore, duke marrë në konsideratë se ato duhet të jenë në përmasa të tilla që të mos shkaktojnë konfuzion. Në rastin e enëve kriogjenike të mbyllura, shenja të tilla mund të jenë vendosur në një anë të ndarë bashkëngjitur me veshjen e jashtme. Këto shenja nuk duhet të shkaktojnë problem me shenjat e kërkuara.

4.6.7 Çdo enë nën presion rimbushëse, e cila i nënshtrohet kërkesave të inspektimit periodik dhe të testimit, duhen markuar duke treguar:

a) Të dhënat e autorizimit për trupën që kryen inspektime periodike dhe testime.

b) Datën e inspektimit periodik dhe të testit, vitin (dyshifror), të ndjekur nga muaji (dyshifror), të ndarë nga fraksioni (p.sh. "/"). Mund të përdoren katër shifra për të treguar vitin.

4.6.8 Për bombola acetileni, me marrëveshjen e autoritetit kompetent, data e inspektimit periodik të fundit dhe vula e trupës, e cila kreu inspektimin periodik dhe testin, mund të gdhenden në një unazë të vendosur te ventilët e bombolës. Unaza duhet të jetë e tillë që të mund të hiqet vetëm duke shkëputur ventilin nga bombola.

4.6.9 Për pakot e bombolave, kërkesat e shenjave për enët nën presion duhen zbatuar vetëm për bombolat individuale dhe jo për çdo strukturë.

KAPITULLI II
KËRKESAT PËR CISTERNA TË TRANSPORTUESHME, TË VESHURA ME MBUROJË, SI DHE SERITË E CISTERNAVE E KONTEJNERËVE

Kërkesat e paraqitura më poshtë aplikohen si për kontejnerët e fiksuar, po ashtu për kontejnerët e çmontueshëm dhe pajisjet-bateri, për depozitat kontejner, për depozitat e ndërrimit dhe seritë e cisternave kontejner.

1. Kërkesat lidhur me cisternat automobilistike

1.1 Prodhimi

Rezervuarët e cisternave, lidhjet e tyre dhe pajisjet e punës dhe të strukturës, projektohen për t'i rezistuar pa humbje të përmbajtjes (me përjashtim të sasive të gazit që del nga hapjet e posaçme për degazim):

- sforcimeve statike dhe dinamike në kushtet normale të transportit;
- ngarkesave minimale të imponuara nga presioni i provës.

Cisternat, si dhe mjetet e tyre të fiksimit duhet të mund të mbajnë ngarkesën maksimale të lejuar, forcat e mëposhtme të barabarta me ato të ushtruara:

- në drejtimin e ecjes, dy herë masën totale;
- tërthor me drejtimin e ecjes, një herë masën totale;
- vertikalisht, nga poshtë lart, një herë masën totale;
- vertikalisht, nga lart poshtë, dy herë masën totale.

Paretet e rezervuarëve duhet të kenë të paktën trashësinë e përcaktuar nga formula:

$e = Pep\ D / 2\ \sigma\ \lambda$

ku:

e = trashësia minimale e rezervuarit në mm

Pep = presioni i provës në M Pa

D = diametri i brendshëm i enës në mm

σ = tensioni i lejuar në N/mm^2

λ = koeficient, më i vogël ose i barabartë me 1, që merr parasysh dobësimin eventual të bashkimeve me saldim, e lidhur me metodat e kontrollit.

Rezervuarët duhet të projektohen dhe prodhohen në përputhje me kërkesat dhe normat e një kodi teknik, të pranuar nga autoriteti kompetent, në të cilin për zgjedhjen e materialit dhe përcaktimin e trashësisë të rezervuarit, duhet të merren parasysh temperaturat maksimale dhe minimale të mbushjes dhe të punës.

Cisternat e destinuara për disa nga lëndët e rrezikshme duhet të pajisen me një mbrojtje. Kjo mund të konsistojë në një trashësi shtesë të rezervuarit (presioni i llogaritjes i rritur), të përcaktuar nga natyra e rreziqeve që paraqesin lëndët në fjalë dhe një dispozitiv mbrojtës.

Bashkimet me saldim duhet të realizohen sipas rregullave teknike dhe të japin të gjitha garancitë e sigurisë. Punimet e saldimit dhe kontrolli i tyre duhet të bëhen sipas kërkesave të standardeve përkatëse.

Duhet të merren masa për të mbrojtur rezervuarët nga rreziqet e deformimeve të shkaktuara nga depresioni i brendshëm. Rezervuarët e parashikuar të jenë të pajisur me

valvul depresioni, e cila mund t'i qëndrojë pa deformime mbetëse, presionit të jashtëm ndaj atij të brendshëm 21 kPa (0, 21 bar). Valvuli i depresionit duhet të tarohet për t'u hapur në një vlerë depresioni më të ulët, se ajo për të cilën është projektuar cisterna. Rezervuarët që nuk janë projektuar për t'u pajisur me një valvul depresioni, duhet të munden të durojnë një presion të jashtëm të paktën 0,4 bar ndaj presionit të brendshëm.

Fabrikuesi është i detyruar të analizojë rreziqet, me qëllim identifikimin e atyre që lidhen me këto pajisje për shkak të presionit. Ai e projekton dhe e ndërton këtë pajisje, duke pasur parasysh këtë analizë të tij.

Kërkesat thelbësore interpretohen dhe zbatohen, në mënyrë që të mbahet parasysh niveli i artizanatit dhe teknologjisë në kohën e projektimit dhe të prodhimit, si dhe faktorët teknikë dhe ekonomikë të pajtueshëm me një shkallë të lartë mbrojtje të shëndetit dhe sigurisë.

1.2 Materialet e prodhimit të cisternave automobilistike

Rezervuarët duhet të ndërtohen prej materialesh metalike të përshtatshme, që për intervale temperaturash të paparashikuara për klasën e fluidit, të jenë të pandjeshëm ndaj shkatërrimit dhe korrozionit me plasaritje nën sforcimin e një temperature ndërmjet –20 oC dhe + 50 oC.

Materialet e rezervuarëve ose veshjet e tyre mbrojtëse, në kontakt me përmbajtjen nuk duhet të kenë lëndë, që mund të reagojnë në mënyrë të rrezikshme me përmbajtjen, të formojnë produkte të rrezikshme ose të dobësojnë ndjeshëm materialin nën efektin e saj.

Nëse kontakti ndërmjet produktit që transportohet dhe materialit të përdorur për ndërtimin e cisternës, sjell një zvogëlim progresiv të trashësisë së rezervuarit, atëherë kjo duhet të zmadhohet që në ndërtim me një vlerë të përshtatshme. Shtesa e spesorit të korrozionit nuk merret në konsideratë kur bëhet llogaritja e trashësisë së rezervuarit.

Për rezervuarët e salduar duhet të përdoren vetëm materiale që saldohen shumë mirë dhe për të cilët vlera e viskozitetit dinamik garantohet për një temperaturë të ambientit –20oC, sidomos në bashkimet me saldim të zonave të lidhjes.

Në rastin e përdorimit të çelikut me granë të imët, vlera e garantuar e kufirit të elasticitetit Re nuk duhet të jetë më e lartë se 725 N/mm^2, sipas specifikimeve të materialit.

Për presionin e llogaritjes, kur G është e përcaktuar, zbatohen kërkesat që vijojnë:

a) rezervuarët që zbrazen me gravitacion të destinuar për transportin e lëndëve që në temperaturën 50°C, kanë presion avulli që nuk e kalon 1,1 bar (presion absolut), duhet të llogariten me presion sa dy herë presioni statik i lëndës që transportohet, duke mos qenë më i ulët se dyfishi i presionit statik të ujit;

b) rezervuarët me mbushje dhe zbrazje me presion, të destinuar për transportin e lëndëve, që në temperaturën 50°C kanë presion të avullit që nuk e kalon 1.1 bar (presion absolut), llogariten për një presion sa 1,3 herë presionin e mbushje–zbrazjes.

Kur vlera numerike e presionit minimal të llogaritjes tregohet (presion manometrik), rezervuari llogaritet sipas këtij presioni, pa qenë më i ulët se 1,3 herë presionin e mbushje-zbrazjes.

Në presionin e provës, sforcimi σ në pikën më të tensionuar të rezervuarit, duhet të jetë më i ulët ose i barabartë me kufijtë e vendosur më poshtë, në funksion të materialeve. Duhet të merret parasysh dobësimi i mundshëm në bashkimet me saldim.

Për të gjitha metalet dhe lidhjet sforcimi σ në presionin e provës, duhet të jetë më i ulët nga më e vogla nga vlerat e dhëna nga formulat që vijojnë:

$\sigma \leq 0{,}75$ Re ose $\sigma \leq 0{,}5$ Rm

ku:

Re = kufiri i elasticitetit për çeliqet me kufi elasticiteti të përcaktuar; ose

Kufiri i elasticitetit i garantuar në 0,2 % zgjatim për çeliqet pa kufi elasticiteti të përcaktuar.

Rm = rezistenca në shkatërrim në tërheqje.

Pjesët e tjera që saldohen në cisternë duhet të jenë prej materiali të pajtueshëm me atë të cisternës.

Materialet e saldimit duhet të jenë në gjendje të sigurojnë saldime të qëndrueshme me rezistencë minimale në tërheqje të paktën të barabartë me atë të materialit bazë të cisternës së përfunduar.

Prodhuesi i cisternës duhet të ketë dhe të paraqesë certifikatat e analizës së përbërjes dhe vetitë mekanike të cisternës.

Prodhuesi duhet të jetë në gjendje të identifikojë për çdo cisternë, çelikun me të cilin është prodhuar.

1.3 Realizimi dhe kontrolli i saldimeve

Kompetenca e prodhuesit të cisternës për të realizuar punimet e saldimit duhet të jetë e miratuar nga autoriteti kompetent. Punimet e saldimit duhet të realizohen nga personel i kualifikuar (patentuar), sipas një procedure saldimi (përfshirë trajtimin termik që mund të jetë i nevojshëm), cilësia e të cilit është demonstruar nga prova e procedurës. Kontrollet pa shkatërrim duhet të kryhen me radiografi ose me ultratingull dhe duhet të konfirmojnë që kryerja e saldimeve i korrespondon sforcimeve.

Duhet të kryhen kontrollet e mëposhtme, në përputhje me koeficientin λ, të përdorur për përcaktimin e trashësisë së mureve të rezervuarëve në pikën 2.2, të mësipërme:

λ = 0,8 Të gjithë tegelat e saldimit duhet të kontrollohen sa të jetë e mundur me sy, nga të dyja anët dhe t'i nënshtrohen një kontrolli pa shkatërrim, me sondazh. Të gjitha nyjat e saldimit dhe një gjatësi e tegelit, më e madhe ose e barabartë me 10 % të gjatësisë së përgjithshme të saldimeve gjatësore, rrethore dhe radiale (në fundet e cisternës) duhet të kontrollohen;

λ = 0,9 Të gjithë tegelat gjatësorë në të gjithë gjatësinë dhe tërësia e nyjave, tegelat rrethorë në përpjestim 25% dhe tegelat e montimit të pajisjes me diametër të rëndësishëm, duhet t'i nënshtrohen kontrolleve pa shkatërrim. Tegelat e saldimit duhet të verifikohen sa të jetë e mundur, në mënyrë vizuale nga të dyja anët;

λ = 1Të gjithë tegelat e saldimit duhet t'i nënshtrohen kontrolleve pa shkatërrim dhe duhet të verifikohen, sa të jetë e mundur në mënyrë vizuale nga të dyja anët. Duhet të bëhet një marrje mostre saldimi.

Kur ISHTI-ja ka dyshim për cilësinë e tegelave të saldimit, mund të urdhërojë kontrolle suplementare.

1.4 Pajisjet e punës

Për prodhimin e pajisjeve të punës dhe të strukturës mund të përdoren materiale të përshtatshme jometalike.

Pajisjet duhet të vendosen në mënyrë të tillë që të jenë të mbrojtura nga rreziqet e shkuljes ose të avarisë, gjatë transportit ose mirëmbajtjes. Duhet të jepen garanci sigurie të duhura dhe të njëjta, me atë të vetë rezervuarëve sidomos:

- të përshtaten me lëndët e transportuara;
- të plotësojnë kërkesat e projektimit.

Tubacionet duhet të projektohen dhe ndërtohen në mënyrë të tillë që, të shmanget çdo rrezik dëmtimi për shkak të sforcimeve termike, nga goditjet mekanike ose nga vibrimet.

Pjesa më e madhe e pajisjeve duhet të grupohet në një minimum vrimash në depozitë. Pajisjet e punës, përfshirë kapakun e hyrjes për inspektimin, duhet të mbeten hermetike, edhe në rast përmbysje të cisternës, pavarësisht nga forcat, sidomos nxitimet dhe presionit dinamik të përmbajtjes, të krijuar nga një goditje. Megjithatë, lejohet një humbje e lehtë e përmbajtjes për shkak të arritjes së pikut të presionit gjatë goditjes.

Bashkimet hermetike duhet të përbëhen nga materiale që përshtaten me lëndën e transportuar dhe të mund të zëvendësohen kur kompromentohet efikasiteti i tyre, p.sh., gjatë vjetrimit.

Bashkimet që sigurojnë hermeticitetin e organeve që manovrohen gjatë përdorimit normal të cisternës, duhet të projektohen dhe të vendosen në mënyrë të tillë që, manovrimi i organit të mos sjellë dëmtimin e tyre.

Çdo hapje në pjesën e poshtme të cisternës duhet të pajiset me të paktën dy mbyllje, të montuara në seri dhe të pavarura njëra nga tjetra, që përmbajnë:

- një ventil të jashtëm me tubacion prej materiali metalik që nuk deformohet; dhe
- një dispozitiv mbyllje në skajin e çdo tubacioni, që mund të jetë një tapë e filetuar, një flanxhë e plotë ose një dispozitiv ekuivalent. Ky dispozitiv duhet të jetë hermetik që të mos ketë humbje të përmbajtjes. Duhet të merren masa që në tubacion të mos ketë presion të mbetur, përpara se dispozitivi i mbylljes të jetë hequr plotësisht.

Çdo hapje në pjesën e poshtme për mbushjen dhe zbrazjen e cisternës, duhet të pajiset me të paktën tre mbyllës të montuar në seri dhe të pavarur nga njëri tjetri, që përmbajnë:

- një mbyllës të brendshëm, d.m.th, një mbyllës të montuar brenda rezervuarit ose në një flanxhë të salduar ose në kundër flanxhën e saj;

- një ventil të jashtëm ose një dispozitiv ekuivalent të vendosur në skajin e çdo tubacioni, gjithashtu mund të jetë i vendosur sa më afër rezervuarit; dhe

- një dispozitiv mbyllje në skajin e çdo tubacioni, që mund të jetë një tapë e filetuar, një flanxhë e plotë ose një dispozitiv ekuivalent. Ky dispozitiv duhet të jetë hermetik që të mos ketë humbje të përmbajtjes. Duhet të merren masa që në tubacion të mos ketë presion të mbetur, përpara se dispozitivi i mbylljes të jetë hequr plotësisht.

Mbyllësi i brendshëm duhet të mund të manovrohet nga lart ose nga poshtë. Në të dyja rastet, pozicioni i tij, hapur apo mbyllur, duhet që sa të jetë e mundur të mund të verifikohet nga toka. Dispozitivët e komandimit duhet të jenë të tillë që, të mos lejojnë asnjë hapje pa dashje nga efekti i goditjes, ose nga një veprim i pavullnetshëm.

Në rast avarie të dispozitivit të komandimit të jashtëm, mbyllja e brendshme duhet të mbetet efikase.

Me qëllim që të shmangen humbjet e përmbajtjes në rast avarie të organeve të jashtme (tubacione, organe anësore mbyllje), mbyllësi i brendshëm dhe sedia e tij duhet të jenë të mbrojtura nga rreziqet e shkuljes, nën efektin e sforcimeve të jashtme ose të projektuara me mbrojtëse. Organet e mbushjes dhe zbrazjes dhe kapakët mbrojtës duhet të jenë të siguruar nga çdo hapje e pavullnetshme.

Pozicioni ose kahu i mbylljes së ventilëve duhet të jetë i njëanshëm.

Hapjet e tjera të cisternës duhet të jenë vendosur mbi nivelin e lëngut. Cisternat nuk duhet të kenë tubacione ose degëzime mbi nivelin e lëngut. Megjithatë vrimat për pastrim lejohen në pjesën e poshtme të rezervuarit.

Cisternat që nuk janë të mbyllura hermetikisht mund të jenë të pajisura me valvul depresioni, për të shmangur presion të brendshëm negativ të papranueshëm: këto valvule depresioni duhet të tarohen në vlerën e depresionit, që të mos jetë më i lartë se ai i projektuari. Cisternat e mbyllura hermetikisht nuk duhet të kenë valvule depresioni.

Valvulet e depresionit dhe dispozitivët e ajrimit që përdoren në cisternat e destinuara për transportin e lëndëve, që për shkak të pikës së tyre të flakërimit i përgjigjen cisternave të klasës 3, duhet të mos lejojnë futjen e flakës në cisternë nëpërmjet një dispozitivi të posaçëm.

Nëse mbrojtja konsiston në flakëshuarëse ose ndaluese të flakës, këto duhet të vendosen sa më afër që të jetë e mundur me cisternën.

Rezervuari ose secila ndarje e tij, duhet të jenë të pajisura me hapje të mjaftueshme, për të mundësuar inspektimin.

Cisternat e destinuara për transportin e lëndëve të lëngëta, presioni i avullit të të cilave në 50°C nuk e kalon 1,1 bar (presion absolut), duhet të jenë të parashikuara me një dispozitiv ajrimi dhe një dispozitiv të përshtatshëm, për të penguar përmbajtjen të përhapet përjashta, nëse cisterna përmbyset.

Cisternat e destinuara për transportin e lëndëve të lëngëta, presioni i avullit të të cilave në 50°C është më i lartë se 1,1 bar (presion absolut) dhe me pikë vlimi më të lartë se 35°C, duhet të jenë të parashikuara me një valvul sigurie të rregulluar në presionin manometrik të paktën 1,5 bar dhe që të hapet plotësisht në presion, e shumta e barabartë me presionin e provës.

Cisternat e destinuara për transportin e lëndëve të lëngëta, me pikë vlimi deri në 35°C, duhet të jenë të parashikuara me një valvul sigurie të rregulluar në presionin manometrik deri 3 bar dhe që të hapet plotësisht në presion, e shumta e barabartë me presionin e provës.

Pjesët e lëvizshme, si: kapakët, dispozitivët e mbylljes etj., që mund të hyjnë në kontakt qoftë me fërkimet, ashtu dhe me përplasjet me cisterna alumini të destinuara për transportin e lëngjeve flakërues, pika e flakërimit të të cilëve nuk është më i lartë se 60°C ose gaze flakërues, nuk duhet të jenë prej çeliku inoksidabël të pambrojtura.

Nëse cisternat e konsideruara të mbyllura hermetikisht janë të pajisura me valvule sigurie, ato duhet të paraprihen nga një disk shkatërrimi. Në hapësirën ndërmjet diskut të shkatërrimit dhe valvulit të sigurisë duhet të ketë një manometër ose tregues tjetër, për të bërë të mundur zbulimin e shkatërrimit të diskut, një vrimë ose një shkarkim të diskut, për të mosrrezikuar efikasitetin e valvulit të sigurisë.

1.5 Kontrollet dhe provat

Rezervuarët dhe pajisjet duhet t'i nënshtrohen, qoftë të montuara, qoftë veç e veç, një kontrolli fillestar përpara vënies së tyre në punë. Ky kontroll përmban:

- verifikimin e tipit të miratuar;
- kontrollin e karakteristikave të prodhimit;
- inspektimin e brendshëm të cisternës;
- inspektimin e jashtëm të cisternës;
- prova e presionit hidraulik në presionin e treguar në targetë;
- prova e hermeticitetit për funksionimin e mirë të pajisjeve.

Prova hidraulike duhet të kryhet në tërësinë e rezervuarit dhe në çdo ndarje të rezervuarit me ndarje. Prova duhet të kryhet në çdo ndarje me presion të paktën të barabartë me 1.3 herë presionin minimal të punës.

Prova e presionit hidraulik duhet të kryhet përpara vënies në vend të termoizolimeve, kur janë të nevojshme.

Nëse rezervuarët dhe pajisjet e tyre janë të provuara të ndara, tërësia e montuar duhet t'i nënshtrohet pas montimit një prove hermeticiteti. Prova e hermeticitetit duhet të kryhet veças në çdo ndarje të rezervuarit me ndarje.

Rezervuarët dhe pajisjet e punës duhet t'i nënshtrohen kontrolleve periodike në afatet e rregulloreve.

Përveç rastit të klasës 2, presioni i provës së presionit hidraulik varet nga presioni i llogaritjes dhe duhet të mos jetë më i vogël se presionet e treguara në tabelë.

Rezervuarët dhe pajisjet e tyre duhet t'i nënshtrohen inspektimeve jo më vonë se çdo gjashtë vjet. Këto kontrolle periodike përmbajnë:

- një shqyrtim të gjendjes së brendshme dhe të jashtme;
- një provë hermeticiteti të rezervuarit me pajisjet e punës konform me 6.3, si dhe një verifikim të funksionimit të të gjitha pajisjeve;
- si rregull i përgjithshëm, një provë të presionit hidraulik (për presionin e provës që zbatohet në rezervuarët dhe ndarjet në raste të veçanta të shihet 6.1).

Mbështjellat e izolimit termik ose të tjera, duhet të hiqen në atë masë që është e nevojshme për vlerësimin e sigurt të karakteristikave të rezervuarit.

Cisternat dhe pajisjet e tyre duhet t'i nënshtrohen kontrolleve të ndërmjetme, çdo vit pas kontrollit fillestar dhe çdo kontrolli të mëtejshëm periodik.

Këto kontrolle të ndërmjetme përmbajnë një provë hermeticiteti të rezervuarit me pajisjet, si dhe një verifikim i funksionimit të mirë të të gjitha pajisjeve. Për këtë cisterna duhet t'i nënshtrohet një presioni efektiv të brendshëm, të paktën të barabartë me presionin maksimal të punës. Për cisternat e destinuara për transportin e lëngjeve ose të lëndëve të ngurta të pulverizuara ose të granuluara, kur ato realizohen me anën e një gazi, prova e hermeticitetit duhet të kryhet në një presion sa 25 % e presionit maksimal të punës. Në çdo rast, ai nuk duhet të jetë më i ulët se 0.2 bar (presion manometrik).

Për cisternat e pajisura me dispozitiv të nxjerrjes në atmosferë dhe një dispozitiv të përshtatshëm, për të penguar që përmbajtja të dalë jashtë nëse cisterna përmbyset, presioni i provës së hermeticitetit është i barabartë me presionin statik të lëndës që mbushet.

Prova e hermeticitetit duhet të kryhet veç për çdo ndarje të rezervuarëve me ndarje.

Kur siguria e cisternës ose e pajisjeve të saj mund të kompromentohet në vijim të riparimit, modifikimit ose aksidentit, duhet të kryhet një kontroll i veçantë i detajuar. Në rastet kur kryhet një kontrolli i tillë, atëherë konsiderohet si të ishte kontroll periodik.

Provat, kontrollet dhe verifikimet shoqërohen me një raport mbi rezultatet e këtyre inspektimeve edhe në rastin kur këto rezultate janë negative.

Një kopje e raportit duhet t'i bashkëlidhet dosjes së cisternës së testuar e inspektuar.

2. Kërkesa të veçanta të zbatueshme për klasën 2

Ndryshe nga kërkesat e mësipërme, kontrollet periodike të parashikuara më sipër duhet të bëhen:

a) çdo dy vjet për cisternat e destinuara për transportin e nr. UN 1079 dyoksid squfuri;

b) çdo tre vjet, për cisternat e destinuara për transportin e gazeve të lëngëzuara të ftohura.

Kur rezervuarët, aksesorët e tij, tubacionet e tij dhe pajisjet e tij të punës, i janë nënshtruar provës veçmas, cisterna mbas montimit duhet t'i nënshtrohet një prove hermeticiteti.

Në rastin e cisternave me termoizolim me vakum, prova e presionit hidraulik dhe verifikimi i gjendjes së brendshme, me pëlqimin e ekspertit të miratuar, zëvendësohen me një provë hermeticiteti dhe një matje të vakumit.

Nëse janë përdorur hapjet në momentin e vizitave periodike, në rezervuarët e destinuar për transportin e gazeve të lëngëzuara të ftohura, metoda për mbylljen hermetike, përpara se të rivihet në punë, duhet të miratohet nga eksperti i miratuar dhe duhet të garantojë integritetin e rezervuarit.

Provat e hermeticitetit për cisternat e destinuara për transportin e gazeve, duhet të kryhen nën një presion të paktën sa:

- për gazet e komprimuar, gazet e lëngëzuara ose gazet e tretura: 20% e presionit të provës; dhe
- për gazet e lëngëzuara të ftohura: 90% e presionit maksimal të punës.

2.1 Cisternat dhe pajisjet e tyre, qoftë së bashku, qoftë veç e veç, duhet t'i nënshtrohen një kontrolli fillestar para vënies së tyre në punë. Ky kontroll përmban:

- një verifikim të konformitetit të tipit të miratuar;
- një verifikim të karakteristikave të ndërtimit;
- një shqyrtim të gjendjes së brendshme dhe të jashtme;
- një provë të presionit hidraulik në presionin e provës të treguar në pllakën e identifikimit;
- një provë hermeticiteti dhe një verifikim të funksionimit të mirë të pajisjeve.

Përveç rastit të klasës 2, presioni i provës së presionit hidraulik, varet nga presioni i llogaritjes dhe duhet të mos jetë më i vogël se presionet e treguara në tabelë.

2.2.Cisternat dhe pajisjet e tyre duhet t'i nënshtrohen inspektimeve çdo 2 vjet.

Këto kontrolle periodike përmbajnë:

- një shqyrtim të gjendjes së brendshme dhe të jashtme;
- një provë hermeticiteti të rezervuarit me pajisjet e punës, si dhe një verifikim të funksionimit të të gjitha pajisjeve;
- si rregull i përgjithshëm, një provë të presionit hidraulik.

Mbështjellat e izolimit termik ose të tjera, duhet të hiqen në atë masë që është e nevojshme, për vlerësimin e sigurt të karakteristikave të rezervuarit.

2.3 Për cisternat e destinuara për transportin e lëngjeve ose të lëndëve të ngurta të pulverizuara, ose të granuluara, kur ato realizohen me anën e një gazi, prova e hermeticitetit duhet të kryhet në një presion sa 25% e presionit maksimal të punës. Në çdo rast, ai nuk duhet të jetë më i ulët se 0.2 bar (presion manometrik).

Për cisternat e pajisura me dispozitiv të nxjerrjes në atmosferë dhe një dispozitiv të përshtatshëm, për të penguar që përmbajtja të dalë jashtë nëse cisterna përmbyset, presioni i provës së hermeticitetit është i barabartë me presionin statik të lëndës që mbushet.

Prova e hermeticitetit duhet të kryhet veç për çdo ndarje të rezervuarëve me ndarje.

3. Dispozita të zbatueshme për të gjitha klasat

3.1 Përdorimi

3.1.1 Lëndët që i nënshtrohen ADR-së mund të transportohen me cisterna fikse (autobote) dhe cisterna të çmontueshme, vetëm nëse në ADR është parashikuar një kod–cisternë. Kodet e identifikimit janë të kompozuara nga germa ose numra, sipas një rregulli të caktuar. Tipi i korrespondon kërkesave të konstruksionit më pak të rrepta, që janë të pranueshme për lëndën në fjalë. Është e mundur të përdoren cisterna që i korrespondojnë kodeve që parashikojnë një presion minimal, llogaritje më të lartë ose kërkesa më të rrepta, për hapjet e mbushjes e të zbrazjes ose për valvulet/dispozitivët e sigurisë.

3.1.2 Cisternat mund të ngarkohen vetëm me lëndën për transportin e të cilave janë miratuar dhe që në kontakt me materialet e rezervuarit, hermetizuesve të bashkimeve, pajisjeve, si dhe veshjeve mbrojtëse, nuk ka rrezik të formojnë produkte të rrezikshme ose të dëmtojnë këto materiale në mënyrë të vlerësueshme.

3.1.3 Produktet ushqimore mund të transportohen në cisterna të përdorura për transportin e mallrave të rrezikshme, vetëm nëse janë marrë masat e nevojshme për të parandaluar çfarëdo cenimi të shëndetit publik.

3.1.4 Dosja e cisternës duhet të ruhet nga pronari ose përdoruesi i cisternës, që duhet të jenë në gjendje ta paraqesin këtë dokument, kur e kërkojnë autoritetet kompetente. Dosja e cisternës duhet të mbahet gjatë gjithë jetës së

cisternës dhe duhet të ruhet edhe 15 muaj, pasi cisterna është hequr nga përdorimi.

3.1.5 Në rast ndryshimi të pronarit ose përdoruesit të cisternës, dosja e cisternës duhet t'i transferohet pronarit ose përdoruesit të ri.

3.1.6 Kopje e dosjes së cisternës ose të gjithë dokumenteve të nevojshme, duhet të vihen në dispozicion të ekspertit për provat, kontrollet dhe verifikimet e cisternës, gjatë kontrolleve periodike ose jashtë radhe.

3.2 Shkalla e mbushjes

3.2.1 Në cisternat e destinuara për transportin e lëndëve të lëngëta në temperaturën e ambientit, nuk duhet të tejkalohen shkallët e mbushjes së mëposhtme:

a) Për lëndët e flakërueshme që nuk paraqesin rrezik tjetër (p.sh. toksicitet, korrozion), të ngarkuara në cisterna të pajisura me dispozitivë ajrimi ose valvule sigurie (edhe kur ato janë të paraprira nga një disk shkatërrimi):

Shkalla e mbushjes = 100 /1 + α (50 – tf) % të kapacitetit;

b) Për lëndët toksike ose korrozive (që paraqesin ose jo një rrezik flakërimi), të ngarkuara në cisterna të pajisura me dispozitivë ajrimi ose valvule sigurie (edhe kur ato janë të paraprira nga një disk shkatërrimi):

Shkalla e mbushjes = 98 /1 + α (50 – tf) % të kapacitetit;

c) Për lëndët e paflakërueshme, për lëndët që paraqesin një shkallë të vogël toksiciteti ose korrozioni (që paraqesin ose jo një rrezik flakërimi), të ngarkuara në cisterna të mbyllura hermetikisht, pa dispozitiv sigurie:

Shkalla e mbushjes = 97 /1 + α (50 – tf) % të kapacitetit;

d) Për lëndët shumë toksike ose toksike, shumë korrozive ose korrozive (që paraqesin ose jo një rrezik flakërimi), të ngarkuara në cisterna të mbyllura hermetikisht, pa dispozitiv sigurie:

Shkalla e mbushjes = 98 / 1 + α (50 – tf) % të kapacitetit;

3.2.2 Në këto formula, α paraqet koeficientin mesatar të bymimit vëllimor të lëngut ndërmjet 15°C dhe 50°C, pra për një ndryshim të temperaturës prej 35oC, α llogaritet me formulën:

α = d15 – d50 / 35 d50

Ku d15 dhe d50 janë masat vëllimore të lëngut në 15°C dhe 50°C dhe tF temperatura mesatare e lëngut në momentin e mbushjes.

3.2.3 Dispozitat e 2.2.1/a dhe "d" të mësipërme nuk zbatohen për cisternat, përmbajtja e të cilave gjatë transportit mbahet me një dispozitiv ngrohje në temperaturë më të lartë se 50°C. Në këtë rast, shkalla e mbushjes në nisje duhet të jetë e tillë dhe temperatura duhet të rregullohet në mënyrë të tillë që cisterna gjatë transportit, të mos jetë mbushur asnjëherë më shumë se 95% dhe që temperatura e mbushjes të mos tejkalohet.

3.2.4 Rezervuarët e destinuar për transportin e lëndëve në gjendje të lëngët, ose të gazit të lëngëzuar në të ftohtë, që janë të ndarë në seksione me kapacitet maksimal 7500 litra, me anën e mureve ndarës ose ndaluesit të përmbytjes, duhet të mbushen jo më shumë 80% ose të lihet të paktën 20% e kapacitetit të tyre.

3.3 Përdorimi

3.3.1 Trashësia e mureve të cisternës, gjatë gjithë përdorimit të saj, duhet të jetë më e madhe ose e barabartë me vlerën minimale të përcaktuar në projektimin e cisternës.

3.3.2 Gjatë mbushjes dhe zbrazjes së cisternës duhet të merren masat e duhura, për të penguar që të çlirohen sasi të rrezikshme të gazeve dhe avujve. Cisternat duhet të jenë të mbyllura në mënyrë të tillë që, përmbajtja të mos përhapet në mënyrë të pakontrolluar jashtë. Vrimat e cisternës me zbrazje nga poshtë, duhet të jenë të mbyllura në mënyrë të tillë që, tapat e filetuara dhe flanxhat qorre ose dispozitivëve të tjerë të veprojnë në mënyrë efikase. Hermeticiteti i dispozitivëve të mbylljes së cisternës duhet të verifikohet nga mbushësi, pas mbushjes së cisternës. Kjo zbatohet në mënyrë të veçantë në pjesën e sipërme të tubit zhytës.

3.3.3 Nëse disa sisteme mbyllje janë vendosur njëri pas tjetrit, ai që ndodhet më pranë lëndës që transportohet duhet të mbyllet në fillim.

3.3.4 Gjatë transportit asnjë mbetje e rrezikshme e lëndës që mbushet, nuk duhet të aderojë jashtë cisternës.

3.3.5 Lëndët që rrezikojnë të reagojnë në mënyrë të rrezikshme me njëra-tjetrën, nuk duhet të transportohen në ndarje të cisternës të ngjitura me njëra tjetrën.

Lëndët që rrezikojnë të reagojnë në mënyrë të rrezikshme me njëra tjetrën, mund të transportohen në ndarje ngjitur, me kusht që këto ndarje të veçohen nga një mur me trashësi sa trashësia e cisternës. Ato mundet, gjithashtu, të transportohen të ndara nga një hapësirë e zbrazët ose nga një ndaje bosh ndërmjet ndarjeve të ngarkuara.

3.4 Cisternat e zbrazëta, të papastruara

3.4.1 Gjatë transportit asnjë lloj mbetje e rrezikshme e lëndës së mbushjes nuk duhet të aderojë jashtë cisternës.

3.4.2 Cisternat e zbrazëta, të papastruara, që të mund të dërgohen, duhet të jenë të mbyllura në të njëjtën mënyrë dhe të paraqesin të njëjtën garanci hermeticiteti, si të ishin plot.

3.4.3 Kur cisternat e zbrazëta, të papastruara, nuk janë të mbyllura dhe nuk paraqesin të njëjtat garanci hermeticiteti si të ishin të mbushura dhe kur nuk mund të plotësohen kërkesat e ADR-së, ato duhet të transportohen në kushte të sigurisë së përshtatshme për në vendin më të afërt të përshtatshëm ku mund t'u bëhet pastrimi ose riparimi. Kushtet e sigurisë janë të përshtatshme nëse janë marrë masat e duhura, për të garantuar një siguri ekuivalente me atë që garantojnë dispozitat e ADR-së dhe, për të penguar humbjen e pakontrolluar të mallrave të rrezikshme.

3.4.4 Cisternat fikse (autobotet) dhe cisternat e çmontueshme të zbrazëta, të papastruara, mund të dërgohen pas mbarimit të afatit për inspektimin periodik për t'iu nënshtruar kontrolleve.

4. Dispozita të veçanta të zbatueshme për klasën 2

4.1 Kodimi i cisternave

Të katërta pjesët e kodeve (kode–cisternë) kanë kuptimet që vijojnë:

Pjesa	Përshkrimi	Kodi – cisternë
1	Tipi i cisternës	C = cisternë për gaz të komprimuar; P = cisternë për gaze të lëngëzuara ose të tretura; R = cisternë për gaze të lëngëzuara të ftohura.
2	Presioni i llogaritjes	X = vlerë me shifra e presionit minimal të provës, ose 22 = presioni minimal i llogaritjes në bar.
3	Hapjet	B = cisternë me hapje për mbushje dhe zbrazje nga poshtë me tri mbyllje; C = cisternë me hapje për mbushje dhe zbrazje nga lart me tri mbyllje, që poshtë nivelit të lëngut, ka vetëm vrima për pastrim; D = cisternë me hapje për mbushje dhe zbrazje nga lart me tri mbyllje pa vrima nën nivelin e lëngut.
4	Valvule/dispozitivë sigurie	N = cisternë me valvul sigurie që nuk është e mbyllur hermetikisht; H = cisternë e mbyllur hermetikisht.

4.2 Kushtet e mbushjes dhe presionet e provës

4.2.1 Presioni i provës i zbatueshëmn në cisternat e destinuara për transportin e gazeve të komprimuar duhet të jetë të paktën sa një herë e gjysmë, presionin e punës të përcaktuar për enët nën presion.

4.2.2 Presioni i provës që zbatohet në cisternat e destinuara për transportin e gazeve të lëngëzuara, në presion të lartë dhe të gazeve të tretura, duhet të jetë i tillë që, kur rezervuari të jetë mbushur në shkallën maksimale të mbushjes, presioni i lëndës, në 55°C për cisternat e pajisura me termoizolim ose 65°C për cisternat pa termoizolim, të mos kalojë presionin e provës.

4.2.3 Presioni i provës që zbatohet në cisternat e destinuara për transportin e gazeve të lëngëzuara në presion të ulët, duhet të jetë:

a) nëse cisterna është e pajisur me termoizolim, të paktën sa presioni i lëngut në 60°C, i zvogëluar me 1 bar, por jo më e vogël se 10 bar;

b) nëse cisterna nuk ka termoizolim, të paktën sa presioni i lëngut në 65°C, i zvogëluar me 1 bar, por jo më e vogël se 10 bar.

Masa maksimale e lejuar e përmbajtjes për litër të kapacitetit, llogaritet si vijon:

Masa maksimale e lejuar e përmbajtjes për litër të kapacitetit =0,95 x masa vëllimore e fazës së lëngët në 50 °C (në kg/l).

Veç kësaj, faza e avullit nuk duhet të zhduket nën 60°C.

Nëse diametri i rezervuarëve nuk është më i madh se 1,5 m, duhet të aplikohen vlerat e presionit të provës dhe të shkallës së mbushjes maksimale të instruksionit të ambalazhimit P 200.

4.2.4 Presioni i provës që zbatohet në cisternat e destinuara për transportin e gazeve të lëngëzuara shumë të ftohura nuk duhet të jetë më i ulët se 1,3 herë presionin e punës maksimal të autorizuar të treguar në cisternë, as më i ulët se 3 bar (presion manometrik); për cisternat e pajisura me izolim me vakum, presioni i provës nuk duhet të jetë më i ulët se 1,3 herë presionin e punës maksimal të autorizuar, të rritur me një bar.

4.2.5 Tabela e gazeve që mund të lejohen të transportohen në cisterna, me tregimin e presionit minimal të provës që zbatohet në cisterna dhe shkallën e mbushjes

Kur cisternat e destinuara të mbajnë gaze të komprimuar ose të lëngëzuar në presion të lartë, i nënshtrohen një presioni prove më të ulët se ai që figuron në tabelë dhe që cisternat janë të pajisura me termoizolim, eksperti i miratuar nga autoriteti kompetent mund të caktojë një masë maksimale më të ulët, me kusht që presioni i lëndës në cisternë në 55°C të mos tejkalojë presionin e provës, të incizuar në cisternë.

Nr. UN	Emri	Kodi i klasifikimit	Presioni minimal i provës për cisternat				Masa maksimale e lejuar e përmbajtjes për litër të kapacitetit
			me termoizolim		pa termoizolim		
			MPa	bar	MPa	bar	kg
1005	Amoniak anhidër	2TC	2,6	26	2,9	29	0,53
1009	Bromotrifluorometan (Gaz ftohës R13 B1)	2A	12	120			1,50
					4,2	42	1,13
					12	120	1,44
					25	250	1,60
1011	Butan	2F	1	10	1	10	051
1012	Butilen	2F	1	10	1	10	053
1013	Dioksid karboni	2A	19	190			0,73
			22,5	225			0,78
					19	190	0,66
					25	250	0,75
1017	Klor	2TOC	1,7	17	1,9	19	0,66
1018	Klorodifluorometan (Gaz ftohës R22)	2A	2,4	24	2,6	26	1,03
1020	Kloropentafluoretan (Gaz ftohës R115)	2A	2	20	2,3	23	1,08
1021	Kloro-tetrafluoro-1,2,2,2etan (Gaz ftohës R124)	2A	1	10	1,1	11	1,2
1022	Klorotrifluorometan (Gaz ftohës R13)	2A	12	120			0,96
			22,5	225			1,12
					10	100	0,83
					12	120	0,90
					19	190	1,04
					25	250	1,10

1028	Diklorofluorometan (Gaz ftohës R12)	2A	1,5	15	1,6	16	1,15
1029	Diklorofluorometan (Gaz ftohës R21)	2A	1	10	1	10	1,23
1030	Difluor-1,1 etan (Gaz ftohës R152a)	2A	1,4	140	1,6	160	0,79
1063	Klorur metili (Gaz ftohës R40)	2F	1,3	13	1,5	15	0,81
1070	Protoksid azoti	2O	22,5	225			0,78
					18	180	0,68
					22,5	225	0,74
					25	250	0,75
1079	Dioksid squfuri	2TC	1	10	1,2	12	1,23
1965	Hidrokarburë të gaztë në përzierje të lëngëzuar, si :	2F					
	përzierje A	2F	1	10	1	10	050
	përzierje A01	2F	1,2	12	1,4	14	0,49
	përzierje A02	2F	1,2	12	1,4	14	0,48
	përzierje A0	2F	1,2	12	1,4	14	0,47
	përzierje A1	2F	1,6	16	1,8	18	0,46
	përzierje B1	2F	2	20	2,3	23	0,45
	përzierje B2	2F	2	20	2,3	23	0,44
	përzierje B	2F	2	20	2,3	23	0,43
	përzierje C	2F	2,5	25	2,7	27	0,42

4.1 Përdorimi

4.1.1 Kur cisternat janë miratuar për gaze të ndryshme, ndryshimi i përdorimit duhet të përmbajë operacionet e zbrazjes, pastrimit dhe evakuimit në atë masë që të garantohet siguria e përdorimit.

4.1.2 Kur cisternat rivihen në transport, duhet të jenë të shikueshme vetëm tregimet e vlefshme për gazet që do të ngarkohen; të gjitha tregimet lidhur me gazet e tjera duhet të maskohen.

5. Dispozita të veçanta për klasën 3

5.1.1 Kodimi dhe përqasja optimale e cisternave

5.1.2 Kodimi i cisternave

Pjesa	Përshkrimi	Kodi – cisternë
1	Tipi i cisternës	L = cisternë për lëndë në gjendje të lëngët (lëndë të lëngëta ose lëndë të ngurta të vëna në transport në gjendje të shkrirë); S = cisternë për lëndë në gjendje të ngurtë (të pulverizuar ose të granuluar);
2	Presioni i llogaritjes	G = presioni minimal i llogaritjes sipas kërkesave të përgjithshme 1.5 ; 2.65 ; 4 ; 10 ; 15 ose 21= presioni minimal i llogaritjes në bar.
3	Hapjet	A = cisternë me hapje për mbushje nga poshtë dhe zbrazje nga poshtë me dy mbyllje; B = cisternë me hapje për mbushje dhe zbrazje nga poshtë me tri mbyllje; C = cisternë me hapje për mbushje dhe zbrazje nga lart me tri mbyllje, që poshtë

		nivelit të lëngut, ka vetëm vrima për pastrim; D = cisternë me hapje për mbushje dhe zbrazje nga lart me tri mbyllje pa vrima nën nivelin e lëngut.
4	Valvule/ dispozitivë sigurie	V = cisternë me dispozitiv ajrimi, pa dispozitiv të mbrojtjes nga përhapja e flakës; ose cisternë që nuk i reziston presionit të prodhuar nga një eksplozion; F = cisternë me dispozitiv ajrimi, e pajisur me një dispozitiv mbrojtës ndaj përhapjes së flakës; ose cisternë që i reziston presionit të prodhuar nga një eksplozion N = cisternë pa dispozitiv sigurie dhe që nuk është e mbyllur hermetikisht; H = cisternë e mbyllur hermetikisht.

5.1.3 Përqasja optimale për të bërë caktimin e kodeve cisternë me grupet e lëndëve
Përqasja optimale

Kodi – cisternë	Grupi i lëndëve të autorizuara		
	Klasa	Kodi i klasifikimit	Grupi i ambalazhit
LIQUIDES LGAV	3	F2	III
LGBF	3	F1	II Presioni i avullit në 50 °C ≤ 1,1 bar
		F1	III
		D	II Presioni i avullit në 50 °C ≤ 1,1 bar
		D	III
	Po kështu grupet e lëndëve të autorizuara për kodet cisternë LGAV dhe LGBV		
L1.5BN	3	F1	II Presioni i avullit në 50 °C > 1,1 bar
		F1	III Pika e flakërimit < 23 °C, viskoz Presioni i avullit në 50 °C > 1,1 bar Pika e vlimit > 35 °C
		D	II Presioni i avullit në 50 °C > 1,1 bar
	Po kështu grupet e lëndëve të autorizuara për kodet cisternë LGAV dhe LGBV dhe LGBF		
L4BN	3	F1	I, III pika e vlimit ≥ 35 °C
		FC	III
		D	I
L4BH	3	FT1	II, III
		FT2	II
		FC	II
		FTC	II
L10CH	3	FT1	I
		FT2	I
		FC	I
		FTC	I
L15CH	3	FT1	I

5.2 Dispozita të përgjithshme

5.2.1 Në rastin e mbushjes së lëndëve të ngrohta, temperatura e sipërfaqes së jashtme të cisternës ose e termoizolimit nuk duhet të kalojë 70oC, gjatë transportit.

5.2.2 Tubat e lidhjes ndërmjet cisternave të pavarura, të lidhura me njëra-tjetrën në një njësi transporti, duhet të jenë të zbrazët gjatë transportit. Tubat fleksibël të mbushjes dhe të zbrazjes që nuk janë të lidhur në mënyrë të përhershme me cisternën, duhet të jenë të zbrazët gjatë transportit.

6. Referencat në standardet e harmonizuara

Standardet e paraqitura në tabelën vijuese shërbejnë si referencë bazë për projektimin dhe ndërtimin e cisternave fikse, cisternave të lëvizshme dhe cisternave të montuara në automjete (autocisterna).

Referencë	Titulli i dokumentit
Për gjithë cisternat	
S SH EN 14025:2013 + A1:2016	Cisternat për transportimin e mallrave të rrezikshme – Rezervuarët metalikë në presion – Projektimi dhe prodhimi
S SH EN 14025:2013+A1:2016	Cisternat për transportimin e mallrave të rrezikshme – Rezervuarët metalikë në presion – Projektimi dhe prodhimi
S SH EN 14432:2014	Cisternat për transportimin e mallrave të rrezikshme – Pajisje tank për transportin e kimikateve të lëngëta dhe gazeve të lëngshme – Shkarkimi i produktit dhe valvulet hyrëse të ajrit
S SH EN 14433:2014	Cisternat për transportimin e mallrave të rrezikshme – Pajisje tank për transportin e kimikateve të lëngëta dhe gazeve të lëngshme – Valvulet fundore
S SH EN 13094:2015	Cisternat për transportimin e mallrave të rrezikshme – Cisternat metalike që punojnë në presion më të vogël se 0.5 bar – Projektimi dhe ndërtimi
Për cisternat e gazit të kategorisë 2	
S SH EN 12493:2013 + A1:2014	Pajisjet dhe aksesorët për GLN – Enët nën presion prej çeliku të salduara për autocisternat e GLN
S SH EN 12493:2013 + A1:2014	Pajisjet dhe aksesorët për GLN – Enët nën presion prej çeliku të salduara për autocisternat e GLN
S SH EN 12493:2013 + A1:2014	Pajisjet dhe aksesorët për GLN – Enët nën presion prej çeliku të salduara për autocisternat e GLN
S SH EN 12252:2014	Pajisjet dhe aksesorët e GLN – Pajisjet për cisternat rrugore të GLN-së
S SH EN 13530-2:2002	Enët kriogjenike – Enët e mëdha të transportueshme, të izoluara në vakum – Pjesa 2: Projektimi, fabrikimi, inspektimi dhe prova.
S SH EN 13530-2:2002 + A1:2004	Enët kriogjenike – Enët e mëdha të transportueshme, të izoluara në vakum – Pjesa 2: Projektimi, fabrikimi, inspektimi dhe prova.
S SH EN 14398-2:2003+A2:2008 (përveç Tabelës 1)	Enë tejftohëse - Enë të mëdha transportuese të izoluara pa vakum - Pjesa 2: Projekti, prodhimi, inspektimi dhe prova.

Për cisternat e mbajtjes së produkteve të lëngshme dhe substancave të tjera të rrezikshme të Kategorisë 3, të cilat kanë presion avullimi jo më shumë se 110 kPa, në 50oC dhe naftë, aplikohen standardet e mëposhtme.

S SH EN 13094:2015	Cisternat për transportimin e mallrave të rrezikshme – Cisternat metalike që punojnë në presion më të vogël se 0.5 bar – Projektimi dhe ndërtimi
S SH EN 13082:2008 +A1:2012	Cisternat për transportimin e mallrave të rrezikshme – Pajisjet e shërbimit për cisternat – Valvulet për mbledhjen (rikuperimin) e avujve.
S SH EN 13308:2002	Cisternat për transportimin e mallrave të rrezikshme – Pajisjet e shërbimit për cisternat – Valvulet fundore me presion të pabalancuar
S SH EN 13314:2002	Cisternat për transportimin e mallrave të rrezikshme – Pajisjet e shërbimit për cisternat – Mbulesa e vrimës së mbushjes
S SH EN 13316:2002	Cisternat për transportimin e mallrave të rrezikshme – Pajisjet e shërbimit për cisternat – Valvulet fundore me presion të balancuar
S SH EN 13317:2002 + A1:2006 (përveç figurës dhe tabelës në Aneksin B) (Materiali duhet të plotësojë kërkesat e standardit S SH EN 13094: 2004, Pika 5.2)	Cisternat për transportimin e mallrave të rrezikshme – Pajisjet e shërbimit për cisternat – Kapaku i futjes së njeriut.
S SH EN 13317:2002 + A1:2006	Cisternat për transportimin e mallrave të rrezikshme – Pajisjet e shërbimit për cisternat – Kapaku i futjes së njeriut
S SH EN 14595:2016	Cisternat për transportin e mallrave të rrezikshme – Pajisjet e punës për cisternat – Vrimat e ventilëve të presionit dhe vakumit.

Standardi i treguar si referencë më poshtë, zbatohet për inspektimin dhe testimin e cisternave për të përmbushur kërkesat e zbatueshme të sigurisë, të referuara në këtë rregull teknik. Përdorimi i këtij standardi është i detyrueshëm.

S SH EN 12972:2015 – Cisternat për transportimin e mallrave të rrezikshme – Provat, inspektimi dhe markimi i cisternave metalike.

S SH EN 13807:2003 – Bombola (cilindra) që transportojnë gaz – Mjete transporti me bateri – Projektimi. prodhimi. identifikimi dhe prova.

S SH EN 1252-1:1998 – Enët kriogjenike - Materialet – Pjesa 1: Kërkesat e qëndrueshmërisë në temperaturat nën -80°C.

S SH EN 1252-2:2001 – Enët kriogjenike - Materialet – Pjesa 1: Kërkesat e qëndrueshmërisë në temperaturat ndërmjet -80°C dhe -20°C.

7. Kërkesa të veçanta

Për lëndët që në tabelën A të kapitullit 3.2 të ADR, në kolonën 13 kanë të shënuar kodin alfanumerik të paraprirë nga germat TT (tank test), zbatohen kërkesat shtesë që vijojnë:

TT1 Cisternat prej alumini të pastër duhet t'i nënshtrohen provave të presionit hidraulik, fillestare dhe periodike, vetëm në 2.5 bar (presion manometrik).

TT2 Gjendja e veshjes së rezervuarëve duhet të inspektohet çdo vit nga një trupë inspektuese, që duhet të inspektojë brenda rezervuarit.

TT3 Ndryshe nga kërkesat e pikës 1, inspektimet periodike duhet të kryhen të paktën çdo katër vjet dhe duhet të përshijnë kontrollin e trashësisë duke përdorur instrument të përshtatshëm. Për këto cisterna provat e hermeticitetit duhet të kryhen të paktën çdo dy vjet.

TT5 Provat e presionit duhet të kryhen të paktën çdo vit.

TT6 Provat periodike, përfshirë provën e presionit hidraulik, duhet të kryhen të paktën çdo vit.

TT7 Inspektimi periodik i brendshëm mund të zëvendësohet me një program të miratuar nga autoriteti kompetent.

TT8 Krahas inspektimit të përcaktuar më sipër, duhet t'i nënshtrohen kontrollit edhe me grimca magnetike.

TT9 Inspektimet duhet të kryhen vetëm nga OM-ja.

TT10 Inspektimet periodike sipas 1.2 duhet të bëhen të paktën çdo vit.

VENDIM
Nr. 437, datë 26.6.2019

PËR KRITERET E LICENCIMIT TË VEPRIMTARIVE TË PËRPUNIMIT INDUSTRIAL TË DUHANIT DHE/OSE PRODHIMIT TË PRODUKTEVE TË DUHANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 14, të ligjit nr. 8691, datë 16.11.2000, "Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Me qëllim përcaktimin e kritereve për licencimin e veprimtarive të përpunimit industrial të duhanit dhe/ose prodhimit të produkteve të duhanit sipas standardeve të përshtatshme të cilësisë, synohet mbrojtja e shëndetit të konsumatorit dhe përmirësimi i teknologjisë në rritjen e cilësisë së produktit përfundimtar.

2. Me qëllim lehtësimin e zbatimit të këtij vendimi, për referencë do të përdoren përkufizimet e dhëna në ligjin nr. 8691, datë 16.11.2000, "Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve", ligjin nr. 10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", vendimin nr.538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", si dhe akronimet:

- MBZHR – Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- QKB – Qendra Kombëtare e Biznesit;
- AKDC – Agjencia Kombëtare e Duhan-Cigareve.

Veprimtaritë "Përpunim industrial i duhanit" dhe "Prodhim i produkteve të duhanit" përfshihen në grupin e tretë të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", në kategorinë II. 5. C, aneksi 1, dhe vendimin nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet

Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta".

Licencimi i veprimtarive "Përpunim industrial duhani" dhe "Prodhim i produkteve të duhanit" bëhet sipas legjislacionit për licencat. Licenca u jepet subjekteve që plotësojnë kushtet tekniko-teknologjike për përpunimin industrial të duhanit dhe/ose prodhimin e produkteve të duhanit. Verifikimi i kushteve tekniko-teknologjike kryhet nga AKDC-ja, me urdhër të ministrit përgjegjës për bujqësinë.

3. Përpunimi industrial i duhanit mund të kryhet nga një subjekt që vërteton se plotëson kushtet, si më poshtë vijon:

3.1 Kritere të përgjithshme

a) të jetë i pajisur me ekstrakt tregtar, me objekt veprimtarie "Përpunim industrial duhani";

b) të vërtetohet nga organet tatimore pagesa e kontributeve shoqërore të jo më pak se 20 punonjësve me kohë të plotë, gjatë vitit të fundit kalendarik;

c) të vërtetohet nga organet e drejtësisë që nuk është i ndjekur penalisht.

3.2. Kritere teknike

a) të ketë të punësuar teknolog me arsim të lartë, diplomuar në teknologji ushqimore;

b) zotëron ambiente të përshtatshme, jo më pak se 500 m^2, për magazinimin e duhanit të grumbulluar, përpunimin industrial, klasifikimin dhe magazinimin e duhanit të përpunuar, fermentimin natyral (vjetërsimin), të vërtetuara me dokumente pronësie apo me kontratë qiraje/huapërdorjeje me kohëzgjatje jo më pak se 5 vjet;

c) depoziton planimetri të ambienteve të magazinimit, përpunimit dhe klasifikimit të duhanit;

ç) disponon laborator analizash ose ka kontratë me një laborator vendas ose të huaj për vlerësimin e duhanit.

d) disponon mjete transporti në pronësi ose marrëveshje përdorimi me kapacitet jo më pak se 2 tonë, të mbuluara, të përshtatshme për transportin e gjetheve të duhanit.

dh) disponon pajisje të përshtatshme për përpunimin industrial të duhanit, jo më pak se 1 000 kg në ditë, në varësi të llojeve të duhanit që do të përpunojë, si më poshtë vijon:

i. dhomë vakuumi;

ii. transportierë klasifikimi;

iii. eliminues materialesh joduhanore, më të rënda dhe më të lehta se duhani;

iv. dhomë fermentimi;

v. furra për tharjen dhe fermentimin industrial të certifikuar;

vi. presë për presimin e duhanit;

vii. pajisje për kontrollin e lagështisë dhe të temperaturës së duhanit dhe ambientit ku përpunohet;

viii. përshkrim të teknologjisë së zbatuar.

Lista e pajisjeve, shoqëruar me foto, dhe treguesit teknikë shoqërohen edhe me planvendosjen e pajisjeve dhe përshkrimin e karakteristikave të tyre, përshkrimin e teknologjisë së zbatuar, ku të përfshihen lëndët e para dhe ndihmëse, karakteristikat kryesore të tyre, standardi me të gjithë treguesit cilësorë të sigurisë, që është në fuqi, ambalazhimi dhe etiketimi.

4. Prodhim i produkteve të duhanit mund të kryhet nga një subjekt që vërteton se plotëson kushtet, si më poshtë vijon:

4.1 Kritere të përgjithshme

a) të jetë i pajisur me ekstrakt tregtar, me objekt veprimtarie "Prodhim i produkteve të duhanit";

b) të vërtetohet nga organet tatimore që s'ka detyrime dhe/ose nuk është në proces falimenti;

c) të vërtetohet nga organet tatimore pagesa e kontributeve shoqërore të jo më pak se 15 punonjësve me kohë të plotë, gjatë vitit të fundit kalendarik;

ç) të vërtetohet nga organet e drejtësisë që nuk është i ndjekur penalisht.

4.2. Kritere teknike

a) të ketë të punësuar teknolog me arsim të lartë, diplomuar në teknologji ushqimore;

b) disponon ambiente të përshtatshme, jo më pak se 500 m2 për magazinimin e duhanit të grumbulluar, përpunimin industrial, klasifikimin dhe magazinimin e duhanit të përpunuar, fermentimin natyral (vjetërsimin), të vërtetuara me dokumente pronësie apo me kontratë qiraje me kohëzgjatje jo më pak se 5 vjet;

c) depoziton planimetri të ambienteve të magazinimit, përpunimit, prodhimit dhe klasifikimit të duhanit;

ç) disponon laborator analizash të vetin ose ka kontratë me një laborator vendas ose të huaj për vlerësimin e produkteve të duhanit;

d) disponon linjë përpunimi duhani në pronësi ose marrëveshje përdorimi, si më poshtë vijon:

i. të përshtatshme për prodhimin e duhanit, jo më pak se 1 000 kg në orë;

ii. dhomë vakuumi;

iii. cilindër për kondicionimin dhe shtimin e lëngjeve;

iv. cilindër zbutës;

v. cilindër tharjeje dhe aromatizues;

vi. transportierë klasifikimi;

vii. eliminues materialesh joduhanore, më të rënda dhe më të lehta se duhanit;

viii. silose përzierjeje;

ix. silose për ruajtjen e duhanit të grirë;

x. dhomë fermentimi;

xi. furra për tharjen dhe fermentimin industrial;

xii. makinë grirjeje;

xiii. makinë paketimi;

xiv. presë për presim duhani;

xv. pajisje për kontrollin e lagështisë dhe temperaturës së duhanit dhe të ambienteve ku prodhohet;

Lista e pajisjeve, shoqëruar me foto, dhe treguesit teknikë shoqërohen edhe me planvendosjen e pajisjeve dhe përshkrimin e karakteristikave të pajisjeve, përshkrimin e teknologjisë së zbatuar, ku të përfshihen lëndët e para dhe ndihmëse, karakteristikat kryesore të tyre, produkti i gatshëm dhe karakteristikat kryesore të tij, standardi, me të gjithë treguesit cilësorë të sigurisë që është në fuqi, ambalazhimi, etiketimi, ruajtja dhe transporti i produkteve të gatshme, afatet e garancisë dhe jetëgjatësisë së produktit, data e prodhimit.

5. Prodhim duhan nargjile (shisha) mund të kryhet nga një subjekt që vërteton se plotëson kushtet tekniko-teknologjike, si më poshtë vijon:

5.1 Kritere të përgjithshme

a) të jetë i pajisur me ekstrakt tregtar, me objekt veprimtarie "Prodhim i produkteve duhanit";

b) të vërtetohet nga organet tatimore që s'ka detyrime dhe/ose nuk është në proces falimenti;

c) të vërtetohet nga organet tatimore pagesa e kontributeve shoqërore të jo më pak se 4 punonjësve me kohë të plotë, gjatë vitit të fundit kalendarik.

5.2 Kritere teknike

a) të ketë të punësuar teknolog me arsim të lartë, diplomuar në teknologji ushqimore;

b) disponon ambiente të përshtatshme, jo më pak se 300 m2, për magazinimin e duhanit të grumbulluar, të vërtetuara me dokumente pronësie apo me kontratë qiraje me kohëzgjatje jo më pak se 5 vjet;

c) depoziton planimetri të ambienteve të magazinimit, përpunimit, prodhimit dhe klasifikimit të duhanit;

ç) disponon laborator analizash të vetin ose ka kontratë me një laborator vendas ose të huaj për vlerësimin e duhanit;

d) disponon mjete transporti në pronësi ose në marrëveshje përdorimi;

dh) disponon linjë të përshtatshme për prodhimin e duhanit nargjile (shisha) jo më pak se 150 kg në orë;

e) disponon larëse për heqjes e mbetjeve të duhanit;

ë) disponon cilindër përzierës të duhanit me ngrohje;

f) zotëron enë përzierëse me ngrohje për shkrirjen e glukozës;

g) zotëron enë përzierëse me ngrohje për shkrirjen e glicerinës;

gj) disponon enë përzierëse për aromat;

h) disponon enë përzierëse për harmonizimin e duhanit me aromat;

i) zotëron transportierë;

j) zotëron makinë grirjeje;

k) zotëron makinë paketimi;

l) disponon pajisje për kontrollin e lagështisë dhe temperaturës.

Lista e pajisjeve, shoqëruar me foto, dhe treguesit teknikë shoqërohen edhe me planvendosjen e pajisjeve dhe përshkrimin e karakteristikave të pajisjeve, përshkrimin e teknologjisë së zbatuar, ku të përfshihen lëndët e para dhe ndihmëse, karakteristikat kryesore të tyre, produkti i gatshëm dhe karakteristikat kryesore të tij, standardi, me të gjithë treguesit cilësorë të sigurisë që është në fuqi, ambalazhimi, etiketimi, ruajtja dhe transporti i produkteve të gatshme, afatet e garancisë dhe jetëgjatësisë së produktit, data e prodhimit.

6. Licenca e përpunimit industrial të duhanit dhe/ose prodhimit të produkteve të duhanit merret pasi të jetë kryer vlerësimi i të dhënave për kushtet teknike dhe teknologjinë e instaluar dhe pasi të shlyhet tarifa përkatëse.

Vlerësimi i të dhënave për kushtet teknike dhe teknologjinë e instaluar kryhet nga komisioni i ekspertëve pranë AKDC-së, përbërja e të cilit

përcaktohet me urdhër të titullarit të këtij institucioni dhe bazohet në:

a) vlerësimin e dokumentacionit teknik, të paraqitur sipas kritereve të përcaktuara në këtë vendim;

b) vlerësimin në vend të mjediseve dhe nivelit teknologjik të instaluar, sipas kritereve të përcaktuara në këtë vendim.

AKDC-ja shprehet me aktmiratimi ose aktmosmiratimi, jo më vonë se 10 ditë pune, të cilin ia përcjell MBZHR-së;

Në rast aktmiratimi, MBZHR-ja regjistron subjektin kërkues në regjistrin e përpunuesve industrialë të duhanit dhe/ose prodhuesve të produkteve të duhanit dhe ia përcjell QKB-së.

QKB-ja pajis me licencë subjektin pasi të ketë marrë konfirmim bankar të pagesës së tarifës përkatëse.

Afati për marrjen e vendimit është 10 ditë pune, nga momenti i aplikimit pranë QKB-së.

Pajisja me licencë bëhet sipas formatit tip, të miratuar nga QKB-ja.

Licenca e përpunimit industrial të duhanit dhe/ose prodhimit të produkteve të duhanit është pa afat.

Licenca e përpunimit industrial të duhanit dhe/ose prodhimit të produkteve të duhanit regjistrohet në Regjistrin Kombëtar të Licencave pranë QKB-së.

7. Kur, përgjatë kryerjes së veprimtarisë, ndodh ndryshim faktik i të dhënave, të cilat kanë të bëjnë me kriteret e licencimit, titullari i licencës duhet të njoftojë menjëherë QKB-në dhe AKDC-në.

Revokimi i licencës, përveç sa është parashikuar në nenin 29, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", mund të bëhet në çdo kohë, me kërkesë të titullarit të AKDC-së, nëse gjatë ushtrimit të këtyre veprimtarive nuk garantohet dhe/ose cenohet interesi publik.

Kërkesa për revokim i drejtohet QKB-së, bashkë me dokumentacionin shoqërues të cenimit të interesit publik.

8. Të gjithë operatorët e licencuar njoftohen për marrjen e masave për plotësimin e kritereve të përcaktuara në këtë vendim brenda një periudhe tranzitore 3-mujore. Me mbarimin e këtij afati, në zbatim të pikës 6, të këtij vendimi, AKDC-ja njofton QKB-në dhe operatorin për fillimin e procedurës së revokimit të licencës.

Vendimi nr. 126, datë 27.2.2003, i Këshillit të Ministrave, "Për kriteret e dhënies së lejes së përpunimit industrial dhe/ose të prodhimit të produkteve të duhanit", shfuqizohet.

9. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Kombëtare e Duhan-Cigareve dhe Qendra Kombëtare e Biznesit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 441, datë 26.6.2019

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA KATEGORIA E RESURSIT "TOKË BUJQËSORE" NË "TOKË URBANE", TRUALL, TË PASURISË ME NUMËR 1044, ZONA KADASTRALE 3826, BASHKIA KOLONJË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, të pasurisë me numër 1044, zona kadastrale 3826, Bashkia Kolonjë, sipas certifikatës së pronësisë, hartës treguese dhe lidhjes nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, Qarku Korçë, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e kategorisë së resursit, nga "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, të pasurisë me numër 1044, zona kadastrale 3826, Bashkia Kolonjë.

3. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të bëjë ndryshimin e llojit të pasurisë në certifikatën e pasurisë, sipas të dhënave për pasurinë, të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Qarkut Korçë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Lidhja nr.1

Nr. rend	Qarku	Bashkia	Zona kadastrale	Adresa e pasurisë	Numri i pasurisë	Sipërfaqja në m²	Sipërfaqja që përdoret për zhvillim m²	Sipërfaqja ndërtimore m²	Emërtimi i Strukturës
1	Korçë	Kolonjë	3826	Vrepcke	1044	2438	600	200	Akomodim agroturistik



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË 968887
PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. KOLONJË Zona Kadastrale Nr. 3826
Numri i Pasurisë 1044 Volumi 5 Faqe 44
Adresa e Pasurisë VREPCKE
Lloji i Pasurisë ARE
Sipërfaqja Totale 2438.00 m2
Nga kjo : Sa Truall Nga kjo : Sa Ndërtesa
Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
BARDHYL	FARI	VLLAMASI	1/2	
LILJANA	FOTO	VLLAMASI	1/2	

- është pronar i
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart tek pasuria me numër 1044
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi
- kufizimet e pasurisë janë : V 1047, L 1047, J 1037, P 1033

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 23/3/2016 Nr. 199

Data e lëshimit të çertifikatës
23/3/2016

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI
(ARBEN DAUTI)



HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

ZYRA E REGJISTRIMIT
E PASURIVE TE PALUAJSHME
KOLONJE

Regjistruesi
Arben DAUTI

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE
ZONA KADASTRALE 3826 NR. I PASURISE 1044 VOL. 5 FQ 44
INDEKSI I HARTES K-34-138-(101-D) SHKALLA 1:2500
ADRESA E PASURISE: Rrethi KOLONJE Q/F VREPCKE
Rr/L ____ P/G ____ Sh ____ K ____ Ap ____

B. KUFIZIMET
V. 1047
L. 1047
J. 1037
P. 1033
L. Data: 25/03/2016, Ora: ____

C. PRONARI
BARDHYL VLLAMASI
LILJANA VLLAMASI

Sip = 2438 m²

VENDIM
Nr. 442, datë 26.6.2019

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË NDALIMIT TË EKSPORTIT TË MERKURIT METALIK, KOMPONIMEVE DHE PËRZIERJEVE TË CAKTUARA TË MERKURIT, RUAJTJES SË SIGURT TË MERKURIT METALIK DHE TË KRITEREVE SPECIFIKE TË RUAJTJES SË MERKURIT METALIK TË KONSIDERUAR SI MBETJE[3]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 23, të ligjit nr. 27/2016, "Për menaxhimin e kimikateve", me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave për ndalimin e eksportit të merkurit metalik, komponimeve dhe përzierjeve të caktuara të merkurit, ruajtjen e sigurt të merkurit metalik dhe të kritereve specifike të ruajtjes së merkurit metalik të konsideruar si mbetje, sipas tekstit dhe shtojcave I, II, III, IV e V, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen ministria përgjegjëse për mjedisin, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, ministria përgjegjëse për shëndetësinë, ministria përgjegjëse për industrinë, inspektorati shtetëror përgjegjës për mjedisin, inspektorati shtetëror përgjegjës për tregtinë, inspektorati shtetëror përgjegjës për industrinë dhe minierat, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe operatorët ekonomikë, të përmendur në këtë vendim, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet juridike pas datës 1 janar 2020.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

[3] Ky vendim përafron pjesërisht Rregulloren (EU) 2017/852 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 17 maj 2017 mbi merkurin, që shfuqizon Rregulloren (EC) nr. 1102/2008 (Text with EEA relevance) *OJ L 137, 24.5.2017, f. 1–21. CELEX:* 32017R0852.

RREGULLAT
PËR NDALIMIN E EKSPORTIT TË MERKURIT METALIK, KOMPONIMEVE DHE PËRZIERJEVE TË CAKTUARA TË MERKURIT, RUAJTJEN E SIGURT TË MERKURIT METALIK DHE KRITERET SPECIFIKE TË RUAJTJES SË MERKURIT METALIK TË KONSIDERUAR SI MBETJE

I. OBJEKTI, PËRKUFIZIMET DHE FUSHA E ZBATIMIT

1. Objekti

Objekti i këtij vendimi janë përcaktimi i rregullave, masave dhe kushteve në lidhje me përdorimin, ruajtjen, tregtimin e merkurit, komponimeve që përmbajnë merkur dhe përzierjeve të merkurit, prodhimin, përdorimin dhe tregtimin e produkteve me merkur të shtuar, si dhe menaxhimin e mbetjeve të merkurit.

Qëllimi i këtij vendimi është mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe mjedisit nga shkarkimet antropogjene dhe çlirimet e merkurit dhe komponimeve që përmbajnë merkur.

2. Përkufizime

Për qëllime të këtij vendimi, të gjithë termat kanë të njëjtin kuptim me termat e përcaktuar në nenin 5, të ligjit nr. 27/2016, "Për menaxhimin e kimikateve", ndërsa termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

a) "Asgjësim", sipas kuptimit të përcaktuar në ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar;

b) "Dokument dorëzimi", sipas kuptimit të përcaktuar në ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar;

c) "Eksport", dalja e merkurit, komponimeve të merkurit, përzierjeve të merkurit dhe produkteve me merkur të shtuar;

ç) "Rieksportim", dalja e merkurit, komponimeve të merkurit, përzierjeve të merkurit dhe produkteve me merkur të shtuar, të cilat i nënshtrohen një procedure doganore të posaçme, të ndryshme nga procedura e transitit të jashtëm, nëpërmjet territorit doganor të Shqipërisë ;

d) "Import", hyrja fizike në territorin doganor të Shqipërisë të merkurit, komponimeve të merkurit, përzierjeve të merkurit dhe produkteve me merkur të shtuar, të cilat i nënshtrohen një procedure doganore të ndryshme nga procedura e transitit të

jashtëm për lëvizjen e mallrave nëpërmjet territorit doganor të Shqipërisë;

dh) "Komponim merkuri" , çdo substancë që përbëhet nga atomet e merkurit dhe një ose më shumë atome të elementeve të tjera kimike, që mund të ndahen në komponentë të ndryshëm vetëm nëpërmjet reaksioneve kimike;

e) "Konventë", Konventa e Minamatës, për merkurin;

ë) "Mbetje merkuri", merkuri metalik që klasifikohet mbetje, sipas përcaktimit të dhënë në ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar;

f) "Merkur", merkuri metalik (Hg, Nr. CAS 7439-97-6);

g) "Nxjerrje parësore e mineralit të merkurit", nxjerrja e mineraleve, ku përbërësi kryesor që kërkohet është merkuri;

gj) "Operator", sipas përcaktimit në ligjin nr.10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar;

h) "Palë në konventë" ose "Palë", një shtet ose një organizatë rajonale e integrimit ekonomik, që ka rënë dakord për t'u detyruar nga kjo konventë dhe për të cilat konventa është në fuqi;

i) "Produkt me merkur të shtuar", një produkt ose komponime të produktit që përmban merkur ose një komponim merkuri të shtuar në mënyrë të qëllimshme;

j) "Produkte të reja me merkur të shtuar", produktet me merkur të shtuar, të prodhuara pas hyrjes në fuqi të këtyre rregullave;

k) "Ruajtje e përkohëshme", sipas përcaktimit në ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar;

l) "Shndërrim", transformimi kimik i gjendjes fizike të merkurit, nga një gjendje e lëngshme deri në sulfur merkuri ose një përbërje kimike të krahasueshme, që është njëlloj ose më e qëndrueshme dhe e barabartë ose më pak e tretshme në ujë dhe që nuk paraqet rrezik më të madh për mjedisin ose shëndetin e njeriut sesa sulfuri i merkurit;

ll) "Shtet tjetër" ose "jo Palë", çdo shtet që nuk është palë në Konventë;

m) "Teknika më e mirë në dispozicion", teknika që është më efektive për të parandaluar dhe, kur kjo nuk është praktike, që zvogëlon emetimet dhe shkarkimet e merkurit në ajër, ujë dhe tokë dhe ndikimin e emetimeve të tilla e të shkarkimeve në mjedis si një e tërë, duke marrë parasysh rrethanat ekonomike dhe teknike për një vend ose objekt të caktuar brenda territorit.

3. Fusha e zbatimit

Këto rregulla zbatohen për të gjithë personat fizikë ose juridikë në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilët:

a) eksportojnë, importojnë, përdorin, ruajnë dhe tregtojnë merkur, komponime që përmbajnë merkur dhe përzierje merkuri;

b) prodhojnë dhe përdorin produkte me merkur të shtuar;

c) menaxhojnë mbetjet e merkurit.

II. EKSPORTI, TREGTIMI DHE KUFIZIMET MBI PRODHIMIN E MERKURIT, KOMPONIMEVE TË MERKURIT, PËRZIERJEVE TË MERKURIT DHE PRODUKTEVE ME MERKUR TË SHTUAR

II.1 Kufizimet e eksportit

1. Në Republikën e Shqipërisë ndalohet eksporti:

a) i merkurit;

b) i komponimeve dhe përzierjeve të merkurit, listuar në shtojcën I, të këtij vendimi, sipas afateve kohore të përcaktuara në këtë shtojcë;

c) për qëllime të rikuperimit të merkurit, të komponimeve dhe përzierjeve të tjera të merkurit, që nuk janë objekt ndalimi, sipas shkronjës "b", më sipër.

2. Përjashtimisht nga pika 1 e këtij kreu, lejohet eksporti i mbetjeve të merkurit vetëm për qëllime asgjësimi drejt shteteve, të cilat kanë në dispozicion kapacitetet teknike, infrastrukturore të nevojshme për kryerjen e shndërrimit, ngurtësimit të merkurit. Eksporti, në këtë rast, kryhet në përputhje me procedurat e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve dhe kërkesat e Konventës së Bazelit mbi kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme.

3. Kërkesat e shkronjës "b", të pikës 1, të këtij kreu, nuk zbatohen në rastin e eksportit të komponimeve të merkurit të listuara në shtojcën I, të këtij vendimi, për qëllime kërkimore laboratorike ose analiza laboratorike. Personi që eksporton merkur, komponime dhe përzierje të merkurit, sipas përjashtimit të kësaj pike, duhet që, nëpërmjet një dokumenti të lëshuar nga subjekti që operon jashtë vendit, të vërtetojë se eksporti kryhet vetëm për qëllimet e përcaktuara në këtë pikë.

II.2. Kufizimet e importit

1. Në Republikën e Shqipërisë ndalohet importi:

a) i merkurit dhe i përzierjeve të merkurit të listuara në shtojcën I, të këtij vendimi;

b) i mbetjeve të merkurit;

c) i përzierjeve të merkurit që nuk përfshihen në shkronjat "a" dhe "b", më sipër, dhe i komponimeve të merkurit për qëllime të rikuperimit të merkurit;

ç) i merkurit për përdorim në miniera dhe përpunim artizanal në shkallë të vogël të arit.

2. Përjashtimisht nga ndalimi në shkronjën "a", të pikës 1, të këtij kreu, importi i merkurit dhe importi i përzierjeve të merkurit, të listuara në shtojcën I, të këtij vendimi, për një përdorim të caktuar, në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e kimikateve, do të lejohet kur ministria përgjegjëse për mjedisin/Zyra e kimikateve, në zbatim të detyrimeve sipas Konventës së Merkurit, ka dhënë pëlqimin me shkrim për atë import.

Pëlqimi me shkrim jepet kur:

a) shteti eksportues është Palë në Konventë dhe merkuri që do të eksportohet nuk konsiderohet si nxjerrje parësore e mineralit të merkurit, e ndaluar sipas Konventës;

b) shteti eksportues, që nuk është Palë në Konventë, siguron dokumentin se merkuri nuk konsiderohet si nxjerrje parësore e mineralit të merkurit.

3. Në çdo rast, vendosja në treg, depozitimi dhe ruajtja e merkurit kryhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e kimikateve, nga personat fizikë ose juridikë të pajisur me licencën përkatëse për prodhimin, vendosjen në treg, depozitimin dhe ruajtjen e kimikateve të rrezikshme.

4. Formatet për zbatimin e pikës 2, të këtij kreu, miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për mjedisin.

II.3. Eksporti, importi dhe prodhimi i produkteve me merkur të shtuar

1. Ndalohet eksporti, importi dhe prodhimi i produkteve me merkur të shtuar sipas përcaktimeve dhe afateve kohore të parashikuara në shtojcën II, të këtij vendimi.

2. Përjashtimisht nga pika 1, e këtij kreu, ndalimi në pikën 1 nuk zbatohet për produktet, të cilat:

a) janë thelbësore për mbrojtjen civile dhe përdorimet ushtarake, sipas përcaktimit të legjislacionit përkatës në fuqi në fushën e mbrojtjes civile dhe të mallrave ushtarake;

b) përdoren për qëllime kërkimore, kalibrimin e instrumenteve ose si standarde referimi. Personi fizik ose juridik, i cili eksporton/importon produkte me merkur të shtuar, duhet të provojë, nëpërmjet një dokumentacioni, se eksporti/importi kryhet vetëm për qëllimet e përcaktuara në këtë pikë.

III. RUAJTJA E SIGURT E MERKURIT, KOMPONIMEVE DHE PËRZIERJEVE TË MERKURIT, SI DHE KUFIZIMET MBI PËRDORIMIN E MERKURIT NË PROCESET E PRODHIMIT, PËRDORIMI AMALGAMËS DENTARE

III.1. Ruajtja e merkurit, komponimeve dhe përzierjeve të merkurit dhe përdorimet e tyre në proceset e prodhimit

1. Përdorimi i merkurit dhe i komponimeve të merkurit në proceset e prodhimit lejohet vetëm në përputhje me kufizimet, kushtet dhe afatet kohore të përcaktuara në pjesën II, të shtojcës III, bashkëlidhur.

2. Ndalohet përdorimi i merkurit dhe i komponimeve të merkurit në proceset e prodhimit, sipas përcaktimeve dhe afateve kohore të parashikuara në pjesën I, të shtojcës III, të këtij vendimi.

3. Për aktivitetet industriale, të reja ose ekzistuese, që synojnë të përdorin procese që çlirojnë merkur dhe komponime merkuri, AKM-ja, gjatë procesit të pajisjes me lejen përkatëse të mjedisit, përveç kërkesave të përcaktuara në legjislacionin për lejet e mjedisit, vlerëson edhe proceset dhe kushtet e përcaktuara në pjesën II, të shtojcës III, të këtij vendimi.

4. Për qëllime të këtij kreu, merkuri, komponimet dhe përzierjet e merkurit, që gjenden në shtojcën I, bashkëlidhur, ruhen në mënyrë të përkohshme kur ruajtja:

a) siguron mbrojtjen e mjedisit;

b) është në përputhje me legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet;

c) përmbush kërkesat e pikës 3, të kreut II.2, të këtij vendimi;

ç) është në përputhje me pragjet dhe kërkesat e përcaktuara në legjislacionin specifik për kontrollin e rreziqeve të aksidenteve madhore, që përfshijnë substanca të rrezikshme.

5. Kërkesat teknike për ruajtjen e përkohshme të merkurit, komponimeve të merkurit dhe përzierjeve të merkurit në mënyrë të sigurt për mjedisin përcaktohen me urdhër të ministrit.

III.2. Përpunimi artizanal dhe minierat e arit në shkallë të vogël

1. Në aktivitetet e nxjerrjes e arit nga minerali, në përpunimin artizanal, si dhe në minierat e arit në shkallë të vogël ndalohet përdorimi i amalgamave të merkurit.

2. Kur konstatohen raste të mospërmbushjes së ndalimit të pikës 1 dhe të kërkesave të kreut VI, më poshtë, ministria përgjegjëse për industrinë përgatit planin kombëtar të veprimit, me masat që duhen ndërmarrë dhe në përputhje me kërkesat e shtojcës IV, bashkëlidhur.

III.3. Amalgamat dentare

1. Amalgama dentare, e përftuar nga përzierja e merkurit elementar të lëngët dhe një aliazhi në formë pluhuri, të përbërë nga argjendi, kallaji dhe/ose bakri, përdoret si material mbushës dentar për trajtimin dentar të dhëmbëve, në përputhje me kërkesat e këtij kreu.

2. Nga data 1 korrik 2021 lejohet përdorimi i amalgamave dentare vetëm në formën e dozave të preparateve të kapsuluara. Në klinikat dentare ndalohet përdorimi i merkurit në gjendje të lirë.

3. Nga data 1 korrik 2021, ndalohet përdorimi i amalgamave dentare për trajtimin dentar të dhëmbëve të qumështit, të fëmijëve nën moshën 15 vjeç dhe të femrave shtatzëna ose që janë në proces ushqyerje me gji.

4. Përjashtim nga zbatimi i pikës 3, të këtij kreu, bën përdorimi i amalgamave dentare në rastet kur dentisti e konsideron përdorimin e amalgamave dentare të nevojshme për shërbimin dentar ndaj pacientit.

5. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë, brenda datës 1 korrik 2021, përgatit planin kombëtar me masat që do të ndërmerren për heqjen nga përdorimi të amalgamës dentare në vend, i cili, brenda 1 muaji, nga data e miratimit, publikohet në faqen zyrtare të ministrisë.

6. Ndarësi i amalgamës (separator) për mbajtjen dhe grumbullimin e pjesëzave/grimcave të amalgamës, përfshirë edhe pjesëzat që gjenden në ujin e përdorur gjatë këtyre procedurave, pas datës 1 janar 2021 është detyrim vetëm për ata ofrues të shërbimit dentar, të cilët përdorin amalgamën dentare apo kryejnë heqjen e mbushjeve me amalgamë dentare në klinikat e tyre.

7. Sipas përcaktimit në pikën 6, të këtij kreu, merren masat, si më poshtë vijon:

a) Ndarësit e amalgamës, që janë në përdorim pas datës 1 janar 2020, të kenë një nivel mbajtjeje, të paktën, 95% të pjesëzave/grimcave të amalgamës;

b) Të gjithë ndarësit e amalgameve, që janë në përdorim pas datës 1 janar 2024, të sigurojnë nivelin e mbajtjes të përcaktuar në shkronjën "a";

c) Ofruesit e shërbimit dentar të mirëmbajnë ndarësit e amalgamave në përputhje me udhëzimet e prodhuesit, për të siguruar nivelin më të lartë praktik të mbajtjes.

8. Kapsulat dhe ndarësit e amalgamave, që ofrojnë një nivel cilësie dhe mbajtjeje në përputhje me standardet evropiane, ose standarde të tjera kombëtare apo ndërkombëtare, duhet të përmbushin kërkesat e përcaktuara në pikat 2 dhe 7, të këtij kreu.

9. Ofruesit e shërbimit dentar, që përdorin amalgama, marrin masat që mbetjet e amalgamave, pjesëzat dhe mbushjet e amalgamave, dhëmbët ose pjesët e tyre, të cilat përmbajnë ose janë të kontaminuara me amalgamë dentare, të grumbullohen dhe trajtohen nga subjekte të autorizuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

10. Ofruesit e shërbimit dentar ndalohen të hedhin në mjedis, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, mbetjet e amalgamave.

11. Inspektorati përgjegjës për mjedisin dhe ai përgjegjës për shëndetësinë inspektojnë ofruesit e shërbimit dentar.

IV. KRITERET SPECIFIKE TË RUAJTJES SË MERKURIT, KOMPONIMEVE DHE PËRZIERJEVE TË MERKURIT TË KONSIDERUAR SI MBETJE, TRAJTIMI, ASGJËSIMI DHE GJURMUESHMËRIA E TYRE

IV.1 Ruajtja e mbetjeve të merkurit dhe trajtimi i tyre

1. Operatorët, që krijojnë dhe ruajnë mbetje, marrin masat për të shmangur kontaminimin e mbetjeve të tjera nga mbetjet e merkurit, komponimet e merkurit dhe përzierjet që përmbajnë merkur.

2. Merkuri dhe komponimet e merkurit, që gjenerohen në formë të pastër ose si përzierje nga burimet e mëdha, të përcaktuara në pikën 3, të këtij

kreu, konsiderohen mbetje në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

3. Për qëllime të pikës 2, të këtij kreu, burime të mëdha konsiderohen:

a) industria klor-alkali;

b) pastrimi i gazit natyror;

c) operacionet minerare joferrore dhe ato të shkrirjes;

ç) nxjerrja nga mineralet e cinabarit.

4. Mbetjet e merkurit grumbullohen, transportohen dhe magazinohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe, sipas rastit, mund:

a) të ruhen përkohësisht në gjendje të lëngët, në përputhje me kërkesat e pikës 5, të këtij kreu;

b) t'i nënshtrohen proceseve të përcaktuara në pikën 6, të këtij kreu, për qëllime të ruajtjes së përhershme ose asgjësimit;

c) të ruhen në mënyrë të përhershme ose të asgjësohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Procedurat e asgjësimit, në asnjë rast, nuk duhet të çojnë në rikuperimin e merkurit.

5. Mbetjet e merkurit, deri në datën 1 janar 2025, mund të ruhen përkohësisht në gjendje të lëngët, kur:

a) përmbushen kërkesat për ruajtjen e përkohshme, të përcaktuara në shtojcën V, të këtij vendimi;

b) ruajtja e përkohshme e mbetjeve të merkurit bëhet në objekte mbi tokë, të cilat plotësojnë kushtet e posaçme në pikën 6, të shtojcës V, të këtij vendimi.

6. Për qëllime të pikave 4 dhe 5, të këtij kreu, ruajtja e përkohshme e mbetjeve të merkurit kryhet nga persona fizikë ose juridikë të pajisur me lejen e mjedisit, sipas fushës III.1, të shtojcës së ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe licencën III.2.B, të fushës III, të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta".

7. Mbetjet e merkurit, para se t'i nënshtrohen procesit të ruajtjes së përhershme, kalojnë në procesin e shndërrimit. Në rastin kur asgjësimi parashikohet të ndodhë në objekte mbi tokë, mbetjet e merkurit i nënshtrohen shndërrimit dhe ngurtësimit.

8. Mbetjet e merkurit, që i janë nënshtruar procesit të shndërrimit dhe/ose ngurtësimit, do të ruhen në mënyrë të përhershme në:

a) Lendfill-et e mbetjeve të rrezikshme, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi për lendfill-et;

b) minierat e kripës, të përshtatura dhe që përmbushin kërkesat e pikës 1, të shtojcës V, për ruajtjen e përhershme të mbetjeve të merkurit të shndërruara, ose në formacione të forta shkëmbore nën tokë, të cilat ofrojnë një nivel sigurie dhe izolimi të njëjtë ose më të lartë se minierat e kripës;

c) objektet mbi tokë, të përcaktuara dhe të pajisura për ruajtjen e përhershme të mbetjeve të merkurit të shndërruara dhe ngurtësuara, që sigurojnë një nivel sigurie dhe izolimi të njëjtë ose më të lartë se objektet në shkronjën "b".

9. Operatori, që ruan mbetjet e rrezikshme, ka detyrimin që mbetjet e merkurit të shëndrruara dhe/ose ngurtësuara t'i ruajë sipas kushteve të mëposhtme:

a) në mënyrë të ndarë nga mbetjet e tjera;

b) të grupuara në një dhomë ruajtjeje të vulosur;

c) në përputhje me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin për lendfill-et e mbetjeve;

ç) në përputhje me kërkesat specifike për ruajtjen e përkohshme të mbetjeve të merkurit, sipas pikave 3 dhe 5, të shtojcës V, bashkëlidhur.

IV.2. Gjurmueshmëria

1. Gjurmueshmëria e mbetjeve të merkurit, që nga krijimi deri në destinacionin e tyre përfundimtar, kryhet në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

2. Personat fizikë ose juridikë, që ruajnë përkohësisht mbetjet e merkurit, krijojnë dhe mbajnë regjistrin me të dhënat, si më poshtë vijon:

a) me dërgesat e marra të mbetjeve të merkurit, i cili përfshin:

i. origjinën dhe sasinë e mbetjeve të marra;

ii. emrin dhe të dhënat e kontaktit të furnizuesit e të pronarit të mbetjeve.

b) me dërgesat e mbetjeve të merkurit që largohen nga objekti, i cili përfshin:

i. sasinë e mbetjeve dhe përmbajtjen e merkurit në to;

ii. destinacionin dhe operacionin e destinuar të asgjësimit të mbetjeve;

iii. kopje të dokumentit të lëshuar nga operatori që kryen shndërrimin dhe, nëse është e zbatueshme, ngurtësimin e mbetjeve, siç referohet në paragrafin 3, më poshtë;

c) me sasinë e mbetjeve të merkurit të depozituara në objekt, në fund të çdo muaji.

3. Kur mbetjet e merkurit dalin nga ruajtja e përkohshme, personi fizik ose juridik, sipas pikës 2, të këtij kreu, në përputhje edhe me legjislacionin në fuqi që rregullon eksportin e mbetjeve të rrezikshme, plotëson dokumentin e dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme. Subjekti duhet të deklarojë se këto mbetje janë dërguar, sipas rastit, në një impiant që kryen shndërrimin dhe/ose ngurtësimin e mbetjeve të merkurit ose në një impiant asgjësimi. Një kopje e dokumentit i përcillet pa vonesë operatorëve ekonomikë industrialë të interesuar, sipas kreut IV.2.

4. Personat fizikë ose juridikë, të përcaktuar në pikën 2, të këtij kreu, dërgojnë në AKM çdo vit, deri në datën 31 janar, regjistrin e të dhënave për vitin e mëparshëm kalendarik.

IV.5. Zonat e ndotura

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore përfshijnë në planet vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve edhe masat lidhur me zonat e ndotura me merkur dhe mbetje merkuri, që janë brenda territorit të tyre, rrezikun që ato paraqesin për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, si dhe masat për rehabilitimin e këtyre zonave.

2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore bashkëpunojnë me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, me institucione të tjera shtetërore, si dhe donatorët e ndryshëm (organizata), donatorët e huaj, për financimin e projekteve që reduktojnë riskun në zonat e ndotura me merkur dhe mbetje merkuri.

3. Ministritë, inspektoratet përgjegjëse të tyre, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, INSTAT-i dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë me Ministrinë dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit informacionet e nevojshme lidhur me masat e marra për:

a) adresimin e merkurit, komponimeve dhe përzierjeve të merkurit;

b) identifikimin dhe vlerësimin e zonave të ndotura nga merkuri dhe komponimet e merkurit;

c) adresimin e rreziqeve të kontaminimit të merkurit për shëndetin e njeriut dhe mjedisit.

4. Bazuar në të dhënat e grumbulluara në pikën 3, Ministria përgatit inventarin e zonave të ndotura nga merkuri dhe komponimet e merkurit në vend.

5. Brenda datës 1 janar 2023, Ministria publikon informacionin e mbledhur në përputhje me pikën 3, përfshirë edhe inventarin e zonave të ndotura nga merkuri dhe komponimet e merkurit.

V. RAPORTIMI

V.1. Raportimi i burimeve të mëdha

1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit krijon dhe mirëmban inventarin e shkarkimeve të merkurit në mjedis. Për qëllime të krijimit të inventarit, institucionet përgjegjëse dhe operatorët industrialë raportojnë në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit në përputhje me legjislacionin që rregullon krijimin e regjistrit kombëtar të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve.

2. Për qëllime të pikës 1, të këtij kreu, operatorët industrialë të burimeve të mëdha, sipas shkronjave "a", "b" e "c", të pikës 3, të kreut IV.1, raportojnë çdo vit, brenda datës 31 maj, pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, informacionin e mëposhtëm:

a) sasinë totale të mbetjeve të merkurit, të ruajtura në instalimet e tyre;

b) sasinë totale të mbetjeve të merkurit të dërguara në objekte/impiante, të cilat kryejnë:

i. ruajtjen e përkohshme, shndërrimin dhe, kur është e zbatueshme, ngurtësimin e mbetjeve të merkurit;

ii. ruajtjen e përhershme të mbetjeve të merkurit, që i janë nënshtruar procesit të shndërrimit dhe, nëse është e zbatueshme, ngurtësimit.

c) vendndodhjen dhe të dhënat e kontaktit të çdo objekti/impianti të referuar në shkronjën "b";

ç) kopje të dokumentit të lëshuar nga personi fizik ose juridik, që kryen ruajtjen e përkohshme të mbetjeve të merkurit, në përputhje me pikën 2, të kreut IV.4;

d) kopje të dokumentit të lëshuar nga personi fizik ose juridik, që kryen shndërrimin dhe, nëse është e zbatueshme, ngurtësimin e mbetjeve të merkurit, në përputhje me pikën 3, të kreut IV.4;

dh) kopje të dokumentit të lëshuar nga operatori që kryen ruajtjen e përhershme të mbetjeve të merkurit që ka pësuar shndërrim dhe, nëse është e zbatueshme, ngurtësim, në përputhje me pikën 3, të kreut IV.4.

3. Operatorët industrialë të burimeve të mëdha, të dhënat sipas shkronjave "a" dhe "b", të pikës 2, i raportojnë në përputhje me kodet e përcaktuara në legjislacionin për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve.

4. Kërkesat e pikave 1 dhe 2 nuk zbatohen për operatorët e instalimeve klor-alkaline, një vit pas nxjerrjes jashtë përdorimit të të gjithë sasisë së merkurit që operohet prej tij, në përputhje me teknikat më të mira në dispozicion për prodhimet klor-alkaline dhe kur e gjithë sasia e merkurit është dorëzuar në impiantet e menaxhimit të mbetjeve.

V.2. Raporti kombëtar

1. Ministria/Zyra e kimikateve, nga data 1 janar 2023, përgatit raportin kombëtar me të dhënat, si më poshtë vijon:

a) informacionin mbi zbatimin e këtij vendimi;

b) informacionin e nevojshëm për përmbushjen nga Republika e Shqipërisë të raportimit, sipas kërkesave të Konventës;

c) një përmbledhje të informacionit të siguruar në përputhje me kreun IV.2;

ç) informacion në lidhje me merkurin që ndodhet në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë një listë të vendeve:

i. ku gjenden rezervat e më shumë se 50 tonë metrikë merkur, përveç mbetjeve të merkurit dhe sasinë e merkurit në vend;

ii. ku grumbullohen më shumë se 50 tonë metrikë mbetje merkuri, si dhe sasinë e mbetjeve të merkurit në vend;

d) një listë të burimeve që kontribuojnë më shumë se 10 tonë metrikë merkur në vit, për të cilat AKM-ja ka informacion.

2. Formati, frekuenca dhe mënyra e grumbullimit të informacionit për qëllime të përgatitjes së raportit përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për mjedisin.

VI. SANKSIONET

Mosrespektimi i parashikimeve të këtij vendimi, kur nuk përbën vepër penale përbën kundërvajtje administrative, dhe shoqërohet me ndëshkimet administrative të parashikuara në pikat 38, 39 dhe 40, të nenit 40, të ligjit nr. 27/2016, "Për menaxhimin e kimikateve".

SHTOJCA I
KOMPONIMET E MERKURIT, OBJEKT I PARASHIKIMEVE TË PIKAVE 1(b) DHE 3, TË KREUT II.1, DHE PIKËS 3, TË KREUT III.1, DHE PËRZIERJET E MERKURIT OBJEKT I PARASHIKIMEVE SIPAS PIKAVE 1(b) DHE 3, TË KREUT II.1, PIKËS 1(a), TË KREUT II.2, DHE PIKËS 4, TË KREUT III.1:

1. Ndalohen të eksportohen komponimet e merkurit, si më poshtë:

a) nga data 1 janar 2023:

- kloruri i merkurit (I) (Hg_2Cl_2, Nr. CAS 10112-91-1)
- oksidi i merkurit (II) (HgO, Nr. CAS 21908-53-2)
- xeherori i cinabarit
- sulfuri i merkurit (HgS, Nr. CAS 1344-48-5)

b) nga data 1 janar 2025:

- sulfati i merkurit (II) ($HgSO_4$, Nr. CAS 7783-35-9)
- nitrati i merkurit (II) ($Hg(NO_3)_2$, Nr. CAS 10045-94-0)

2. Përzierjet e merkurit, që ndalohen për t'u importuar dhe eksportuar, **nga data 1 janar 2023**, janë:

- Përzierjet e merkurit me substanca të tjera, duke përfshirë aliazhet e merkurit, me një përqendrim merkuri të paktën 95% të peshës.

SHTOJCA II
PRODUKTET ME MERKUR TË SHTUAR, REFERUAR PIKËS II.3, TË KREUT II

PJESA A - PRODUKTET ME MERKUR TË SHTUAR

Produktet me merkur të shtuar	Data e ndalimit të eksportit, importit dhe prodhimit të produkteve me merkur të shtuar
1. Bateritë ose akumulatorët që përmbajnë merkur më shumë se 0.0005% të peshës.	31.12.2025
2. Çelësat dhe reletë, me përjashtim të urave matëse të saktësisë së lartë dhe humbjeve në matje, të çelësave dhe releve të frekuencave të larta dhe radio-frekuencave në instrumentet e monitorimit dhe kontrollit me një përmbajtje maksimale të merkurit prej 20 mg për urë, çelës ose rele.	31.12.2025
3. Llamba fluoreshente kompakte (CFL/LFL) për qëllime të përgjithshme ndriçimi: a) CFL.i ≤ 30 Wat me një përmbajtje merkuri që tejkalon 2.5 mg për ndezësin e llambave; b) CFL.ni ≤ 30 Wat me një përmbajtje merkuri që tejkalon 3.5 mg për ndezësin e llambave.	31.12.2023
4. Llamba fluoreshente lineare (LFLs) për qëllime të përgjithshme ndriçimi: a) fosfor tribandësh < 60 Wat me përmbajtje merkuri që kalon 5 mg për llambë; b) fosfor halofosfatik ≤ 40 Wat me një përmbajtje merkuri që i tejkalon 10 mg për llambë.	31.12.2023
5. Llambat me avuj merkuri në shtypje të lartë (HPMVs) për qëllime të përgjithshme ndriçimi.	31.12.2023
6. Llambat fluoreshente me katodë të ftohtë me merkur të shtuar, si më poshtë dhe llambat fluoreshente me elektrodë të jashtme (CCFL dhe EEFL) për ekranet elektronike: a) me gjatësi të shkurtër (≤ 500 mm) me përmbajtje merkuri që i tejkalon 3.5 mg për llambë; b) me gjatësi mesatare (> 500 mm dhe ≤ 1 500 mm) me përmbajtje merkuri që i tejkalon 5 mg për llambë; c) me gjatësi të madhe (> 1 500 mm) me përmbajtje merkuri që i tejkalon 13 mg për llambë.	31.12.2023
7. Produktet kozmetike me merkur dhe komponime merkuri, me përjashtim të rasteve të veçanta për thiomers, dhe kripërat e fenilmerkurit (përfshirë boratin), në përputhje me legjislacionin për produktet kozmetike.	31.12.2025
8. Pesticidet, biocidet dhe antiseptikët topikal.	31.12.2025
Pajisjet matëse, joelektronike të mëposhtme: a) barometrat; b) higrometrat; c) manometrat; d) termometrat dhe pajisjet e tjera termometrike joelektrike; e) sfigmomanometrat f) matësit e tensionit të materialeve që përdoren me pletismografë; g) piknometrat me merkur; h) pajisjet matëse me merkur që përdoren për përcaktimin e pikës së zbutjes. Pika "h", më sipër, nuk zbatohet për pajisjet matëse që vijojnë: i. pajisjet matëse joelektronike të instaluara në aparatura të mëdha që përdoren për saktësi të lartë, për të cilat nuk ekziston alternativë e përshtatshme pa merkur; ii. pajisjet matëse më të vjetra se 50-vjeçare prej datës 3 tetor 2007; iii. pajisjet matëse që demonstrohen në shfaqet publike për qëllime kulturore dhe historike.	31.12.2025

PJESA B - PRODUKTE SHTESË TË PËRJASHTUARA NGA LISTA NË PJESËN A TË KËSAJ SHTOJCE

Çelësat dhe reletë, llambat fluoreshente me katodë të ftohtë dhe llambat fluoreshente me elektrodë të jashtme (CCFL dhe EEFL) për ekranet elektronikë dhe pajisjet matëse, kur ato përdoren për të zëvendësuar një përbërës të një pajisjeje të madhe, me kusht që të mos ketë alternativë të mundshme pa merkur për atë përbërës, në përputhje me legjislacionin për automjetet në fund të jetës dhe kufizimet mbi përdorimin e disa substancave të rrezikshme në pajisjet elektrike dhe elektronike.

SHTOJCA III
KËRKESAT MBI MERKURIN, PËR T'U ZBATUAR NË PROCESET E PRODHIMIT, REFERUAR PIKËS 1 DHE 2, TË KREUT III.1.

PJESA I: PËRDORIMI I NDALUAR I MERKURIT OSE KOMPONIMEVE TË MERKURIT, QOFTË NË FORMË TË PASTËR APO NË PËRZIERJE, NË PROCESET E PRODHIMIT si më poshtë:

a) nga 1 janari 2023: proceset prodhuese në të cilat merkuri ose përbërjet e merkurit përdoren si katalizator;

b) si përjashtim nga pika "a", prodhimi i monomerit të klorurit të vinileve ndalohet që nga 1 Janari 2027;

c) nga 1 janari 2027: proceset prodhuese në të cilat merkuri përdoret si elektrodë;

d) si përjashtim nga pika "c", prodhimi klor-alkalin ku merkuri përdoret si një elektrodë ndalohet nga 11 dhjetori 2020;

e) me përjashtim të pikës "c", ndalohet prodhimi i metanolatit ose etanolatit të natriumit ose të kaliumit nga 1 janari 2028;

f) nga 1 janari 2023: prodhimi i poliuretanit, deri në masën që lejohet sipas pikës 62, të Shtojcës 1, të legjislacionit për kufizimet për prodhimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e disa kimikateve dhe artikujve të caktuar të rrezikshëm".

PJESA II: PROCESET E PRODHIMIT, QË I NËNSHTROHEN KUFIZIMEVE MBI PËRDORIMIN DHE SHKARKIMET E MERKURIT DHE KOMPONIMEVE TË MERKURIT

Prodhimi i metanolatit ose etanolatit të natriumit ose kaliumit

Prodhimi i metanolatit ose etanolatit të natriumit ose kaliumit, kryhet në përputhje me shkronjën "e", të pjesës I, të kësaj shtojce dhe, në përputhje me kushtet e mëposhtme:

a) nuk përdoret merkur i dalë nga nxjerrja parësore e mineralit të merkurit;

b) reduktimi i shkarkimeve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të merkurit, komponimeve të merkurit në ajër, ujë dhe tokë me 50% për njësi prodhimi deri në vitin 2025, krahasuar me vitin 2010;

c) mbështet kërkimin dhe zhvillimin në respekt të proceseve të prodhimit pa merkur; dhe

d) që nga 13 Korrik 2023, kapaciteti i impianteve që përdorin merkurin dhe komponimet e merkurit për prodhimin e metanolatit ose etanolatit të natriumit ose kaliumit dhe të cilat ishin në funksionim para kësaj date, nuk do të rritet dhe nuk do të lejohen impiante të reja.

SHTOJCA IV
PËRMBAJTJA E PLANIT KOMBËTAR PËR PËRPUNIMIN DHE NXJERRJEN ARTIZANALE NË SHKALLË TË VOGËL TË ARIT, referuar pikës III.3, të Kreut III.

Plani kombëtar përfshin informacionin, si më poshtë vijon:

a) Objektivat kombëtare dhe tragetet e reduktimit për të eliminuar përdorimin e merkurit dhe komponimeve të tij;

b) masat për eliminimin e:

i. të gjithë xeherorëve të amalagamave*;

ii. djegien në mjedise të hapura të amalgamit ose amalgamit të përpunuar;

iii. djegia e amalgameve në zonat e banuara;

iv. kullimin/rrjedhjet e cianideve në sediment, xeheror apo mbetje në të cilat është shtuar merkur, pa e larguar paraprakisht atë.

c) hapa për të lehtësuar formalizimin ose rregullimin e sektorit të minierave dhe përpunimit artisanal të arit në shkallë të vogël;

d) vlerësimet bazë të sasive të merkurit të përdorur dhe praktikat e përdorura në miniera dhe

përpunimin artizanal dhe në shkallë të vogël të arit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;

e) strategjitë për promovimin e reduktimit të shkarkimeve, nxjerrjen, ekspozimin ndaj merkurit në miniera dhe për përpunim artizanal dhe në shkallë të vogël të arit, duke përfshirë metodat që nuk përmbajnë merkur;

f) strategjitë për të menaxhuar tregtimin dhe parandalimin e shndërrimit të merkurit dhe përbërjeve të merkurit nga burimet e huaja dhe ato të brendshme, për përdorim në miniera dhe përpunim artizanal në shkallë të vogël të arit;

g) strategjitë për përfshirjen e aktorëve në zbatimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të planit kombëtar;

h) strategjinë e shëndetit publik mbi ekspozimin e minatorëve artizanal dhe të vogël të arit dhe komuniteteve të tyre ndaj merkurit, duke përfshirë ndër të tjera, grumbullimin e të dhënave shëndetësore, trajnimin e personave të kujdesit shëndetësor dhe rritjen ndërgjegjësimit nëpërmjet personelit të qendrave shëndetësore;

i) strategjitë për të parandaluar ekspozimin e popullatave vulnerabël, veçanërisht fëmijët dhe femrat në periudhën e lindjes, sidomos femrat shtatzëna, ndaj merkurit të përdorur në minierat dhe përpunimin në shkallë të vogël të arit;

j) strategjitë për sigurimin e informacionit për minatorët artizanal dhe në shkallë të vogël të arit, si dhe komunitetet e prekura;

k) një plan pune për zbatimin e planit kombëtar.

SHTOJCA V
RUAJTJA E PËRKOHSHME E MERKURIT METALIK

1. Ruajtja e përkohshme e merkurit metalik

Për qëllime të ruajtjes së përkohshme, për më shumë sesa 1 vit të merkurit metalik, zbatohen kushtet e mëposhtme:

a) merkuri metalik ruhet veçmas nga mbetje të tjera;

b) kontejnerët vendosen në vendruajtje të përshtatshme të mbyllura në mënyrë të tillë që të mos kenë krisje, të çara dhe të papërshkueshme nga merkuri metalik, me vëllim të përshtatshëm me sasinë e merkurit që mbajnë. Kontejnerët me merkur duhet të sigurohen në një formacion shkëmbor të pajisur me një gropë grumbullimi;

c) vendruajtja duhet të pajiset me një sistem të mbrojtjes nga zjarri;

ç) hapësira e magazinimit duhet të organizohet në një mënyrë të tillë për të garantuar se të gjithë kontejnerët administrohen lehtësisht.

2. Përbërje të merkurit

Përbërjet e merkurit, duhet të jenë në përputhje me specifikimet e mëposhtme:

a) përmbajtja e merkurit të jetë më e lartë se 99.9% e peshës;

b) pa papastërti me aftësi gërryese për karbonin ose çelikun (p.sh.: tretësirë e acidit nitrik, tretësirë e kripërave klorure).

3. Ruajtja

1. Kontejnerët e përdorur për ruajtjen e merkurit metalik duhet të jenë rezistentë ndaj ndryshkjes dhe ndaj goditjeve. Për këtë arsye duhet të shmanget saldimi. Kontejnerët duhet të përmbushin të dhënat, si vijon:

a) materiali i përbërës të jetë prej çelikut të karbonit (ASTM A36 minimum) ose çelik inoksi (AISI 304, 316L);

b) kontejnerët duhet të mbyllen hermetikisht për mos u përshkuar nga gazet dhe lëngjet;

c) faqja e jashtme e kontejnerit duhet të jetë rezistente ndaj kushteve ku realizohet ruajtja;

d) lloji dhe dizajni i kontejnerit duhet të kalojë me sukses testin e rënies dhe të rrjedhjes.

2. Raporti maksimal i mbushjes së kontejnerit duhet të jetë 80% i vëllimit për të siguruar një qëndrueshmëri të mjaftueshme, që as rrjedhja dhe as shtrembërimi i përhershëm i kontejnerit të mos ndodhë si rezultat i bymimit të lëngut për shkak të temperaturës së lartë.

4. Procedurat e pranimit

Lejohen për përdorim vetëm kontejnerët që shoqërohen me një certifikatë që përmbush kërkesat e përcaktuara në vijim:

a) vetëm merkuri metalik që plotëson kriteret minimale të pranimit të përcaktuara më sipër, do të pranohet;

b) kontejnerët duhet të inspektohet me sy para magazinimit në mënyrë që të shmanget përdorimi i kontejnerëve të dëmtuar, që rrjedhin ose përmbajnë ndryshk;

c) kontejnerët duhet të jenë pajisur me një vulë të qëndrueshme që përmban numrin e identifikimit të kontejnerit, materialin e ndërtimit, peshën e tij bosh, referencën nga prodhuesit dhe datën e ndërtimit;

ç) kontejnerët do të mbajnë një tabelë të përhershme ku përmendet numri i identifikimit të certifikatës.

5. Certifikata

1. Certifikata duhet të përmbajë elementet e mëposhtme:

a) emrin dhe adresën e prodhuesit të mbetjeve;

b) emrin dhe adresën e përgjegjësit për mbushjen;

c) vendin dhe datën e mbushjes;

ç) sasinë e merkurit;

d) pastërtinë e merkurit dhe, nëse gjykohet e nevojshme, një përshkrim të papastërtive, duke përfshirë raportin analitik;

dh) nëse kontejnerët janë përdorur ekskluzivisht për transportimin dhe ruajtjen e merkurit;

e) numrin e identifikimit të kontejnerit;

ë) ndonjë koment të veçantë.

2. Certifikata lëshohet nga prodhuesi i mbetjeve ose, në mungesë të tij, nga personi përgjegjës për menaxhimin e mbetjeve.

6. Kushte të posaçme për merkurin metalik

Për qëllime të ruajtjes së përkohshme për më shumë sesa 1 vit të merkurit metalik, zbatohen kushtet e mëposhtme:

Monitorimi, inspektimi dhe kërkesat emergjente

1. Në vendin e magazinimit duhet të vendoset një sistem i vazhdueshëm i monitorimit të avujve të merkurit me një ndjeshmëri prej të paktën 0,02 mg merkur/m^3. Sensorët duhet të vendosen në nivelin e tokës dhe lartësinë e kokës. Kjo do të përfshijë një sistem alarmi vizual dhe akustik. Sistemi i nënshtrohet mirëmbajtjes të paktën një herë në vit.

2. Hapësira dhe kontejnerët e magazinimit duhet të inspektohen me vëmendje nga një person i autorizuar të paktën një herë në muaj. Kur zbulohen rrjedhje, subjekti menjëherë duhet të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të shmangur çdo shkarkim të merkurit në mjedis dhe për të rivendosur sigurinë e ruajtjes së merkurit. Çdo rrjedhje konsiderohet se ka ndikim të dëmshëm mjedisor.

3. Planet e emergjencës dhe pajisjet e përshtatshme mbrojtëse për trajtimin e merkurit metalik duhet të jenë të pranishme në çdo kohë.

7. Mbajtja e të dhënave

1. Të gjitha dokumentet që përmbajnë informacionin e përmendur në pikat 4, 5 dhe 6 të këtij kreu, përfshirë certifikatën që shoqëron kontejnerin, si dhe të dhënat lidhur me shpërndarjen dhe dërgimin e merkurit metalik pas magazinimit të përkohshëm dhe destinacionit të vendtrajtimit mbahen për të paktën 3 vjet, pas përfundimit të magazinimit.

2. Merkuri metalik, përbërjet dhe përzierjet e merkurit, të depozituara në vendruajte të përcaktuara dhe kushte të veçanta, duhet të jenë të ambalazhuara dhe etiketuara me simbolin e rrezikut, treguesin e rrezikut dhe të sigurisë.

3. Depozitimi dhe ruajtja e merkurit metalik, përbërjeve dhe përzierjeve të merkurit, si substanca të kategorizuara me rrezik për shëndetin e njerëzve dhe mjedisin i nënshtrohet procedurës së lejes dhe regjistrimit, kontrollit dhe marrjes së masave mbrojtëse për ruajtjen e mjediseve të ruajtjes në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.

VENDIM
Nr.445, datë 28.6.2019

PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA TË KRYETARIT TË BASHKISË VAU I DEJËS, Z. ZEF HILA

Në mbështetje të neneve 100 e 115, pika 1, të Kushtetutës, dhe të shkronjës "a", të nenit 62, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkarkimin nga detyra, për shkak të shkeljeve të rënda, të kryetarit të Bashkisë Vau i Dejës, z. Zef Hila.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

URDHËR
Nr. 386, datë 26.6.2019

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në zbatim të pikës 4 të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 2, të nenit 28 e në vijim të Kodit të Procedurës Administrative si dhe pikës 2, të kreut V, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve

që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", i ndryshuar

URDHËROJ:

1. Autorizimet për dërgimin me shërbim të punonjësve të institucioneve në varësi të Ministrisë së Kulturës, jashtë qendrës së punës, brenda vendit, në largësi mbi 100 km, të lëshohen përkatësisht nga titullarët e institucioneve në varësi të Ministrisë së Kulturës.

2. Në ushtrimin e kësaj kompetence, titullarët e institucioneve në varësi të Ministrisë së Kulturës të zbatojnë kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 997, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", të ndryshuar.

3. Ngarkohen titullarët e institucioneve në varësi të Ministrisë së Kulturës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS
Elva Margariti

VENDIM
Nr. 84, datë 31.5.2019

MBI MIRATIMIN E "KONTRATËS PËR SIGURIMIN E SHËRBIMEVE TË BALANCIMIT(KAPACITETIT REZERVË DHE ENERGJISË BALANCUESE) TË SISTEMIT ELEKTROENERGJETIK PËR PERIUDHËN KOHORE 1.1.2019– 31.12.2019" MIDIS OST SHA DHE KESH SHA

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, germa "h", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike"; nenit 6, pika 2 dhe 11 të "Rregullave të përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017, dhe nenit 105, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", si dhe nenit 19 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) në mbledhjen e tij të datës 31.5.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike në lidhje me "Kontratën për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektroenergjetik për periudhën kohore 1.1.2019– 31.12.2019 midis OST sh.a. dhe KESH sh.a.",

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 65 prot., datë 4.1.2019, shoqëria OST sh.a., ka dërguar në ERE kërkesën për miratimin e kontratës me nr. 6651 prot., datë 31.12.2018 për shoqërinë KESH sh.a. dhe nr. 8859 prot., datë 31.12.2018 për shoqërinë OST sh.a. "Për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektroenergjetik, për periudhën 1.1.2019– 31.12.2019", të nënshkruar nga shoqëritë OST sh.a. dhe KESH sh.a.

- Enti Rregullator i Energjisë në bazë të nenit 20 germa "h" të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, miraton kontratat tip ose kushtet e përgjithshme të kontratave për shërbimet e rregulluara, të ofruara nga pjesëmarrësit e tregut, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.

- ERE me vendimin nr. 9, datë 24.1.2019 filloi procedurën për miratimin e "Kontratës për sigurimin e shërbimeve të balancimit(kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektroenergjetik për periudhën kohore 1.1.2019– 31.12.2019" midis OST sh.a. dhe KESH sh.a.

- Enti Rregullator i Energjisë me shkresën nr. 162 prot., datë 15.2.2019, njoftoi vendimin e Bordit me nr. 9, datë 24.1.2019 palëve OST sh.a., "KESH" sh.a., Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetit të Konkurrencës, ku në përfundim të afatit 15 ditor asnjë palë nuk shprehu opinion në lidhje me këtë kontratë.

- ERE në datë 20.3.2019 organizoi një seancë dëgjimore, me përfaqësues të palëve kontraktore KESH sh.a. dhe OST sh.a. dhe me anë të shkresës nr. 15/1 prot., datë 6.3.2019 kërkoi prej palëve kontraktore të depozitojnë paraprakisht në ERE, informacion shpjegues në lidhje me çështjet, të cilat

do të ishin objekt i diskutimit të kësaj seance si më poshtë:

- Sqarimet e palëve lidhje me procedurën që është ndjekur për arritjen e çmimit të dakordësuar;
- Kostot e shërbimeve të ofruara objekt i kësaj kontrate;
- Si do të aplikohet ky çmim i analizuar;
- Çmimi i dakordësuar reflekton apo jo parashikimet e Rregullave për shërbimin e balancimit.

Shoqëria KESH sh.a. nëpërmjet shkresës me nr. 6651/1 prot., datë 13.3.2019, protokolluar në ERE me nr. 15/2, datë 15.3.2019, shprehet se kontrata e nënshkruar ndërmjet KESH sh.a. dhe "OST" sh.a. për sigurimin e shërbimit të balancimit për vitin 2019, ka në përmbajtje të njëjtat parashikime me kontratën e zbatuar për vitin 2018. KESH sh.a. sqaron se kontrata e nënshkruar nga palët, është në përmbushje të detyrimit që buron nga neni 6, pika 2 e "Rregullave të Përkohshme për Mekanizmin Balancues të Energjisë Elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017 dhe çmimi i propozuar për shërbimin e balancimit (çmimi për kapacitet rezervë) merr në konsideratë elementët si më poshtë:

- Çmimet e ofrimit të shërbimit të balancimit në rajon ("FRR +/-" dhe "RR");
- Faktin që ky shërbim ofrohet në kushtet e detyrimit për shërbim publik;
- Ecuria e zbatimit të rregullave të balancimit deri më datë 31.12.2018.
- KESH sh.a. sqaron se çmimet e ofrimit të shërbimit të balancimit në rajon të cilat janë reflektuar dhe nga "OST" sh.a. gjatë aplikimit për tarifën e shërbimit të transmetimit për vitin 2018 janë përkatësisht 2.4 Euro/MW për rezervën sekondare (FRR+/-), dhe 5 euro/MW për rezervën terciale (RR), ndërsa çmimi i negociuar dhe dakordësuar ndërmjet palëve është me një diferencë të konsiderueshme, përkatësisht 2 euro/MW për rezervën sekondare (FRR+/-), dhe 2.9 euro/MW për rezervën terciale (RR). Nëse OST sh.a. do të siguronte këtë shërbim në tregun e parregulluar bazuar në çmimet e referencës sipas rajonit, shpenzimet e saj për rezervimin e kapacitetit rregullues do të rezultonin të ishin më shumë se dyfishi i shpenzimeve aktuale.
- Në përfundim KESH sh.a. shprehet se, megjithëse synohet të jepen sinjale nxitëse për hapjen e tregut të balancimit nëpërmjet kualifikimit të pjesëmarrësve të tjerë si ofrues të shërbimeve ndihmëse, përsëri çmimi i dakordësuar nuk reflekton kostot reale të aktivitetit të KESH sh.a., i cili është projektuar në vetvete si një detyrim për shërbim publik dhe që implikon të ardhura të munguara nga ofrimi i shërbimeve ndihmëse (detyrime që rrjedhin nga kontratat për sigurimin e shërbimit të balancimit për periudhën deri më 31.12.2018).
- Në vijim të kësaj korrespondence, pavarësisht konfirmimit nga ana e KESH sh.a. për pjesëmarrjen në seancën dëgjimore, në këtë seancë morri pjesë vetëm shoqëria OST sh.a., e cila dha shpjegime, si dhe kërkoi ndërhyrjen në kontratë në nenin 6 që lidhet me mos sigurimin e shërbimeve të balancimit dhe nenin 11 që lidhet me matjen dhe faturimin e shërbimit të balancimit. Nga ana e ERE-s u la detyrë që brenda një kohe sa më të shkurtër palët kontraktore të diskutonin dhe të përcillnin të dakordësuara propozimet konkrete apo ndryshimet në këto dy nene.
- Në përfundim të seancës dëgjimore, ERE nëpërmjet shkresës me nr. 15/3 prot., datë 29.3.2019, i është drejtuar palëve kontraktore, ku ka kërkuar që këto palë të shprehin qëndrimin e tyre përfundimtar në lidhje me "Kontratën për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektroenergjetik për periudhën kohore 1 janar 2019–31 dhjetor 2019" ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a.".
- Në përgjigje të kërkesës për shprehje të qëndrimit përfundimtar në lidhje me "Kontratën për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektroenergjetik për periudhën kohore 1 janar 2019–31 dhjetor 2019" ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a.", është shprehur shoqëria KESH sh.a. nëpërmjet shkresës me nr. 1626/1 prot., datë 5.4.2019, ku konfirmon qëndrimin për miratimin e kësaj kontrate, siç është nënshkruar prej palëve.
- Shoqëria OST sh.a. nëpërmjet postës elektronike të datës 5.4.2019, ka bërë me dije se, i qëndron sqarimeve dhe kërkesave të mbajtura në seancën dëgjimore të zhvilluar më datë 20.3.2019.
- ERE në vijim nëpërmjet shkresë me nr. 15/6 prot., datë 16.4.2019, ka rikërkuar nga ana e shoqërisë OST sh.a. sqarimin përfundimtar të qëndrimit të tyre në lidhje me "Kontratën për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit

rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektroenergjetik për periudhën kohore 1 janar 2019–31 dhjetor 2019" ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a.", duke i dërguar edhe një kopje të procesverbalit të kësaj seance OST-së, si dhe për dijeni KESH sh.a., për të evidentuar edhe një here mungesën e një propozimi në lidhje me ndryshime në këtë kontrate.

- OST sh.a. me shkresën nr. 65/4 prot., datë 2.5.2019, shprehet se i qëndron mendimit të shprehur në seancën dëgjimore të zhvilluar më datë 20.3.2019, por gjithashtu thekson se, nuk kanë patur asnjë reagim nga shoqëria KESH sh.a., megjithëse kjo e fundit është në dijeni të pretendimeve të ngritura nga ana e saj. ERE nuk është bërë me dije nëse ka pasur korrespondenca zyrtare apo diskutime dhe negociata mes palëve.

Në konkluzion të sa më sipër konstatojmë se:

- Kontrata për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektroenergjetik për periudhën kohore 1 janar 2019–31 dhjetor 2019" ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a.", është përcjellë në ERE e nënshkruar nga të dyja shoqëritë KESH sh.a. dhe OST sh.a.. Kjo kontratë është e njëjtë në formë dhe përmbajtje me atë të miratuar nga ERE me vendimin e Bordit nr. 184, datë 20.8.2018.

- Nuk rezulton provë e dokumentuar që Shoqëria OST sh.a., të ketë negociuar me palën tjetër kontraktore KESH sh.a., si dhe të kenë dakortësuar apo sjellë në ERE propozim për miratim të një kontrate të ndryshme nga ajo për të cilën është filluar procedura me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 19, datë 18.2.2019.

- Çmimet e përcaktuara në këtë kontratë, të cilat janë reflektuar dhe në aplikimin për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2019, mbështeten në nenin 11, pika 1, 2, 3 dhe 6 të Rregullave të Përkohshme për Mekanizmin Balancues të Energjisë Elektrike miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017, ku përcaktohet se:

1. Në mungesë të ofertave të balancimit komercialisht të nxitur, nga ofrues të shërbimeve të balancimit, për këto rregulla transitore një indeks tregu referent do të zbatohet si bazë për llogaritjen e çmimeve të disbalancës dhe të shërbimeve të balancimit.

2. Indeksi referent, i referuar në paragrafin 1 më lart, që do të shërbej si bazë për llogaritjen e çmimeve është çmimi orar i vendosur në tregun e një dite para të Hungarisë, HUPX. Ky është HUPX DAM në EUR/MWh dhe publikohet mbi baza ditore për ditën e ardhshme të livrimit në faqen e web-it HUPX (www.hupx.hu).

3. Atëherë kur çmimi referent nuk është i disponueshëm për shkak të dështimit në mekanizmin e ankandit të një dite përpara, OST-ja mund të përdorë një çmim tjetër referent për ditët-orët kur këto çmime mungojnë. Çmimi referent që OST-ja do të përdorë në këto rrethana është ai i vendosur në tregun e një dite përpara të tregut të Serbisë, SEEPEX. Ky është çmim i një dite para, në EUR/MWh dhe publikohet mbi baza ditore për ditën e ardhshme të livrimit, në faqen e web-it SEEPEX (www.seepex-spot.rs).

6. Pavarësisht Çmimet e vendosura sipas këtyre rregullave mund të mos reflektojnë vlerën e tregut në kohën reale të energjisë elektrike të Shqipërisë, prandaj përdorimi i tyre, për llogari të kontratave të ekzekutuara bilateralisht, ato fizike ose financiare, do të jenë në diskrecionin e pjesëmarrësve të tregut.

- Në përfundim, në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 266, datë 21.12.2018 "Mbi përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga shoqëria "OST" sh.a. për vitin 2019", shpenzimet për shërbimet ndihmëse u njohën në vlerën 186 milion Lekë, vlerë e njëjtë kjo me realizimin e këtij shpenzimi gjatë vitit 2018, ku çmimet e aplikuara midis palëve janë të njëjta me ato të reflektuara në "Kontratën për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektroenergjetik për periudhën kohore 1 janar 2019–31 dhjetor 2019" ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a..".

- Palët e kësaj kontrate janë subjekte juridike të legjitimuara për nënshkrimin e kontratës "Për sigurimin e shërbimeve të balancimit(kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektroenergjetik për periudhën kohore 1.1.2019–31.12.2019" midis OST sh.a. dhe KESH sh.a.", duke pasur parasysh që licenca e shoqërisë OST sh.a., në aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike është rinovuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 134, datë 6.9.2017 dhe licenca e shoqërisë KESH sh.a. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike është rinovuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016.

- Dispozitat e parashikuara në nenin 9 të kësaj kontrate janë objekt negocimi mes palëve e përcaktohen duke u mbështetur në nenin 11 të Rregullave të përkohshme të mekanizmit balancues, por nuk janë objekt miratimi nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e "Kontratës për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektroenergjetik për periudhën kohore 1 janar 2019–31 dhjetor 2019" ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a.."(bashkëlidhur)

2. Neni 9 i kësaj kontratë ndryshon si më poshtë:

a) Çmimi i negociuar mes palëve për sigurimin e kapacitetit të Rezervës së Restaurimit të frekuences në drejtim ngritje/ulje është 270 lekë/MW /h;

b) Çmimi për sigurimin e kapacitetit të Rezervës Zëvendësuese (RR) i negociuar mes palëve është 400 leke/MW /h;

c) Çmimet janë subjekt i negocimit dhe vullnetit respektiv të KESH sh.a. dhe OST sh.a.;

d) Çmimi i ofrimit të energjisë balancuese është ai i kalkuluar mbi bazën e mekanizmit të përcaktuar në nenin 11 të "Rregullave të Përkohshme për Mekanizmin Balancues të Energjisë Elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë KESH sh.a. dhe OST sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetin e Konkurrencës, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1.1.2019–31 dhjetor 2019..

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KONTRATË
PËR SIGURIMIN E SHËRBIMIT TË BALANCIMIT (KAPACITETIT REZERVË DHE ENERGJISË BALANCUESE) NDËRMJET KORPORATËS ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE (MË POSHTË REFERUAR SI KESH SHA)

Adresa: rruga "Viktor Eftimiu", blloku "Vasil Shanto", Tiranë

dhe

OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT sh.a.

(më poshtë referuar si "OST" sh.a.)

Adresa: Autostrada Tiranë–Durrës, km. 9, Yrshek, Kashar, Tiranë

KESH sh.a. dhe OST sh.a. më poshtë referuar si "Palët"

Tiranë, _____2018

Baza ligjore

Baza ligjore për hartimin dhe nënshkrimin e kësaj kontrate është:

a) Ligji nr. 43/2015, datë 30.4.2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar;

b) Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2015 "Për Miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", i ndryshuar;

c) Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 139, datë 25.8.2016 "Mbi rregullat e përkohshme të tregut të energjisë elektrike" i ndryshuar;

d) Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017 "Mbi miratimin e Rregullave të përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike";

e) Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017 "Mbi miratimin e Kodit të Transmetimit";

f) Vendimet nr. 23, datë 25.3.2009 dhe nr. 34, datë 13.5.2014, me të cilat Enti Rregullator i Energjisë (ERE), ka vendosur rinovimin përkatësisht të licencave për prodhimin dhe tregtimin e energjisë elektrike, për KESH sh.a. (ndryshuar me vendimin nr. 97, datë 17.6.2016, "Mbi miratimin e licencës së tregtimit të energjisë

elektrike" dhe vendimin nr. 99, datë 17.6.2016, "Mbi miratimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike)"

g) Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 43, datë 15.3.2017, "Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a.";

h) Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 134, datë 6.9.2017 "Mbi licencimin e Shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit OST sh.a., në aktivitetin e Operimit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike".

Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1
Përkufizime

Përveç rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë kontratë ose kur konteksti e kërkon ndryshe, të gjithë termat e mëposhtëm do të kenë kuptimin e përcaktuar në këto përkufizime:

"Kontratë" do të thotë kjo kontratë dhe të gjitha ndryshimet që mund t'i bëhen kësaj kontrate së bashku me anekset dhe çdo dokumentacioni bashkëlidhur.

"Data e fillimit" do të thotë dita nga e cila kontrata fillon të bëhet efektive.

"Muaji" do të thotë muaji kalendarik.

"Viti" do të thotë viti kalendarik.

"Korporata Elektroenergjitike Shqiptare" sh.a. ose "KESH" është personi juridik i licencuar nga ERE për prodhimin dhe tregtimin e energjisë elektrike.

"Operatori i Sistemit të Transmetimit" sh.a. ose "OST" është personi juridik, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit të Sistemit të Transmetimit, duke përfshirë interkoneksionet me sistemet e tjera ndërkufitare, për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike.

"Enti Rregullator i Energjisë" ose "ERE", është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjin për sektorin e energjisë dhe ligjin për sektorin e gazit.

"Sistem i Transmetimit" është sistemi i përdorur për transmetimin e energjisë elektrike në tension të lartë dhe shumë të lartë, i lidhur në paralel me sistemet e vendeve të tjera, që përfshin midis të tjerave linjat, strukturat mbështetëse, pajisjet transformuese dhe kyçëse/shkyçëse për lëvrimin e energjisë elektrike te klientët ose në rrjetin e shpërndarjes, pa përfshirë furnizimin.

"Sistemi i energjisë elektrike" është një Sistem i ndërlidhur, i përbërë nga Centralet Elektrike, linjat elektrike, nënstacionet dhe pajisjet e Transmetimit dhe Shpërndarjes me qëllim transmetimin apo shpërndarjen e energjisë elektrike te klientët.

"Pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike" është një person juridik, i regjistruar si pjesëtar i tregut të energjisë elektrike, që përfshin prodhuesit, tregtarët, furnizuesit, klientët, Operatori i Sistemit të Transmetimit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, sistemet e mbyllura të shpërndarjes dhe operatori i tregut. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes janë pjesëmarrës të tregut të energjisë elektrike vetëm për qëllim të sigurimit të energjisë elektrike të nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjet, balancimin dhe shërbimet ndihmëse.

"Rezerva e mbajtjes së frekuencës (FCR)" është ajo rezervë që në rast të devijimit të frekuencës nga vlerat e lejuara, aktivizohet automatikisht dhe plotësisht brenda 30 sec, duke vazhduar të jetë efektive për rreth 15 min, nëpërmjet kontrollit automatik RASH (Rregullatori Automatik i Shpejtësisë) të çdo agregati që mbahet vazhdimisht në punë.

"Rezerva e restaurimit të frekuencës (FRR)" është rezerva e rivendosjes së frekuencës.

"Rezerva zëvendësuese (RR)" është rezerva e rregullimit terciar e cila aktivizohet manualisht sipas kërkesës së Operatorit të Transmetimit, në rast se vihet re aktivizim i vazhdueshëm i rezervës FRR deri në limitet e paracaktuara. Qëllimi kryesor i rezervës terciare është të çlirojë rezervën FRR dhe ta kthejë në gatishmëri për aktivizimin e radhës, si dhe të përdoret si rezervë suplementare për rezervën FRR kur shfaqet një incident në sistemin elektroenergjetik. Koha e aktivizimit të rezervës RR është 15 min nga kërkesa e bërë nga operatori i QDK.

"Kapacitet rezervë në ngritje/ulje" është kapaciteti rezervë FRR dhe RR.

"Rregullat e përkohshme të mekanizmit balancues" Rregullat e përkohshme për mekanizmin balancues (Rregullat për Mekanizmin Balancues) miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017 mbi miratimin e

"Rregullave të përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike".

"Mekanizmi Balancues i Energjisë Elektrike" një mekanizëm i operuar nga OST në përputhje me "Rregullat e përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike".

"Shërbime Ndihmëse" janë shërbimet e nevojshme për operimin e qëndrueshëm të sistemit të transmetimit ose shpërndarjes.

"Shërbimi i Balancimit" është sigurimi i kapacitetit rezervë të kontraktuar dhe/ose energjia balancuese e përdorur nga Operatori i Sistemit të Transmetimit për të kryer balancimin.

"Ofruesi i shërbimit të balancimit" është një pjesëmarrësi tregut të energjisë elektrike që siguron shërbimet e balancimit për Operatorin e Sistemit të transmetimit, në bazë të një kontrate për pjesëmarrje në tregun e balancimit, në përputhje me rregullat e balancimit të sistemit elektrik.

"Siguruesi i shërbimeve të balancimit" është një pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike, i cili siguron shërbimet e balancimit për Operatorin e Sistemit të Transmetimit, bazuar në kontratën për pjesëmarrjen në tregun e balancimit, sipas rregullave të balancimit të sistemit të energjisë elektrike.

"Përfaqësues i Autorizuar" është person i ngarkuar zyrtarisht nga përfaqësuesi ligjor i shoqërive OST sh.a. dhe KESH sh.a. për të garantuar zbatimin e kësaj kontrate.

"Urdhër Operativ" është urdhër që jepet nga Qendra Dispeçer e OST-së në përputhje me këtë kontratë dhe i detyrueshëm për tu zbatuar nga Qendra Dispeçer e KESH-it. Këto urdhra jepen nëpërmjet telefonit të dedikuar me regjistrim, fonogrameve, faksit dhe mesazheve kompjuterike prej instalimeve SCADA të Sistemit Elektroenergjetik.

"Veprim Operativ" është veprimi që ndërmerret nga Qendra Dispeçer e KESH-it për zbatimin e urdhrit operativ të lëshuar nga Qendra Dispeçer e OST-së në përputhje me këtë kontratë.

Neni 2
Objekti i kontratës

Objekt i kësaj kontrate është ofrimi (shitja) nga ana e KESH-it dhe sigurimi (blerja) nga ana e OST-së e shërbimit të balancimit (kapacitet dhe energji balancuese) që do të përdoret për balancimin e sistemit elektroenergjitik sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë.

Neni 3
Detyrimet e KESH sh.a.

3.1 KESH merr përsipër të sigurojë shërbimin e balancimit për OST, në sasinë dhe kohën e kërkuar nga OST dhe të konfirmuar nga KESH sh.a. sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë.

3.2 KESH merr përsipër të vendosë në dispozicion kapacitetet rezervë në ngritje/ulje, në masën e kërkuar në avancë nga OST, të cilat aktivizohen vetëm me kërkesë të OST dhe për qëllim të balancimit të sistemit elektroenergjitik shqiptar.

3.3 Kjo kontratë për sigurimin e shërbimeve të balancimit për sa konfirmohet nga KESH në avancë ka prioritet ndaj të gjitha marrëdhënieve të tjera tregtare të KESH.

Neni 4
Shërbimet Ndihmëse që Sigurojnë Gjenerimin/Absorbimin e Fuqisë reaktive, Mbajtjen e Niveleve të Tensionit

4.1 KESH-i, nëpërmjet Qendrës Dispeçer, merr përsipër të sigurojë që gjenerimi/absorbimi i fuqisë reaktive, do të garantohet nga njësitë gjeneruese sipas kërkesës së paraqitur nga Qendra Dispeçere OST sh.a., kërkesë kjo në përputhje me kushtet e lidhjes me Rrjetin e Transmetimit.

4.2 Në bazë të studimeve mbi shpërndarjen e fluksit dhe nivelet e tensionit dhe brenda shërbimit të kontraktuar, Qendra Dispeçer e OST-së udhëzon Qendrën Dispeçer të KESH-it të mbajnë nivele tensioni të specifikuara në pikat e lidhjes së tyre me Sistemin e Transmetimit.

4.3 Kërkesat minimale për njësitë gjeneruese të KESH-it që do të marrin pjesë në sigurimin e shërbimit të balancimit parashikohen në aneksin 2.

Neni 5
Mundësia për ristartim

5.1 KESH-i merr përsipër të mbajë grupe diesel në të tre centralet e saj, për të mundësuar ristartimet e tyre në mungesë të tensionit në pikën e lidhjes me rrjetin e transmetimit.

5.2 KESH-i duhet të garantojë që grupet diesel në secilin prej centraleve, duhet të jenë në kushte të mira dhe në gatishmëri në çdo kohë, në mënyrë që agregatet të startohen pa prezencë tensioni nga Sistemi i Transmetimit.

Neni 6
Mossigurimi i shërbimeve të balancimit

6.1 Energjia e devijuar përkundrejt interkoneksionin në drejtim ulje/ngritje nga palët përgjegjëse për balancimin, për efekt të zbatimit të mekanizmit të përkohshëm të balancimit do të llogaritet si shërbim balancimi i ofruar nga KESH-i.

6.2 Kompensimi i devijimeve nga programi i shkëmbimit, i lëvrimit të energjisë në rrjetin interkonektiv ose i tërheqjes së energjisë nga rrjeti interkonektiv, jashtë programit të shkëmbimit, bëhet nëpërmjet programeve të kompensimit, që llogariten nga Qendra Koordinative e Rajonit, me bazë javore, dhe janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo zonë kontrolli (OST), për t'u lëvruar/tërhequr nga rrjeti interkonektiv, sipas tarifave (blloqe orare) të ENTSO-E.

6.3 OST sh.a. pas marrjes së njoftimit, do t'i bëjë me dije/dërgojë KESH sh.a. programin e kompensimit të devijimeve nga programi i shkëmbimit, i lëvrimit të energjisë elektrike të llogaritur nga Qendra Koordinative e Rajonit sipas tarifave (blloqe orare) të ENTSO-E.

6.4. KESH-i është përgjegjëse për mbulimin e programeve të kompensimit të OST-së me interkoneksionin pa kosto shtesë.

Neni 7
Detyrimet e OST-së

7.1 OST-ja do të dërgojë në KESH kërkesën (skedulin) mujore me treguesit për kapacitetin rezervë në ngritje/ulje të kërkuar jo më vonë se 10 ditë përpara fillimit të muajit për muajin pasardhës.

7.2 KESH-i, referuar kërkesës (skedulit) mujore të dërguar nga OST-ja për muajin pasardhës, jo më vonë se 8 ditë përpara fillimit të muajit do t'i dërgojë OST-së konfirmimin mbi mundësinë e sigurimit të kapacitetit rezervë në ngritje/ulje të kërkuar nga OST-ja për muajin pasardhës.

7.3 OST-ja, bazuar në konfirmimin e bërë nga KESH-i për muajin pasardhës, jo më vonë se ora 12:00 e ditës së premte të çdo jave, do t'i dërgojë KESH-it kërkesën (skedulin) javor me treguesit indikativ të kapacitetit rezervë në ngritje/ulje të kërkuar për javën pasardhëse. KESH-i, referuar kërkesës së OST-së për javën pasardhëse, jo më vonë se ora 14:00 e së njëjtës ditë, do t'i dërgojë OST-së konfirmimin mbi mundësinë e sigurimit të kapacitetit rezervë të kërkuar nga OST-ja për javën pasardhëse.

7.4 Kërkesa (skeduli) i dërguar nga OST-ja do të përmbajë, treguesit e kapacitetit të rregullimit në ngritje/ulje në MW me bazë orare për ditën e mesatarizuar të javës pasardhëse. Ky skedulim është i vlefshëm për të gjitha ditët e javës pasardhëse.

Neni 8
Kontrolli, monitorimi dhe testimi

Aktivitetet e kontrollit monitorimit dhe testimit për njësitë gjeneruese, që do të marrin pjesë në sigurimin e shërbimeve ndihmese dhe monitorimi i kapacitetit rezervë do të bëhet nëpërmjet sistemit SCADA që administrohet vetëm nga OST-ja.

Neni 9
Çmimi për sigurimin e shërbimit të balancimit (kapacitet dhe/ose energji balancuese)

9.1 Çmimi për sigurimin e kapacitetit të Rezervës së Restaurimit të frekuencës në drejtim ngritje/ulje është 270 lekë/MW/h.

9.2 Çmimi për sigurimin e kapacitetit të Rezervës Zëvendësuese (RR) është 400 lekë/ MW/ h.

9.3 Çmimi i ofrimit të energjisë balancuese është ai i miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017, mbi miratimin e "Rregullave të përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike".

Neni 10
Matja dhe faturimi i shërbimit të balancimit (kapacitet rezervë)

10.1 KESH-i, bazuar në të dhënat për kapacitetin e kërkuar nga OST-ja dhe të siguruar KESH-in (nominuar) për secilën javë të muajit objekt faturimi, brenda ditës së 2 (dytë) të punës së çdo muaji, për muajin paraardhës të sigurimit të

shërbimit të balancimit (kapacitetit rezervë), do t'i dërgojë OST faturën paraprake e cila do të përmbajë shumën e kapaciteteve orare të mesatarizuara për 24 orë (ditore) të kërkuar dhe konfirmuar nga palët respektivisht për kapacitetin rezervë në ngritje/ulje për muajin përkatës, çmimin respektiv të kapacitetit rezervë në ngritje/ulje siç parashikohet në nenin 9 dhe vlerën totale të shërbimit të siguruar nga KESH-i për periudhën në fjalë.

10.2 KESH-i, brenda ditës së 8 (tetë) të punës të çdo muaji, për muajin paraardhës, do të përgatisë dhe dërgojë në OST faturën tatimore për shërbimin e balancimit (kapacitetit rezervë në ngritje/ulje) të siguruar për OST-në për periudhën objekt faturimi.

10.3 Kursi i këmbimit për konvertimin e euro (EUR) në lek shqiptar (ALL), do jetë ai i datës së lëshimit të faturës tatimore sipas kursit të publikuar nga Banka e Shqipërisë në www.bankofalbania.org.

Neni 11

Matja dhe faturimi i shërbimit të balancimit (energjisë balancuese)

11.1 Energjia balancuese e aktivizuar si shërbim balancues paraqet shumën e energjisë aktivizuar nga të gjitha njësitë balancuese të grupit përgjegjës për balancim. Energjia balancuese e aktivizuar përcaktohet duke u bazuar në kërkesën për aktivizim nga OST-ja dhe/ose nevojën për balancim të sistemit dhe si e tillë konsiderohet ndryshim në skedulën e palës përgjegjëse për balancim.

11.2 Llogaritja dhe faturimi i shërbimit të balancimit (energjisë balancuese) bëhet në bazë të matjes së energjisë orare nga qendra e menaxhimit të energjisë në OST, për çdo agregat/central dhe në total për centralet e KESH-it, dhe krahasohet me nominimin me bazë orare të deklaruar nga KESH-i.

11.3 Diferenca ndërmjet matjes së energjisë dhe nominimit, për çdo ore, do të konsiderohet si energji balancuese nëse justifikohet me kërkesën e bërë nga OST-ja për ngritje/ulje të gjenerimit në mënyrë automatike dhe manuale dhe/ose rezulton se ka shërbyer për balancimin e sistemit në kushtet kur KESH sh.a. është ofrues i vetëm i shërbimit të balancimit dhe mbulon programet e kompensimit me interkoneksionin.

11.4 OST-ja, brenda ditës së 5 (pestë) të punës të muajit pasardhës të ofrimit të shërbimit të balancimit, do t'i dërgojë KESH sh.a. të dhënat e detajuara mbi shërbimin e balancimit (energjinë balancuese) të ofruar nga KESH-i. Bazuar në të dhënat që rakordohen ndërmjet OST-së dhe KESH-it brenda ditës së 7 (shtatë), palët brenda ditës së 8 (tetë) lëshojnë faturat përkatëse të shërbimit të balancimit (energjisë balancuese) nga ku OST-ja faturën për shërbimet ndihmëse (energjinë balancuese) në ulje dhe KESH sh.a. për shërbimet ndihmëse (energjinë balancuese) në ngritje.

11.5 Kursi i këmbimit për konvertimin e euro (EUR) në lek shqiptar (ALL), do jete ai i datës së lëshimit të faturës tatimore sipas kursit të publikuar nga Banka e Shqipërisë në www.bankofalbania.org.

Neni 12

Pagesa e Shërbimit të balancimit (kapacitet rezervë dhe energji balancuese)

12.1 Sipas rastit, palët do të kryejnë pagesat kundrejt vlerave të faturave mujore përkatëse për shërbimin e balancimit brenda ditës së 30 të muajit kalendarik në të cilën është lëshuar secila prej faturave.

12.2 Vonesa në kryerjen e pagesës: Nëse palët dështojnë të kryejnë pagesat brenda afatit të përcaktuar në këtë kontratë, shpërblimi për dëmet e shkaktuara si rezultat i vonesës, do të jetë ai i parashikuar në ligjin nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare", i ndryshuar.

Neni 13

Mosperformanca për shkak të Forcës Madhore

13.1 Përveç se kur specifikohet ndryshe në këtë kontratë, "Forca Madhore" për qëllimet e kësaj kontrate do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të arsyeshëm të një pale që e pengon atë palë të realizojë disa ose të gjitha detyrimet e kësaj kontrate. Ngjarjet e forcës madhore do të përfshijnë pa kufizim:

a) një ngjarje ose një akt natyror ose shoqëror që ndodh në vend, si tërmetet, ciklonet, rrufetë, përmbytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret, lufta, konfliktet e armatosura, kryengritjet, aktet

terroriste, të cilat pengojnë secilën palë të përmbushë detyrimet e saj sipas kësaj kontrate, si dhe akte ose ngjarje të tjera, të cilat janë jashtë kontrollit të mundshëm të një pale dhe nuk ndodhin për faj të saj dhe që pala nuk është në gjendje t'i eliminojë ato, edhe pse ka ushtruar siç duhet aftësitë, përpjekjet dhe kujdesin e saj, si dhe rastet e parashikuara nga neni 90 i ligjit nr. 43/2015, datë 30.4.2015 "Për sektorin e energjisë elektrike".

13.2 Nëse një palë pengohet plotësisht ose pjesërisht për shkak të Forcës madhore, në kryerjen e detyrimeve të saj për lëvrim dhe pranim sipas kësaj kontrate dhe kjo palë respekton kërkesat e pikës 13.3 të këtij neni, do të konsiderohet se nuk ka ndodhur asnjë shkelje ose mospagim nga ana e Palës Pretenduese dhe ajo do të çlirohet nga këto detyrime për atë periudhe kohore që kjo Forcë Madhore e pengon performancën e saj. Asnjë detyrim për të paguar dëmet (Zhdëmtimet për Paaftësinë për Lëvrim dhe Pranim) nuk do t'i kërkohet dhe merret Palës lidhur me sasitë e palëvruara respektivisht të pa marra si rezultat i Forcës Madhore.

13.3 Sa më shpejt që të jetë e mundur, pasi konstaton Forcën Madhore Pala që kërkon përjashtim nga detyrimet e veta, do të njoftojë Palën tjetër për ngjarjen e Forcës Madhore dhe, për aq sa është e mundur do t'i sigurojë një vlerësim jodetyrues mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë së saj performuese. Pala Pretenduese do të përdorë gjithë përpjekjet ekonomikisht të favorshme dhe të ligjshme për të lehtësuar efektet e Forcës Madhore dhe gjatë vazhdimit të Forcës Madhore, do t'i sigurojë Palës tjetër të dhëna të përditësuara, mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë performuese.

Neni 14
Zgjidhje e mosmarrëveshjeve dhe ligjet e zbatueshme

14.1 Për çdo gjë të pashprehur në këtë kontratë, palët do t'i referohen dispozitave të legjislacionit që rregullojnë sektorin e energjisë elektrike.

14.2 Kjo kontratë do të zbatohet në përputhje me të gjitha aktet normative me fuqi juridike në territorin e Republikës së Shqipërisë.

14.3 Në rast të lindjeve të mosmarrëveshjeve gjatë zbatimit të kësaj kontrate, përfaqësuesit e autorizuar për çdo Palë, do të tentojnë me mirëbesim të zgjidhin mosmarrëveshjen sa më shpejt që të jetë e mundur. Në qoftë se përfaqësuesit arrijnë ta zgjidhin mosmarrëveshjen, zgjidhja do t'u njoftohet Palëve me shkrim dhe do të jetë detyruese për to. Në qoftë se përfaqësuesit nuk mund ta zgjidhin mosmarrëveshjen brenda një afati kohor të arsyeshëm, por jo më të gjatë se 40 (dyzet) ditë kalendarike, ose në qoftë se një Palë nuk arrin të zgjedhë një përfaqësues, brenda 10 (dhjetë) ditësh kalendarike nga njoftimi me shkrim i ekzistencës së mosmarrëveshjes, atëherë secila prej Palëve ka të drejtë t'i drejtohet ERE-s, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

14.4 Secila palë ka të drejtë që, që nga dita që ka marrë njoftim për vendimin e ERE-s, t'i drejtohet gjykatës kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Neni 15
Ndryshimet

Kjo kontratë mund të ndryshohet vetëm me një dokument të shkruar të firmosur nga të dyja Palët dhe të miratuar nga ERE.

Neni 16
Klauzola përfundimtare

Palët bien dakord që:

i) do të ndërmarrin të gjitha veprimet që janë të arsyeshme, në mirëbesim dhe të nevojshme për të siguruar vijimësinë e shërbimit dhe aplikimit të kësaj kontrate;

ii) do të negociojnë dhe të rishikojnë këtë kontratë kur është e nevojshme për tu përshtatur me të gjitha ndryshimet në aktet normative me fuqi juridike në territorin e Republikës së Shqipërisë; dhe

iii) përveç rasteve kur përshkruhet ndryshe në këtë kontratë të ruajnë siç parashtrohet në këtë kontratë, të mos e ndërpresin ose të pezullojnë përmbushjen e ndonjë detyrimi si rezultat i ndonjë vendimi në pritje për ndonjë debat ndërmjet palëve.

Neni 17
Hyrja në fuqi dhe afati i zbatimit të kontratës

17.1 Kjo kontratë nënshkruhet nga palët dhe hyn në fuqi pas miratimit nga ERE.

17.2 Kjo marrëveshje i shtrin efektet e saj nga data 1.1.2019 (data e fillimit), deri në datën 31.12.2019 (data e përfundimit).

Kontrata hartohet në 3 (tri) kopje origjinale, nga një për secilën pale dhe një për ERE-n.

PËR KORPORATËN ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE, KESH SHA
ADMINISTRATORI
Agron Hetoja

PËR OPERATORIN E SISTEMIT TË TRANSMETIMIT OST SHA
ADMINISTRATORI
Klodian Gradeci

ANEKSI 1

Palët bien dakord që rezerva mbajtjes së frekuencës (FCR), Rezerva e Restaurimit të Frekuencës (FRR) do të sigurohen nga KESH sh.a. duke përdorur burimet e mëposhtme. KESH sh.a. do të bëjë përpjekjet e tij më të mira, që gjatë kohëzgjatjes së kontratës do të sigurojë shërbimet ndihmëse sipas tipit, sasisë dhe cilësisë sipas kërkesës së OST sh.a.

1. Rezerva e mbajtjes së frekuencës (FCR) vendoset në të gjithë agregatet e lidhur direkt me Rrjetin e Transmetimit, në mënyrë sa me uniforme dhe proporcionale që të jetë e mundur. Njësitë gjeneruese duhet të jenë të pajisura me Rregullator Automatik të Shpejtësisë (RASH). Saktësia e matjes së frekuencës për rregullimin primar duhet të jetë më e mirë ose e barabarte me 10 mHz. Intervali i mos ndjeshmërisë së rregullatorit të njësive gjeneruese nuk duhet të kalojë ±10 mHz. Aktivizimi i Rregullimit Primar në njësitë gjeneruese fillon para se devijimi i frekuencës të kalojë ±20 mHz (që është shuma e saktësisë së matjes së frekuencës dhe intervali i mos ndjeshmërisë së rregullatorit. Sipas planifikimit vjetor që bëhet nga ENTSO-E, kontributi i zonës tonë të kontrollit në rregullimin primar për vitin 2018 është 6MW, nga 3000 MW që është rezerva totale e këtij rregullimi për rrjetin sinkron të ENTSO-E, dhe konstantja e vendosur në rregullatore (karakteristika fuqi – frekuencë e rrjetit) 51 MW/Hz, nga 27002MW/Hz që është konstantja totale e rrjetit sinkron. Në rastin kur sistemi elektroenergjetik punon i izoluar nga sistemet fqinje, rezerva minimale e rregullimit primar vendoset jo më e vogël se 5% e ngarkesës totale të sistemit.

2. Rezerva e restaurimit të frekuencës aFRR përdoret (në mënyrë automatike) në rast të devijimit të frekuencës nga vlera nominale dhe/ose të balancës së shkëmbimit nga vlera e programuar. Kjo rezervë vendoset në agregatet/centralin rregullues të destinuar për këtë qëllim. Sipas Manualit Operacional të ENTSO-E (Policy 1), për llogaritjen e kësaj rezervë, në mënyrë orientuese, përdoret formula e mëposhtme:

$R = \sqrt{aL_{\max} + b^2} - b$, ku a = 10, b = 150, dhe L është ngarkesa e konsumit.

Rezerva e Restaurimit të frekuencës automatike shfrytëzon në mënyrë të centralizuar dhe të vazhdueshme Rregullimin Automatik të Gjenerimit, duke modifikuar pikën e punës të fuqisë aktive të njësive gjeneruese, për një periudhë kohë që fillon pas disa sec e deri në 15 min pas incidentit. Saktësia e matjes së frekuencës për këtë rregullim duhet të jetë ndërmjet 1.0 mHz dhe 1.5 mHz.

Në tabelën e mëposhtme jepen centralet dhe kapaciteti i instaluar i Njësive Gjeneruese të cilat do të sigurojnë shërbimet ndihmëse për sistemin elektroenergjetik.

CENTRALI	KAPACITETI INSTALUAR (MW)
Fierze	4 X 125
Koman	4 X 150
Vau Dejes	5 X 50

Më poshtë në tabelë tregohet alokimi i kapacitetit të rezervës FRR sipas të dy drejtimeve ngritje/ulje dhe rezervës RR i cili jepet në tabelën e mëposhtme, (shembull ilustrues):

Tipi i Rezerves	1	2	3	...	19	20	21	22	23	24	Mesatare
FRR+	22	21	20		68	74	68	60	47	37	48
FRR-	37	36	35	...	43	44	43	40	37	32	37
RR+	70	70	70	...	70	70	70	70	70	70	70
RR-	10	10	10	...	10	10	10	10	10	10	10

ANEKSI 2

Çdo Njësi Gjeneruese që merr pjesë në sigurimin e shërbimeve ndihmëse minimumi duhet të ketë aftësitë e mëposhtme:

i) Të gjenerojë dhe të operojë me parametra normal për frekuenca të Sistemit të Transmetimit në diapazonin 49.5 Hz – 50.5 Hz.

ii) Të mbetet e sinkronizuar me Sistemin e Transmetimit për frekuenca në Sistemin e Transmetimit në diapazonet 47.5 Hz – 49.5 Hz dhe 50.5 Hz – 52.5 Hz për një kohë prej 60 minutash.

iii) Të mbetet e sinkronizuar me Sistemin e Transmetimit për frekuenca në Sistemin e Transmetimit në diapazonet 47.0 Hz – 47.5 Hz për një kohë prej 20 sekonda. Kjo kërkohet për çdo herë që frekuenca është nën 47.5 Hz.

iv) Të mbetet e sinkronizuar me Sistemin e Transmetimit për frekuenca në Sistemin e Transmetimit në diapazonet 52.5 Hz – 53 Hz për një kohë prej 5 sekonda. Kjo kërkohet për çdo herë që frekuenca është mbi 52.5 Hz.

v) Të mbetet e sinkronizuar me Sistemin e Transmetimit gjatë ndryshimit të frekuencës në Sistemin e Transmetimit në vlera më të mëdha dhe të barabarta me 0.5 Hz për sekondë.

vi) Të vazhdojë operimin në minimumin e specifikuar të Gjenerimit brenda vlerave 49.8 Hz – 51.0 Hz.

vii) Të mbetet e sinkronizuar gjatë ndryshimit të nivelit të tensionit në Sistemin e Transmetimit në vlera me të vogël dhe të barabarte me 10%.

viii) Të vazhdojë operimin në përputhje me Kurbën e Aftësisë Reaktive siç kërkohet nga Sistemi i Transmetimit për mbajtjen e niveleve të Tensionit.

ix) Të vazhdojë të mbetet i sinkronizuar gjatë prishjes së balancës gjenerim – ngarkesë sipas standardeve IEC 60034-1.

x) Vlera e rrymës së Lidhjes së Shkurtër duhet të jetë sipas standardeve IEC 60034-1.

xi) Gjenerimi Minimal: jo më i madh se 50% e Kapacitetit Nominal.

xii) Aftësia për Ngritjen e Gjenerimit: jo më i vogël se 1.5% e kapacitetit nominal për minutë, kur njësia është në kushte normale operimi.

xiii) Aftësia për Uljen e Gjenerimit: jo më i vogël se 1.5% e kapacitetit nominal për minutë, kur njësia është në kushte normale operimi.

xiv) Njësitë gjeneruese duhet të vazhdojnë të operojnë dhe kur profilet e tensionit në Sistemin e Transmetimit janë në nivelet e paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Niveli i Tensionit	Lidhur në:	Në Kapacitet Maksimal cosφ	Në50% të Kapacitetit Maksimal cosφ
99kV – 123kV	110 kV	0.93 – 0.85	0.7 – 0.4
90kV – 100kV		0.85	0.7 – 0.4
140kV – 163kV	150 kV	0.93 – 0.85	0.7 – 0.4
125kV - 140kV		0.85	0.7 – 0.4
198kV – 242kV	220 kV	0.85 – 0.93	0.7 – 0.4
190kv – 200kV		0.85	0.7 – 0.4
360kV – 420kV	400 kV	0.93 – 0.85	0.7 – 0.4
350kV- 360kV		0.85	0.7 – 0.4

ANEKSI 3

Formati i skedulimit vjetor, mujor, dhe ai javor që do të përdoret si bazë për llogaritjen e kapacitetit rezervë.

Energjia e mesatarizuar për orën përkatëse të urdhrit të dhënë nga OST-ja për ngritje ose ulje të gjenerimit, në kuadrin e rregullimit automatik dhe manual sipas kësaj Marrëveshje përmbledhurash do të llogaritet sipas formulës:

ΣP reg = ΣP ngritje/ulje, auto + ΣP ngritje/ulje, manual

- ΣP ngritje/ulje, auto - Kërkesa për rregullim automatik për njësitë gjeneruese të cilat janë nën kontrollin fuqi-frekuence.

ΣP ngritje/ulje, manual - Kërkesa për rregullim manual do të bazohet në urdhrat e lëshuar sipas hierarkisë, QDK (OST) --> KESH. Urdhrat do të dokumentohen sipas formatit të aneksit 4. Në çdo rast pas dhënies së urdhrit nga QDK duhet konfirmuar ekzekutimi tij nga ana e KESH-it (me kërkesë për rregullim manual kuptohet aktivizimi i rezervës së zëvendësimit

- Aktivizimi i rezervës së restaurimit automatik (FRR)

Për qëllime të përllogaritjes së aFRR, do të përdoren të dhënat e përftuara nga sistemi kontrollit fuqi-frekuence (LFC) instaluar në Qëndron Dispeçer Kombëtare të OST sh.a. Duke qenë se ky sistem është unik, të dhënat e përftuara nga ky sistem do të konsiderohen të pa kontestueshme duke qenë se aktualisht nuk ka një sistem tjetër për të kontestuar të dhënat e përftuara nga ky sistem. Çdo ditë OST sh.a. do të ekstraktojë të dhënat e një dite më parë mbi pikat e punës për gjeneratorët të cilët kanë qenë të aktivizuar për dhënien e aFRR. Përjashtohet dita e shtunë dhe e diel të cilat janë ditë pushimi dhe të dhënat për këto ditë do të ekstraktohen ditën e hënë të javës pasuese.

Llogaritja e rezervës së restaurimit të frekuencës automatike (FRR) do të jetë si më poshtë:

C= Matja-Kërkesë =B-(A-D)

A→Kërkesa për aFRR (set point), do të llogaritet si mesatare algjebrike e pikave të punës të dërguara çdo 4s nga LFC.

$$A=\frac{\sum_{i=1}^{n} \text{set point}_i}{n}$$

B→Energjia e prodhuar nga njësia/njësitë që kanë ofruar aFRR, me P shprehet Fuqia.

$$B=\frac{\sum_{i=1}^{n} P_i}{n}$$

C→ Energjia e prodhuar si pasojë e aktivizimit të FRR(kontributi FRR)

D→ Skedulimi i njësisë/njësive në ditën avancë në kuadër të kontratave jashtë objektit të kësaj marrëveshje.



ANEKSI 4

Drejtuar: Dispeçeria KESH sh.a.

Subjekti: Kërkesë për aktivizim të rezervës zëvendësuese (RR) në Kaskadën e Drinit

Në përputhje me Marrëveshjen për "Sigurimin e shërbimit të balancimit" kërkohet vënia në punë e kapacitetit gjenerues të energjisë elektrike në centralet e kaskadës së Drinit sipas specifikimeve të mëposhtme:

- Intervali orar: _____
- Sasia: **X MW**
- Drejtimi: **ngritje/ulje**
- Koha maksimale e lejuar për aktivizim: **15_min.**

Jeni të lutur të konfirmoni ekzekutimin e kërkesës sa më sipër.

Faleminderit për bashkëpunimin.

Qendra Dispeçer Kombëtare
OST sh.a.

VENDIM
Nr. 6, datë 12.6.2019

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË KËSHILLIT TË BASENIT UJOR

Në mbështetje të shkronjës "d", të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, dhe të paragrafit "vii", të shkronjës "b", të pikës 1, të kreut III, të vendimit nr. 221, datë 26.4.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Kombëtar i Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores së Këshillit të Basenit Ujor, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Deri në funksionimin e plotë të portalit elektronik të shërbimeve qeveritare në ofrimin e shërbimit për dhënien e lejeve dhe autorizimeve për përdorimin e burimit ujor, shqyrtimi i dokumentacionit dhe propozimi për miratimin e lejes së autorizimit do të bëhen nga Zyra e Administrimit të Basenit Ujor.

3. Vendimi nr. 5, datë 16.2.2016, i Këshillit Kombëtar të Ujit, "Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

RREGULLORE
E KËSHILLIT TË BASENIT UJOR

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore ka si qëllim vendosjen e rregullave të përgjithshme për organizimin, funksionimin dhe procedurat me anë të të cilave Këshilli i Basenit Ujor do të përmbushë detyrat dhe përgjegjësitë e ngarkuara në dispozitat ligjore dhe nënligjore.

Neni 2
Fusha e veprimit

Fusha e veprimit të kësaj rregulloreje është tërësia e veprimeve për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor, si dhe marrëdhëniet me institucionet, organet shtetërore, entet publike dhe subjektet private që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e burimeve ujore.

Neni 3
Objekti

Objekti i rregullores është vendosja e rregullave dhe përcaktimi i procedurave të organizimit të mbledhjes, funksionimit dhe administrimit të veprimtarisë së Këshillit të Basenit Ujor.

Neni 4
Përkufizime

Në zbatim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. **"AMBU":** Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore;
2. **"Autorizim":** akti administrativ, sipas kuptimit të dhënë në ligjin, për menaxhimin e burimeve ujore dhe në ligjin për lejet dhe licencat;
3. **"Detyra":** funksione, detyrime që i ngarkohen Këshillit të Basenit Ujor, nëpërmjet akteve nënligjore të miratuara nga Këshilli i Ministrave ose Këshilli Kombëtar i Ujit
4. **"KBU":** Këshilli i Basenit Ujor;
5. **"Kompetencë**": të drejtat që i janë dhënë me ligj, akte nënligjore, apo nëpërmjet delegimit të kompetencave, Këshillit të Basenit Ujor, për të vendosur e për të zgjidhur një rreth të caktuar çështjesh në fushën e administrimit të burimeve ujore;
6. **"Kërkesë për leje/autorizim":** kërkesat e subjekteve fizike, juridike, publike ose private për marrjen e autorizimit ose lejes për përdorim burimi ujor;
7. **"Leje":** akti administrativ sipas kuptimit të dhënë në ligjin për lejet dhe licencat;
8. **"Projektvendim**": vendimi i propozuar me karakter të përgjithshëm ose individual që rregullon një marrëdhënie juridike konkrete ose vendos rregulla të përgjithshme sjelljeje;
9. **"ZABU":** Zyra e Administrimit të Basenit Ujor.

KREU II
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

Neni 5
Organizimi i Këshillit të Basenit Ujor

1. Qendra, numri, përbërja, mandati dhe shpërblimi i anëtarëve të Këshillit të Basenit Ujor miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. KBU-ja kryesohet nga prefekti i qarkut në të cilën ndodhet Qendra e Basenit Ujor. Kryetari do të jetë në funksion për aq kohë sa ushtron detyrën e prefektit.
3. Këshilli i Basenit Ujor zgjedh nënkryetarin nga anëtarët e tij.

Neni 6
Kompetencat dhe detyrat

1. Kompetencat e KBU-së përcaktohen në ligj dhe në aktet nënligjore.
2. KBU-ja ushtron dhe detyra të tjera të përcaktuara me akte nënligjore.

KREU III
PROPOZIMI I PROJEKTVENDIMEVE, LEJEVE, AUTORIZIMEVE

Neni 7
Propozimi i projektvendimit

1. Të drejtën e propozimit të projektvendimit për miratim në mbledhjen e KBU-së e ka kryetari, çdo anëtar, AMBU-ja dhe institucionet e tjera shtetërore, qendrore ose vendore.
2. Kryetari, anëtari i KBU-së dhe institucionet e tjera shtetërore qendrore ose vendore ushtrojnë të drejtën e propozimit për çështje që përfshihen brenda fushës së përgjegjësisë së tyre shtetërore.
3. Anëtari i KBU-së dhe institucionet e tjera shtetërore, qendrore ose vendore, ushtrojnë të drejtën e propozimit duke paraqitur pranë ZABU-së kërkesën me shkrim të drejtuesit të institucionit që përfaqësojnë.
4. AMBU-ja, vetë ose nëpërmjet ZABU-së, i propozon KBU-së aktet që rregullojnë marrëdhëniet juridike në fushën e menaxhimit të burimeve ujore brenda basenit përkatës.
5. Projektvendimi shoqërohet me përgatitjen e relacionit shpjegues, raportin e vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore, si dhe mbi burimet financiare në rastet kur ka efekte financiare.

Neni 8
Propozimi i lejes, autorizimit

AMBU-ja, nëpërmjet ZABU-së, i propozon KBU-së dhënien e lejes, autorizimit për përdorimin e burimit ujor, kur veprimtaria kryhet brenda kufirit të basenit përkatës.

Neni 9
Bashkërendimi i projektvendimit

1. Kryetari ose anëtari propozues ia dërgon projektvendimin bashkë me relacionin shpjegues dhe dokumentacionin shoqërues, për mendim paraprakisht ZABU-së dhe, pasi bien dakord ndërmjet tyre, ZABU-ja ia dërgon për mendim kryetarit dhe institucioneve që përfaqësohen me anëtarë në KBU, bashkë me relacionin shpjegues dhe dokumentet shoqëruese.

2. Institucionet e parashikuara në pikën 1 e dërgojnë mendimin në formë shkresore, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë kalendarike nga data e marrjes së tij. Nëse pas mbarimit të afatit mendimi i kërkuar nuk është dhënë, do të konsiderohet se institucioni përkatës është dakord dhe pa vërejtje.

3. Në rastin e dhënies së mendimeve që synojnë të propozojnë zgjidhje të tjera alternative ose të kundërshtojnë tërësisht përmbajtjen e projektvendimit, kryetari, në rastet kur është propozues, anëtari propozues ose AMBU-ja mund të vendosë tërheqjen e plotë ose të pjesshme të propozimit ose të ndryshojë projektvendimin duke pasqyruar riformulimet e nevojshme.

Neni 10
Bashkërendimi i kërkesës për leje, autorizim

1. AMBU-ja dërgon për mendim nëpërmjet portalit qeveritar të shërbimeve elektronike kërkesën për leje, autorizim për përdorim burimi ujor, kryetarit, institucioneve që përfaqësohen me anëtarë në KBU, institucioneve të tjera që janë pjesë e bashkërendimit institucional në këtë proces dhe përfaqësuesve të grupeve të interesit, anëtarë të KBU-së.

2. Institucionet e parashikuara në pikën 1 e dërgojnë mendimin e nënshkruar elektronikisht nga nëpunësi i autorizuar, nëpërmjet sistemit elektronik, jo më vonë se 7 ditë kalendarike nga data e marrjes së tij. Nëse pas mbarimit të afatit mendimi i kërkuar nuk është dhënë, konsiderohet se institucioni përkatës është dakord dhe pa vërejtje.

Neni 11
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Në rast mosmarrëveshjeje për projektvendimet e propozuara ndërmjet anëtarëve të KBU-së ose ndërmjet anëtarëve me AMBU-në, ZABU-ja në rastin e mosmarrëveshjes ndërmjet anëtarëve dhe AMBU-së, kur mosmarrëveshja është me të, përgatisin një relacion shpjegues për përmbajtjen, problematikën si dhe zgjidhjen e mundshme të sugjeruar lidhur me kundërshtitë dhe mosmarrëveshjet e evidentuara dhe ia dërgon për shqyrtim dhe zgjidhje kryetarit të Këshillit të Basenit Ujor.

2. Në rast se mosmarrëveshja është ndërmjet AMBU-së dhe kryetarit dhe nuk zgjidhet ndërmjet tyre, atëherë palët ia kalojnë çështjen për zgjidhje kryetarit të Këshillit Kombëtar të Ujit.

3. Në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet AMBU-së dhe anëtarëve të KBU-së gjatë bashkërendimit të kërkesave për leje, autorizim për përdorim burimi ujor, AMBU-ja përgatit një relacion shpjegues për problematikën dhe e paraqet në mbledhjen e KBU-së.

KREU IV
ORGANIZIMI DHE ZHVILLIMI I MBLEDHJES

Neni 12
Rendi i ditës

1. Drejtuesi i ZABU-së, në bazë të propozimeve të AMBU-së dhe çështjeve të tjera të paraqitura, përgatit rendin e ditës së mbledhjes dhe ia propozon për miratim kryetarit.

2. Në rendin e ditës përfshihen: projektvendimi, kërkesa për leje, autorizim për të cilin/cilat ka përfunduar procedura e dhënies së mendimeve sipas neneve 9, 10, të kësaj rregulloreje.

3. Rendi i ditës përmban:

a) datën dhe orën e caktuar për mbledhjen;

b) tematikën që do të trajtohet;

c) propozimet dhe kërkesat që do të shqyrtohen:

ç) problemet e ndryshme që do të diskutohen;

3. Kryetari mund të përfshijë në rendin e ditës çështje për diskutim të cilat nuk janë propozuar nga drejtuesi i ZABU-së.

Neni 13
Thirrja e mbledhjes

1. Kryetari vendos për datën dhe orën e mbledhjes. Mbledhjet thirren si rregull, të paktën një herë në 2 (dy) muaj.

2. ZABU-ja njofton anëtarët e Këshillit të Basenit Ujor, AMBU-në për rendin e ditës, datën dhe orën e mbledhjes së Këshillit të Basenit.

3. Çdo ndryshim në rendin e ditës, datës dhe orës së vendosur për mbledhjet i njoftohet anëtarëve dhe AMBU-së.

4. Kryetari është i detyruar ta thërrasë mbledhjen kur kjo kërkohet me shkrim nga të paktën 1/3 e anëtarëve me të drejtë vote, duke përcaktuar çështjet për të cilat thirret kjo mbledhje. Në këtë rast, ZABU-ja bën njoftimin për thirrjen e mbledhjes brenda 15 ditëve pas paraqitjes së kërkesës.

5. Mbledhja e jashtëzakonshme thirret nga kryetari e, në pamundësi të tij, thirret nga nënkryetari, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj.

Neni 14
Organizimi

1. ZABU-ja organizon punën për përgatitjen e mbledhjes së KBU-së.

2. Anëtarëve u vihet në dispozicion i gjithë dokumentacioni i paraqitur nga subjekti.

3. Anëtarët si rregull vihen në dijeni për rendin e ditës të shoqëruar me materialin përkatës, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së caktuar për thirrjen e mbledhjes.

4. Për mbledhjet e jashtëzakonshme rendi i ditës dhe materialet shpërndahen të paktën 2 orë përpara orës së caktuar për mbledhje.

Neni 15
Pjesëmarrja

1. Mbledhja është e vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të Këshillit, një prej të cilëve duhet të jetë kryetari ose nënkryetari.

2. Drejtuesi i ZABU-së dhe përfaqësuesi i AMBU-së marrin pjesë rregullisht në mbledhje, pa të drejtë vote.

3. Kur në hapjen e mbledhjes nuk janë të pranishëm më shumë se 50% e anëtarëve, drejtuesi vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër, jo më pak se 48 orë pas të parës. Në këtë rast, mbledhja është e vlefshme në qoftë se janë të pranishëm gjysma e anëtarëve me të drejtë vote.

Neni 16
Kryesimi dhe drejtimi i mbledhjes

1. Mbledhja kryesohet dhe drejtohet nga kryetari.

2. Në mungesë të kryetarit, mbledhja drejtohet nga nënkryetari.

3. Drejtuesi i mbledhjes drejton diskutimet dhe siguron zbatimin e ligjit dhe marrjen e vendimeve të drejta.

Neni 17
Zhvillimi i mbledhjes

1. Mbledhja bëhet me dyer të mbyllura.

2. Me propozim të kryetarit, mbledhjet bëhen me dyer të hapura. Në këtë rast, ZABU-ja merr masa për njoftimin e palëve të interesuara. Ky njoftim bëhet të paktën 2 ditë përpara datës së mbledhjes.

3. Për arsye të motivuara, me propozim të kryetarit, për çështje të cilat nuk janë parashikuar në rendin e ditës, këshilli mund të vendosë mbledhje jashtë radhe për shqyrtimin e tyre.

4. Prezantimi i projektvendimit bëhet nga propozuesi. Projektvendimi i hartuar nga organet apo institucionet e tjera shtetërore, qendrore ose lokale, prezantohet në mbledhje nga kryetari.

5. Kërkesat për dhënie autorizimi ose leje të përdorimit të burimit ujor prezantohen nga drejtuesi i ZABU-së.

6. Pas prezantimit, drejtuesi i mbledhjes fton anëtarët të japin mendimet e tyre. Vlerësimet, debatet dhe raportimet mbeten konfidenciale.

7. Projektvendimi mund të tërhiqet nga propozuesi në çdo kohë, deri para votimit të tij.

8. Pas përfundimit të diskutimit, drejtuesi i mbledhjes fton anëtarët për votim.

9. Drejtuesi i mbledhjes mund të shtyjë ose të mbyllë mbledhjen përpara kohe, në rastin kur situata e përligj këtë veprim.

Neni 18
Konflikti i interesit

1. Dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore për konfliktin e interesit zbatohen për të gjithë anëtarët.

2. Anëtarët që kanë ndonjë pengesë ligjore nuk duhet të jenë të pranishëm gjatë diskutimeve dhe votimit.

Neni 19
Marrja e vendimit

1. KBU-ja merr vendim vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës dhe për të cilat ka përfunduar procedura e bashkërendimit sipas neneve 9 e 10, të kësaj rregulloreje.

2. Vendimi merret me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje dhe kanë të drejtën e votës, përveç rasteve kur me ligj kërkohet një shumicë e cilësuar.

3. Anëtarët, që janë të pranishëm në mbledhje dhe që nuk kanë ndonjë pengesë ligjore për të votuar, nuk mund të abstenojnë.

4. Vendimi merret me votim të hapur.

5. Drejtuesi i mbledhjes voton i fundit.

6. Në rastin kur rezultati i votimit është i barabartë, përfshirë dhe votën e kryetarit, vota e kryetarit është vendimtare.

7. Kur rezultati i votimit është i barabartë dhe mbledhja drejtohet nga Nënkryetari, vendimi shtyhet në mbledhjen pasardhëse të kryesuar nga Kryetari.

Neni 20
Vendimi

Në përfundim të shqyrtimit të projektvendimit dhe/ose kërkesës për leje/autorizim, KBU-ja vendos:

a) miratimin në gjendjen e paraqitur;

b) miratimin me ndryshime;

c) shtyrjen për një shqyrtim të mëvonshëm;

ç) mosmiratimin.

Neni 21
Regjistrimi i mbledhjes

1. Mbledhja e KBU-së regjistrohet në procesverbal. Procesverbali mbahet nga nëpunësit e ZABU-së.

2. Procesverbali përmban datën, vendin e mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën si dhe forma dhe rezultati i votimeve.

3. Procesverbali nënshkruhet nga punonjësi që e mban, Drejtori i ZABU-së dhe Drejtuesi i mbledhjes.

4. Në rastet kur mbledhja është e ndarë në seanca dhe Drejtuesi e shikon të arsyeshme, procesverbali nënshkruhet pas përfundimit të seancës së fundit.

5. Procesverbali u paraqitet, përpara mbledhjes pasardhëse, anëtarëve të KBU-s, nëse një gjë e tillë kërkohet nga vetë ata. Në këtë rast, anëtarët kanë të drejtë të paraqesin vërejtje për përmbajtjen e tij, kur nuk është pasqyruar saktësisht qëndrimi i tyre në mbledhje.

Neni 22
Hyrja në fuqi e vendimit

1. Vendimi me karakter normativ hyn në fuqi pas publikimit me mjetet e informimit publik.

2. Vendimi me karakter individual hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

3. Leja apo autorizimi për përdorim të burimit hyn në fuqi pas publikimit të tyre në Regjistrin e Licencave dhe Lejeve.

KREU VI
FORMALIZIMI, PUBLIKIMI, NJOFTIMI, ARKIVIMI DHE RUAJTJA E DOKUMENTACIONIT

Neni 23
Formalizimi, njoftimi, publikimi i vendimit, lejes, autorizimit

1. Vendimi i KBU-së formalizohet nga drejtuesi i ZABU-së dhe nënshkruhet nga drejtuesi i mbledhjes.

2. Formulari i lejes dhe i autorizimit plotësohet brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i vendimit nga drejtuesi i mbledhjes.

3. Vendimi formalizohet brenda 15 ditëve nga dita e nënshkrimit të procesverbalit të mbledhjes nga drejtuesi.

4. Vendimi formalizohet në 4 (katër) kopje, nga të cilat një kopje mbahet në arkivin e prefektit, një mbahet në arkivin e ZABU-së, një kopje i dërgohet AMBU-së dhe një kopje subjektit të interesuar.

5. ZABU-ja merr masa për njoftimin e institucioneve, organeve shtetërore, personave,

fizikë dhe juridikë, që kanë detyrime ose lidhje me përmbajtjen e vendimit.

6. Publikimi i vendimit bëhet në faqen zyrtare të ZABU-së ose nëpërmjet njoftimeve publike.

Neni 24
Vula dhe protokolli

1. KBU-ja ka vulën zyrtare me të cilën identifikohet.

2. Vula ka formën dhe përmban elementet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për prodhimin, administrimin, kontrollin dhe ruajtjen e vulave zyrtare. Vula përmban shënimin identifikues "Këshilli i Basenit Ujor".

3. Vula administrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ajo ruhet në kasafortë dhe përdoret vetëm nga punonjësit e ngarkuar me këtë detyrë në rastet e shoqërimit të dokumenteve origjinale, vulosjes së zarfeve etj.

4. Vula vendoset vetëm mbi firmën / nënshkrimin e kryetarit ose nënkryetarit.

5. Në rast të konstatimit të humbjes apo dëmtimit të vulës, vihet menjëherë në dijeni kryetari dhe drejtori i ZABU-së, ku ky i fundit merr masat për zëvendësimin e saj sipas procedurës ligjore. Përveç sa më sipër, në rastet e humbjes së vulës bëhet dhe denoncimi në organet kompetente.

6. Vula dhe protokolli, administrohet nga punonjësi i protokollit të prefektit, kryetar i Këshillit të Basenit Ujor.

Neni 25
Arkivimi dhe ruajtja e dokumentacionit

Vendimi, pas nënshkrimit nga drejtuesi i mbledhjes, ruhet dhe arkivohet në përputhje me legjislacionin në fushën e arkivave.

KREU VII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 26

Vendimi paraprak ose projektvendimi i KBU-së, i cili propozohet për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Kombëtar të Ujit, paraqitet në emër të KBU-së nga AMBU-ja.

VENDIM
Nr. 4, datë 20.6.2019

PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE TË KUTIVE, DOSJEVE DHE MJETEVE KANCELARIKE TË DETYRUESHME PËR ZBATIM NGA TË GJITHA INSTITUCIONET E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Mbështetur në pikën 1, të nenit 25, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat", dhe germës "e", të pikës 5, të nenit 8, të VKM-së nr. 360, datë 26.4.2017, "Për miratimin e rregullores 'Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave'", i ndryshuar, Këshilli i Lartë i Arkivave,

VENDOSI:

1. Miratimin e standardeve të kutive, të dosjeve dhe mjeteve kancelarike, që ndikojnë te cilësia dhe jetëgjatësia e dokumentit, të detyrueshme për zbatim nga të gjitha institucionet e Republikës së Shqipërisë, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Autoritetet publike mund të përdorin kuti dhe dosje me përmasa të ndryshme nga ato të përcaktuara në këtë vendim, vetëm nëse kanë marrë paraprakisht miratimin me shkrim nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

3. Ngarkohen të gjitha autoritetet publike në Republikën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
I ARKIVAVE
Ardit Bido

STANDARDET E KUTIVE, DOSJEVE DHE MJETEVE KANCELARIKE, QË NDIKOJNË TEK CILËSIA DHE JETËGJATËSIA E DOKUMENTIT, TË DETYRUESHME PËR ZBATIM NGA TË GJITHA INSTITUCIONET E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Lloji	Përmasat	Standardet
Kuti normale	40x28x18	- Materiali që duhet të përdoret duhet të jetë karton 2500 g/m². - Kutia përbëhet nga 2 kapakë, të gjitha këndet vijosen dhe janë 90 gradë, të gjitha brinjët lidhen me beze importi prapikot, për të realizuar një ngjitje dhe mbyllje sa më të mirë të kapakut që të bëj të mundur sigurimin e fortësisë së nevojshme për t'u mos u shkëputur gjatë përdorimit. - Kutia vishet me syprinë njëngjyrëshe 70–80 g/m², kapaku në pjesën ballore duhet të ketë të vendosur një unazë që bën të mundur ajrosjen e dokumenteve brenda në kuti, por edhe për lehtësi tërheqje gjatë përdorimit, kjo e dubluar dhe me vendosjen e një lidhëseje në pjesën e poshtme të kutisë.
Kuti normale për amza	40x55x18	
Kuti normale për regjistra	40x70x9	
Dosje normale	37x26	Kartoni të jetë 400 gr/m², me 2 llapa, llapa brenda e palosur 20 cm, pjesa ballore me kthim pa ngjitje.
Stilolapsi		Në dokumentet zyrtare duhet të përdoret gjithmonë stilolaps cilësor në ngjyrë blu dhe majë metalike. Bojë rezistente ndaj dritës dhe ujit.

VENDIM
Nr. 5, datë 20.6.2019

PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE TË KUTIVE DHE DOSJEVE PËR RUAJTJE TË PËRHERSHME, SI DHE LISTËS SË INSTITUCIONEVE DHE TIPOLOGJISË E DOKUMENTEVE TË INSTITUCIONEVE QË JANË TË DETYRUARA TË ZBATOJNË KËTO STANDARDE

Mbështetur në pikën 1, të nenit 25, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat", dhe germave "ë" dhe "f", të pikës 5, të nenit 8, të VKM-së nr. 360, datë 26.4.2017, "Për miratimin e rregullores 'Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave'", i ndryshuar, Këshilli i Lartë i Arkivave,

VENDOSI:

1. Miratimin e standardeve të kutive dhe dosjeve për ruajtje të përhershme për arkivat jo në veprim dhe për institucionet që ruajnë dokumentacion gjithnjë pranë tyre, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Miratimin e listës së institucioneve dhe tipologjinë e dokumenteve të institucioneve, që janë të detyruara të zbatojnë standardin e kutive dhe dosjeve për arkiva të përhershme, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Autoritetet publike mund të përdorin kuti dhe dosje me përmasa të ndryshme nga ato të përcaktuara në këtë vendim, vetëm nëse kanë marrë paraprakisht miratimin me shkrim nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe institucionet e përmendura në këtë vendim për zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
I ARKIVAVE
Ardit Bido

SHTOJCA 1
STANDARDET E KUTIVE DHE DOSJEVE PËR RUAJTJE TË PËRHERSHME PËR ARKIVAT JO NË VEPRIM DHE PËR INSTITUCIONET QË RUAJNË DOKUMENTACION GJITHNJË PRANË TYRE

Lloji	Përmasat	Standardet
Kuti për ruajtje të përhershme	40x28x18	Përveç standardeve të kutive dhe dosjeve normale, duhet të jetë edhe: - Ndërtuar nga karton i fortë e i valëzueshëm. - Faqet anësore me fortësi të dyfishtë, faqet fundore me trashësi të dyfishtë. - Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5. - Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit. - Të përmbajnë jo më shumë se 1% lignin -Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar) Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapura.
Kuti për ruajtje të përhershme për amza	40x55x18	
Kuti për ruajtje të përhershme për regjistra	40x70x9	
Dosje për ruajtje të përhershme	37x26	

SHTOJCA 2
LISTA E INSTITUCIONEVE DHE TIPOLOGJIA E DOKUMENTEVE TË INSTITUCIONEVE, QË JANË TË DETYRUARA TË ZBATOJNË STANDARDIN E KUTIVE DHE DOSJEVE PËR ARKIVA TË PËRHERSHME

1. Arkivat shtetëror të sistemimit, tipologjisë dhe institucionet e pavarura Kushtetuese, që sipas ligjit i ruajnë dokumente përherë pranë tyre.

2. Institucionet qendrore e të varësisë, si më poshtë:

a) Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (Regjistra të gjendjes civile; Regjistra të lindjes dhe vdekjes; Regjistra për martesat dhe zgjidhje të martesave etj.);

b) Drejtoria e Përgjithshme e Policisë (Kartoteka);

c) Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (Dosjet me dokumentacion tërësor, për patentat, licencat, mbrojtjen e të drejtës së autorit që ruhen mbi 50 vjet);

d) Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor (Regjistra të lejeve të drejtimit, qarkullimit dhe mjeteve të transportit);

e) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (Regjistra të subjekteve tatim-pagues që ruhen mbi 50 vjet);

f) Instituti i Sigurimeve Shoqërore (Librat e pagave, Bordero etj.);

g) Agjencia Shtetërore e Kadastrës (Dokumente për regjistrimin, shqyrtimin dhe verifikimin e pasurive të paluajtshme që ruhen mbi 50 vjet, regjistra etj.);

h) Spitalet Universitare dhe Rajonale (Kartelat shëndetësore që ruhen mbi 50 vjet);

i) Institucionet e Arsimit të Lartë dhe Parauniversitar (Regjistrat e amzave, librat e indekseve etj.).

3. Institucione të tjera që ruajnë e administrojnë dokumente tipologjike mbi 50 vite, i kërkojnë Këshillit të Lartë të Arkivave, përfshirjen në këtë vendim.

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 504 lekë